



UNODC

United Nations Office on Drugs and Crime



Kurrikula e trajnimit për
**Gratë dhe
burgosjen**
versioni 1.0

Korrik 2015

SERIA E MANUALEVE PËR DREJTËSINË PENALE

Falënderime

Kurrikula e trajnimit për gratë dhe burgosjen u përgatit nga Seksioni i Drejtësisë i Zyrës së Kombeve të Bashkuara kundër Drogës dhe Krimit (UNODC), në bashkëpunim me Institutin e të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtës Humanitare Raoul Wallenberg dhe Institutin Tajlandez të Drejtësisë, bazuar në draftin fillestar të hartuar nga Jeff Christian.

Materialet informuese për arsimin dhe formimin e të rriturve që ndodhen në shtojcën III dhe vlerësimi në përfundim të seminarit në shtojcën V mbështeten në *Kurrikulën e trajnimit për reagimin efektiv policor kundër dhunës ndaj grave* të UNODC-së, me ndryshime të vogla.

Struktura e këtij trajnimi është diskutuar në një takim ekspertësh nga vendet e Shoqatës së Kombeve të Azisë Juglindore, mbajtur në Bangkok nga data 19 deri në 21 mars 2013. UNODC-ja dëshiron të falënderojë ekspertët e mëposhtëm, të cilët morën pjesë në atë takim, për kontributin e dhënë: Tunyatorn Insorn, Aliakbar Ludin, Haji Saini Bin Haji Maidin, Tran Thi Kim Nguyet, Olivia Rope, Rachel Duran Ruelo, Petcharat Saisombut, Pacharaporn Sarobhas, Nongnapat Sirichote, Jamchurie Sitivannarak, Phan Xuan Son, Idang Heru Sukoco, Wilberto E. Tolitol.

Në përgatitjen e kësaj kurrikule trajnimi kanë kontribuar punonjësit e mëposhtëm të UNODC-së: Piera Barzano, Sven Pfeiffer, Maria Noel Rodriguez dhe Ehab Salah, si edhe Alison Granger-Brown dhe Mona Chamass Saunier, konsulentë.

Ky dokument nuk është redaktuar zyrtarisht.

Ky botim mund të riprodhohet tërësisht ose pjesërisht dhe në çfarëdolloj forme për qëllime edukimi ose jo fitimprurëse pa qenë e nevojshme ndonjë leje e veçantë, me kusht që të përmendet burimi.

Komentet dhe sugjerimet janë të mirëpritura dhe mund të dërgohen në:

Seksioni i Drejtësisë

Divizioni Operacional

Zyra e Kombeve të Bashkuara kundër Drogës dhe Krimit

P.O. Box 500

1400 Vienna

Austria

E-mail: justice@unodc.org

Tel.: (+43) 1 26060 0

Përmbajtja

- I. Hyrje në kurrikul
- II. Hyrje: nevojat specifike të grave të burgosura
- III. Përshkrim i kurrikulës
 - A. Moduli 1: Identifikimi i nevojave të grave të burgosura dhe trajtimi i diskriminimit
 - B. Moduli 2: Pranimi, regjistrimi dhe shpërndarja
 - C. Moduli 3: Kujdesi shëndetësor
 - D. Moduli 4: Siguria dhe mbrojtja
 - E. Moduli 5: Kontakti me botën e jashtme
 - F. Moduli 6: Rehabilitimi i të burgosurve
 - G. Moduli 7: Gratë shtatzëna dhe gratë me fëmijë në burg
 - H. Moduli 8: Kategoritë e veçanta të grave të burgosura
 - I. Moduli 9: Përgatitja për lirim dhe mbështetja pas lirimit
 - J. Moduli 10: Personeli që punon me gratë e burgosura
 - K. Moduli 11: Kërkimi, planifikimi dhe vlerësimi
 - L. Moduli 12: Masat alternative të burgimit

Shtojca

- I. Materiale për pjesëmarrësit
- II. Pyetjet dhe përgjigjet e testit
- III. Materiale informuese për trajnimin
- IV. Informacione për shëndetin mendor dhe problemet që lidhen me të në burgje
- V. Vlerësim në fund të seminarit

I. Hyrje në kurrikul

Kjo kurrikulë trajnimi është hartuar për të ndihmuar me zhvillimin e njohurive dhe aftësive të oficerëve të drejtësisë penale dhe politikë bërësve për të zbatuar Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e Grave të Burgosura dhe Masat Alternative për Gratë Kundërvajtëse (Rregullat e Bangkokut) dhe standardet dhe normat ndërkombëtare përkatëse. Kjo kurrikulë duhet të përdoret së bashku me Komentarin e Rregullave të Bangkokut¹ dhe Manualin e UNODC-së për Burgosjen e Grave (më poshtë referuar si “Manuali i UNODC-së”), ku jepen informacione të mëtejshme, shembuj dhe praktika të mira. Materiale të tjera, përfshirë kurset e trajnimit online në gjuhë të ndryshme mund t'i gjeni te UNODC-ja,² UN Women,³ OHCHR⁴ dhe Penal Reform International (PRI).⁵

Kurrikula e trajnimit përmban 12 module, të cilët fokusohen në fushat e ndryshme të Rregullave të Bangkokut. Në modulën 1 mbulohen çështjet e përgjithshme që lidhen me diskriminimin kundër grave, të cilat janë kundërvajtëse ose të burgosura dhe mënyrat e trajtimit të këtij diskriminimi në pajtim me standardet dhe normat ndërkombëtare. Në modulet 2 deri në 10 mbulohen çështje që lidhen me menaxhimin e burgjeve, të cilat lidhen më shumë me personelin dhe drejtuesit e burgjeve. Në modulën 11 trajtohet kërkimi, planifikimi dhe vlerësimi i nevojshëm për një formulim më efikas të politikave dhe për zhvillimin e programeve në lidhje me shkeljet, burgosjen dhe riintegrimin social të grave. Moduli i fundit lidhet me masat e ndryshme alternative që mund të merren nga ligjbërësi dhe politikëbërësit dhe avokatët, prokurorët, gjykatësit, shërbimet e provës ose ofrues të tjerë shërbimi për të ndihmuar në uljen e popullsisë së femrave në burgje.

Një sërë materialesh janë përfshirë në formën e shtojcave në fund të kësaj kurrikule trajnimi. Përveç materialeve për pjesëmarrësit (shtojca I), në të përfshihen edhe pyetjet dhe përgjigjet e testit (e vërtetë apo e rreme) për secilin modul (shtojca II) Këto teste mund të përdoren për të arritur objektivat e ndryshme, përfshirë: (1) përqendrimin e mendjes së pjesëmarrësve në fushën në fjalë, (2) vlerësimin e njohurive ekzistuese të pjesëmarrësve dhe (3) vlerësimin e njohurive që kanë marrë pjesëmarrësit në fund të

¹ UNODC, Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e Grave të Burgosura dhe Masat Alternative për Gratë Kundërvajtëse dhe Komentari i tyre, disponohen në anglisht, frëngjisht dhe spanjisht në <http://www.unodc.org/unodc/en/justice-and-prison-reform/tools.html>.

² Listën e plotë të mjeteve të UNODC-së për reformën në burgje dhe alternativat ndaj burgosjes mund ta gjeni në <http://www.unodc.org/unodc/en/justice-and-prison-reform/tools.html>; UNODC, Manual para Operadores de Establecimientos Penitenciarios y Gestores de Políticas para Mujeres Encarceladas, kurs online në spanjisht, që gjendet në <http://observatoriovihycarceles.org/Cursos/Mujeres/>.

³ UN Women, Reforma në Sektorin e Sigurisë (SSR): Të drejtat dhe nevojat e grave të burgosura, kurs online në anglisht, frëngjisht dhe spanjisht gjendet në <https://trainingcentre.unwomen.org/course/description.php?id=13>.

⁴ OHCHR, Manual për Trajnimin për të Drejtat e Njeriut për Oficerët e Burgjeve, gjendet në <http://www.ohchr.org/Documents/Publications/training11en.pdf>.

⁵ PRI dhe Instituti tajlandez i Drejtësisë (TIJ), Dokument Udhëzues për Rregullat e Bangkokut (më poshtë referuar si “Dokumenti udhëzues PRI/TIJ t”), gjendet në <http://www.penalreform.org/resource/bangkok-rules-guidance-document-index-implementation/>; Mjetet e PRI për Rregullat e Bangkokut të OKB-së, gjendet në <http://www.penalreform.org/priorities/women-in-the-criminal-justice-system/bangkok-rules-2/tools-resources/>; PRI, Gratë e burgosura: zbatimi i Rregullave të Bangkokut në praktikë, kurs online në arabisht, anglisht dhe rusisht, gjendet në <http://www.penalreform.org/resource/women-detention-putting-bangkok-rules-practice/>.

modulit të trajnimit. Shtojca III përmban një udhëzues të shkurtër për arsimin e të rriturve, metodologjinë e trajnimit dhe teknikat specifike që mund të përdoren dhe të përshtaten për të qenë në pajtim me nivelin ose prejardhjen kulturore të pjesëmarrësve. Në fund, është edhe një formular për vlerësimin e kursit (shtojca IV) që mund të përdoret për të marrë komentet e pjesëmarrësve në përfundim të trajnimit.

Mënyra e përdorimit të kurrikulës

Kjo kurrikulë është hartuar për t'u përdorur nga trajnuesit ose moderatorët që kanë njohuri të thella për aspektet operative dhe normative të sistemeve të burgjeve. Është e rëndësishme që trajnuesit të kenë një nivel besueshmërie në sytë e pjesëmarrësve. Në këtë drejtim avantazh kanë profesionistët me njohuri operacionale dhe përvojë në një administratë kombëtare burgjesh. Trajnuesit duhet t'i kuptojnë shumë mirë Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve (Rregullat Mandela),⁶ Rregullat e Bangkokut dhe Komentarin e tyre. Gjithashtu ata duhet të kenë njohje shumë të mirë të instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe duhet të dinë që këto standarde korrigjuese ndërkombëtare lidhen me instrumente më të gjera nga perspektiva e të drejtave të njeriut.

Rekomandohet që seancat e trajnimit të drejtohen nga më shumë se një trajnues. Një grup prej dy ose më shumë trajnuesish do të jepte më shumë dije dhe përvoja nga fusha të ndryshme specializimi. Në këto raste është shumë e rëndësishme që një trajnues të ndërveprojë me pjesëmarrësit ndërkohë që tjetri të vëzhgojë ndërveprimin dhe të japë komente dhe të shtojë "një zë tjetër" në dialogët që nxiten nga kjo qasje trajnimi.

Qasja e ndjekur në këtë kurrikulë trajnimi bazohet në parimet dhe metodat e arsimit të të rriturve. Kjo do të thotë se pjesëmarrësit nuk vijnë në trajnim thjesht për të "mësuar", por përkundrazi për të përjetuar një proces që u mundëson të kuptojnë materialet në mënyrë të atillë që për ta ka kuptim. Informacione më të detajuara për arsimimin e të rriturve mund të gjenden në burime të tjera, por ekzistojnë disa parime të përbashkëta që pranohen nga shumica e profesionistëve:

- Të folurit didaktik duhet të mbahet në nivel minimal.
- Ata që janë në trajnim janë "pjesëmarrës", jo nxënës. Ata mbajnë përgjegjësi për të marrë pjesë në trajnimin e tyre.

⁶ Rregullat Minimale Standarde për Trajtimin e të Burgosurve janë miratuar nga Kongresi i Parë i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Kundërvajtësve, Gjenevë 22 gusht-3 shtator 1955 (shih raportin e përgatitur nga Sekretariati, botim i Kombeve të Bashkuara, nr. shitjes 1956.IV.4, shtojca I.A). Në vitin 1977 ato u ndryshuan nga Këshilli Ekonomik dhe Social me rezolutën e tij 2076 (LXII) (shtimi i seksionit E titulluar "Personat e arrestuar ose të burgosur pa dënim"). Në vitin 2015 Komisioni për Parandalimin e Krimit dhe Drejtësinë Penale miratoi një rezolutë për Rregullat Minimale Standarde për Trajtimin e të Burgosurve të rishikuara, ku rekomandonte se ato duhet të njihen si "Rregullat Mandela", për miratim nga Asambleja e Përgjithshme (shih E/2015/30-E/CN.15/2015/19, Kapitulli I(A)(II)).

- Instruktori është udhëzues, jo mësues, gjatë procesit Pjesëmarrësit sjellin maturi dhe përvojë; instruktori duhet t'i nxisë që ta përdorin këtë maturi dhe përvojë.
- Duhet të shtohen sa më shumë veprimtaritë nga përvoja që lidhen me përmbajtjen e trajnimit.

Lista e përgjithshme për trajnuesit

1. *Jini gati.* Përgatiteni modulën tuaj me kujdes dhe dini me saktësi se çfarë do të mbulonit. Për ta bërë këtë do t'ju duhet të lexoni shënimet e moderatorit dhe manualin e trajnimit dhe të familjarizoheni me ushtrimet dhe vlerësimin. Më poshtë gjendet një shembull i planit mësimor, i cili mund të krijohet dhe të ndiqet me lehtësi:

Ora:	Veprimtaria e moderatorit	Veprimtaria e nxënësit	Materialet/metodat
09:00	Përshëndetni dhe urojnini mirëseardhjen pjesëmarrësve. Prezantoni veten dhe historikun tuaj. Shpërndajini një fletë 3x5 secilit pjesëmarrës.	Pjesëmarrësit prezantojnë veten. Plotësoni fletët. Ngjitni fletët në mur.	Tabela, markera, fletë 3x5, ngjitës, punë në grup
09:30	Krijoni norma për grupin.	Jepni ide për normat për grupin.	Tabela, markera
10:00	Rishikoni axhendën e seminarit.	Ndiqni axhendën.	Tabela, manualët e nxënësit

2. *Njihni audiencën tuaj.* Mësoni sa pjesëmarrës do të ndjekin kursin. Planifikoni si duhet çdo veprimtari që lidhet me modulën tuaj (puna në çift është më e vështirë me grupet e mëdha dhe sa më shumë pjesëmarrës të keni aq më shumë kohë do t'ju nevojitet për përmbledhje). Ekzistojnë disa pyetje të rëndësishme që duhen bërë paraprakisht:

- Sa persona do të jenë?
- Kush janë ata?
- Çfarë njohurish kanë për temën?
- Çfarë moshe kanë, çfarë gjinie dhe çfarë formimi arsimor?
- Pse kanë ardhur? Kush u kërkoi të ndjekin kursin? Po vijnë me detyrim apo me dëshirë?
- A ka nevoja të veçanta që duhet t'i dini?
- A e njohin njëri-tjetrin?

3. *Sillni mjete audio-vizuale.* Bëni kopje të mjaftueshme të ushtrimeve, materialeve që do shpërndahen dhe lojës me role përpara se të filloni seancën. Kontrolloni dhe sigurohuni që keni pajisjet e nevojshme, si për shembull një televizor, video, tabela, postera, stilolapsa etj. Duhet të arrini në trajnim përpara kohe për të testuar pajisjet dhe për të përgatitur gjithçka. Për një temë kaq delikate, kur pjesëmarrësit të kenë mbërritur vëmendja juaj duhet të përqendrohet vetëm tek ta.

4. *Jepni informacione specifike për rajonin.* Ky manual është hartuar për t'u përdorur në të gjitha rajonet, por mund të mos ketë detaje specifike për një rajon të caktuar. Nëse është e përshtatshme për modul tuaj, bëni kopje të të dhënave të kontaktit dhe përshkrimeve të grupeve ose personave që punojnë në këtë sektor, të cilët mund t'u japin pjesëmarrësve informacione të tjera shtesë.

5. *Planifikoni kohën tuaj.* Megjithëse mund të jeni fleksibël me kohën për pjesëmarrje aktive, duhet të keni një plan kohor të gjerë në përputhje me axhendën ditore. Përmbajuni planit edhe nëse kjo do të thotë të shkurtoni diskutimet e gjalla që mund të zgjasin shumë. Pjesëmarrësit kanë plot një javë për të menduar dhe për të folur rreth çështjeve. Mund t'i referoheni rregullave të grupit, të cilat grupi i ka pranuar, në mënyrë që t'u përmbahen orarit.

Këshilla të përgjithshme për trajnuesit

1. *Tregohuni të ndjeshëm ndaj niveleve të ndryshme të përvojës dhe prejardhjes së pjesëmarrësve.* Pjesëmarrësit mund të vijnë nga kontekste të ndryshme pune dhe trajnime të mëparshme. Nxisni respektin reciprok mes pjesëmarrësve dhe mes pjesëmarrësve dhe moderatorëve. Bëjuani të qartë se të gjitha nivelet e përvojës janë të dobishme dhe të rëndësishme për diskutimet.

2. *Lini hapësirë për diskutimin e përvojës.* Pjesëmarrësit që ndihen mirë kur ndajnë përvojat e tyre, qoftë në cilësinë personale ose nga ambienti i tyre i punës, mund të jenë të aftë t'i ndihmojnë të tjerët të rriten dhe të pasurojnë njohuritë e grupit. Kur njerëzit tregojnë historitë e tyre, emocionet ulen dhe pjesëmarrësit e tjerë mund të mësojnë nga këto përvoja.

3. *Nxisni pjesëmarrjen e gjerë dhe aktive.* Vini re kush është i qetë dhe kush përgjigjet më shpesh dhe mundohuni që të merrni reagim nga të gjithë. Krijoni një mjedis ku pjesëmarrësit të ndihen të sigurt. Njerëzit e qetë ndonjëherë marrin pjesë më shumë në diskutimet në grupe të vogla ose në çift.

4. *Nxisni debatin konstruktiv.* Nëse pjesëmarrësit nuk janë dakord me njëri-tjetrin ose me ju, ndihmoni në krijimin e një diskutimi të hapur, bazuar në përvojat dhe prejardhjen e të gjithë pjesëmarrësve. Megjithatë, diskutimi duhet të mbetet i bazuar në parimet e kursit: të drejtat e njeriut, gjinia dhe instrumentet ligjore.

5. *Gjeni gjithmonë kohë për:*

- T'i kujtuar grupit pikat e rëndësishme: theksoni dhe përmbledhni idetë kryesore gjatë modulit.
- Të përmbledhur diskutimin dhe për të lidhur idetë përkatëse.
- Të vazhduar diskutimin e temës duke u përqendruar në parime dhe jo në opinionet.

6. *Gjatë diskutimit përdorni teknikën e pyetjeve të hapura.* Pyetjet e hapura që fillojnë me "Si", "Pse", "Çfarë" ose "Kush" i bëjnë njerëzit që të mendojnë për përgjigjet e tyre dhe të mos përgjigjen thjesht "po" ose "jo". Përgjigjet janë më të plota dhe mundësojnë bërjen e pyetjeve të mëtejshme. Një pyetje e hapur shumë e dobishme është thjesht "Na thuaj më shumë për këtë" ose "Shtjelloje idenë të lutem". Përpara se t'i përgjigjeni pyetjes së një pjesëmarrësi, drejtojani atë grupit. Nëse askush nga grupi nuk mund t'i përgjigjet pyetjes, bëni disa sondazhe përpara se të jepni përgjigjen.

7. *Krijoni një marrëdhënie të sinqertë me pjesëmarrësit.* Ndani idetë dhe mendimet tuaja dhe vendosini ato në kontekstin e parimeve të kursit. Nëse ka diçka që nuk e dini, thoni që nuk e dini. Pyesni nëse dikush tjetër në sallë mund të japë ndonjë informacion. Kjo do t'i nxisë pjesëmarrësit të flasin lirshëm dhe të shprehin idetë dhe opinionet e tyre. Nëse është e nevojshme, bëni disa kërkime shtesë dhe gjeni disa minuta kohë më vonë për t'iu përgjigjur pyetjeve që nuk kanë marrë përgjigje. Ndonjëherë kur njerëzit bëjnë një pyetje dhe trajnuesi nuk e di përgjigjen, ata shqetësohen për pyetjen derisa të jepet një përgjigje. Për ta parandaluar këtë dhe për t'i mbajtur pjesëmarrësit të përqendruar në përmbajtjen e trajnimit, shkruajeni pyetjen në tabelë dhe vendoseni diku në sallë. Pjesëmarrësit tani mund të ndihen të qetë, pasi pyetja është vendosur në vend të dukshëm dhe nuk do të harrohet. Kjo gjë gjithashtu do t'ju kujtojë se keni një pyetje pa përgjigje, të cilës duhet t'i kushtoni vëmendje përpara se të përfundojë seanca. Pasi pyetja të ketë marrë përgjigje, mund ta fshini, duke dhënë një shenjë vizuale që tregon se pyetja mori përgjigje.

8. *Tregohuni pozitiv, por realist.* Nxiteni grupin që të shohin mundësitë e shumta që kanë për të mbështetur gratë e burgosura dhe ato kundërvajtëse. Në të njëjtën kohë, tregohuni të ndjeshëm ndaj kufizimeve në veprimet e tyre duke pasur parasysh kohën, aftësitë dhe buxhetin e përcaktuar.

II. Hyrje: nevojat specifike të grave të burgosura

Megjithëse gratë dhe vajzat përbëjnë një pakicë të popullsisë së burgosur në burgjet kombëtare (2-9%), përqindja e tyre është në rritje në të gjitha rajonet e botës, shpesh me ritme më të shpejta se ajo e burrave të burgosur. Në vitin 2014 janë burgosur 625 000 gra dhe vajza. Shumica e burgjeve janë krijuar për burrat dhe nuk arrijnë të përmbushin nevojat bazë të grave të burgosura, përfshirë mbrojtjen e tyre nga dhuna (seksuale). Pas daljes nga burgu, shumë gra stigmatizohen, viktimizohen ose braktisen nga familjet e tyre. Për sa i përket shkeljeve, është me rëndësi të theksohet se shumica e grave burgosen për shkelje penale jo të dhunshme, përfshirë krimet e vogla dhe shkeljet që lidhen me drogën, dhe kështu dënimi i tyre është më i shkurtër. Në rastin kur gratë kryejnë shkelje me dhunë, viktimat në shumë Shtete Anëtare janë shpesh individë të afërt të tyre, të cilët kanë ushtruar dhunë ndaj tyre. Politikat penale diskriminuese dhe ligjet që lidhen me, ndër të tjera, tradhtinë bashkëshortore, prostitucionin, abortin, magjinë ose "kujdestarinë mbrojtëse" mund të kenë një ndikim veçanërisht të dëmshëm te gratë.

Gjendja e grave të burgosura në të gjithë botën karakterizohet nga disa faktorë të përbashkët. Megjithëse arsyet kryesore dhe intensiteti i vulnerabilitetit dhe nevojat

përkatëse të grave të burgosura mund të ndryshojnë nga vendi në vend, faktorët më të zakonshëm përfshijnë:

- Sfidat që ato hasin në aksesin në drejtësi mbi baza të barabarta me burrat në shumë vende;
- Ekzistencën e shkeljeve që vlejnë vetëm ose në mënyrë disproporcionale për gratë, përfshirë abortin ose krimet morale si tradhtia bashkëshortore, sjellja e keqe seksuale ose "largimi nga shtëpia";
- Varfërinë dhe varësinë për para dhe mbështetje nga anëtarët e familjes meshkuj;
- Viktimizimin disproporcional të grave nga abuzimi seksual ose fizik përpara burgosjes;
- Nivelin e lartë të nevojave për kujdesin për shëndetin mendor, shpesh si rezultat i dhunës në familje dhe abuzimit seksual;
- Nivelin e lartë të varësisë nga droga ose alkooli;
- Nivelin e ulët arsimor dhe shkallën e lartë të analfabetizmit;
- Shqetësimin ekstrem që u shkakton burgosja grave, që shpesh çon në probleme të shëndetit mendor ose përkeqësim të problemeve mendore ekzistuese;
- Abuzimin seksual dhe dhunën ndaj grave në burg;
- Probabilitetin e lartë për të pasur përgjegjësi për t'u kujdesur për fëmijët, familjet dhe të tjerët;
- Nevojat për higjienë dhe kujdes shëndetësor specifike për gjininë, të cilat nuk përmbushen sa duhet;
- Mungesën e programeve profesionale dhe të rehabilitimit të përshtatshme për gjininë në burg;
- Stigmatizimin, viktimizimin dhe braktisjen nga familjet e tyre.

Ndryshimi i përbërjes së popullsisë në burgje ka nxjerrë në pah disa mangësi në pothuajse të gjitha sistemet e burgjeve në lidhje me përmbushjen e nevojave specifike sipas gjinisë të grave të burgosura. Me rritjen e popullsisë femërore në burgje në të gjithë botën, nevoja për të qartësuar më shumë elementet e veçanta që duhet të zbatohen në trajtimin e grave të burgosura dhe mënyrat e trajtimit të tyre në burg kanë marrë një rëndësi dhe urgjencë të veçantë.

Rregullat e Bangkokut u miratuan nga Asambleja e Përgjithshme në 21 dhjetor 2010 me konsensusin e të gjitha Shteteve Anëtare. Ato bazohen në njohjen e nevojës për të siguruar standarde globale në lidhje me trajtimin e grave kundërvajtëse dhe të burgosura dhe marrin në konsideratë një sërë rezolutash të rëndësishme të miratuara nga organe të ndryshme të Kombeve të Bashkuara, të cilat kërkojnë që Shtetet Anëtare të reagojnë si duhet ndaj nevojave të grave kundërvajtëse dhe të burgosura.

Rregullat e Bangkokut nuk zëvendësojnë, por plotësojnë, sipas rastit, Rregullat Mandela dhe Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Masat Alternative të

Dënimit me Burgim (Rregullat e Tokios) në lidhje me trajtimin e grave të burgosura dhe alternativat ndaj burgimit të grave kundërvajtëse. Për këtë arsye, të gjitha dispozitat përkatëse që përmbahen nga këto dy grupe rregullash vazhdojnë të zbatohen për të gjithë të burgosurit dhe kundërvajtësit pa diskriminim. Megjithëse disa nga rregullat që përfshihen në Rregullat e Bangkokut i qartësojnë edhe më shumë dispozitat e Rregullave Standarde Minimale për Trajtimin e të Burgosurve dhe Rregullave të Tokios në zbatimin e tyre për gratë e burgosura dhe kundërvajtëse, rregulla të tjera mbulojnë fusha të tjera.

Po ashtu, disa instrumente rajonale përmbajnë standarde dhe norma të detajuara në lidhje me gratë e burgosura. Ato përfshijnë Parimet dhe Praktikën më të Mira për Mbrojtjen e Personave të Privuar nga Liria në 2 Amerikat, të miratuara nga Komisioni Ndëramerikan për të Drejtat e Njeriut në vitin 2008 dhe Rregullat Evropiane të Burgjeve të përditësuara, të miratuara nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës në vitin 2006.

Rregullat e Bangkokut bazohen në parimin e përgjithshëm të mos diskriminimit (Rregulli 1) dhe japin udhëzime për pranimin, regjistrimin dhe shpërndarjen e grave të burgosura (Rregullat 2-4), higjienën e tyre dhe kujdesin shëndetësor (Rregullat 5-18), sigurinë dhe mbrojtjen (Rregullat 19-25) dhe kontaktin me botën e jashtme (Rregullat 26-28). Një sërë dispozitash trajtojnë klasifikimin, regjimin e burgjeve, marrëdhëniet shoqërore dhe kujdesin e mëvonshëm për gratë e burgosura (Rregullat 40-47). Vëmendje e veçantë u kushtohet grave shtatzëna, nënave që ushqejnë fëmijët me gji dhe nënave me fëmijë në burg (Rregullat 48-52) dhe kategorive të veçanta të grave të burgosura, përfshirë të burgosurat e mitura (Rregullat 36-39), shtetasit e huaj (Rregulli 53), pakicat dhe popullsitë vendase (Rregullat 54-55) dhe të burgosurit në arrest në pritje të gjykimit (Rregulli 56). Gjithashtu rregullat japin udhëzime për masat alternative të burgimit për gratë kundërvajtëse (Rregullat 57-66). Për më tepër, ato parashtrajnë standardet për personelin e institucioneve dhe trajnimet (Rregullat 29-35) si edhe përpjekjet që duhet të bëhen për sa i përket kërkimit, planifikimit, vlerësimit dhe sensibilizimit të publikut.

Kjo kurrikulë trajnimi, së bashku me Manualin e UNODC-së për Gratë dhe Burgosjen ka për qëllim që të ndihmojë ligjbërësit, politikëbërësit, drejtuesit e burgjeve, personelin dhe organizatat jo qeveritare në përfundimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për të trajtuar nevojat specifike të gjinisë që kanë gratë e burgosura dhe për të kërkuar dhe për të shfrytëzuar mënyra për reduktimin e burgosjes së panevojshme të tyre, në pajtim me dispozitat e Rregullave të Bangkokut.

III. Përshkrim i kurrikulës

Çdo modul individual i kurrikulës në këtë kapitull përmban një objektivi të përgjithshëm mësimor, një përmbledhje të përmbajtjes, referenca për mjetet si për shembull Manuali i UNODC-së për Gratë dhe Burgosjen, të cilat mund të përdoren për të përgatitur dhe zhvilluar trajnimin, si edhe të paktën një aktivitet ose ushtrim të sugjeruar mësimor.

Aktivitetet e sugjeruara për pjesëmarrësit mund të gjenden edhe në shtojcat I dhe II, të formatuara për kopjim individual dhe shpërndarje në klasë.

Moderatorët nxiten të gjejnë mënyra në secilin modul, të cilat mbështetin dhe nxisin të mësuarit interaktiv. Kjo mund të përfshijë strategji të tilla si drejtimi i pyetjeve për individët dhe jo për grupin, t'u kërkon pjesëmarrësve të lidhin përvojat personale me përmbajtjen e trajnimit menjëherë gjatë diskutimit, të krijojn veprimtari të reja ose lojë me role, ose t'u kërkon pjesëmarrësve që të shpjegojnë me radhë koncepte kyçe që përmban Manuali.

Sugjerohet që çdo rast studimor i përdorur të ndryshohet paraprakisht nga moderatori në mënyrë që të garantohet se është i përshtatshëm për kontekstin lokal dhe kulturor dhe përdor emra që gjenden rëndom në vend ose rajon. Rastet studimore nuk duhet të bazohen në shembuj realë në mënyrë të tillë që mund të identifikojnë persona konkretë ose të vënë në situatë të papëlqyeshme çdo person apo qeveri të përfshirë.

Një veprimtari e sugjeruar për fillimin ose përfundimin e trajnimit (ose secilit modul) është përgatitja e një liste të shkurtër pyetjesh, të përshtatshme për nivelin e pjesëmarrësve, të cilat shërbejnë për të testuar kujtesën e tyre dhe të kuptuarit e temës, aftësinë e tyre për të kuptuar konceptet dhe përkufizimet kyçe dhe aftësinë e tyre për ta zbatuar mësimin me një shembull. Kjo listë pyetjesh (shih gjithashtu shtojcën II) mund të realizohet si një veprimtari individuale me libër të hapur dhe më pas të bëhet një përmbledhje si aktivitet në grup. Në këtë mënyrë pjesëmarrësit janë të detyruar të gjejnë përgjigjet në Manualin e madh dhe të shqyrtojnë informacionin shtesë, duke u njohur njëkohësisht më mirë me Manualin. I takon moderatorit të vendosë nëse kjo listë pyetjesh është për qëllime rishikimi apo testimi.

A. Moduli 1: Identifikimi i nevojave të grave të burgosura dhe trajtimi i diskriminimit

Objektivat mësimore. Në përfundim të këtij moduli pjesëmarrësit do të mund të:

- Kuptojnë përkufizimin e koncepteve kyçe (përfshirë mos diskriminimin, gjininë, barazinë gjinore) dhe mënyrën se si lidhen ato me gratë e burgosura;
- Identifikojnë nevojat specifike të grave të burgosura dhe problemet që ato hasin zakonisht;
- Shqyrtojnë praktikatat që pjesëmarrësit hasin në punën e tyre për të parë nëse ato janë në fakt diskriminuese ndaj grave;
- Identifikojnë mënyrat e mundshme të trajtimit të diskriminimit ndaj grave të burgosura dhe kundërvajtëse brenda fushës së tyre të përgjegjësisë.

Përmbajtja. Në këtë modul jepet një përshkrim i dispozitave përkatëse të konventave, normave dhe standardeve ndërkombëtare në lidhje me eliminimin e diskriminimit ndaj grave dhe grave të burgosura dhe kundërvajtëse. Në të identifikohen nevojat dhe të drejtat e grave të burgosura dhe masat që mund të merren nga oficerët e drejtësisë penale, politikëbërësit dhe aktorët e tjerë për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet e Shteteve.

Mund të përcillen pikat kyçe si më poshtë:

(a) Parimi i mos diskriminimit (me bazë gjinore) nuk i ndalon përpjekjet për të përmbushur nevojat specifike të grave të burgosura. Përkundrazi, përmbushja e nevojave të tyre specifike garanton që ndaj tyre të mos ketë diskriminim. Kjo kërkon masa të vendosura nga drejtuesit dhe personeli i burgjeve për të garantuar që gratë e burgosura të kenë akses të barabartë në të gjitha shërbimet që gëzohen nga meshkujt e burgosur dhe për të garantuar përmbushjen e nevojave të tyre specifike për gjininë.

(b) Koncepti i "gjinisë" zakonisht perceptohet si një kategori social-kulturale, në kundërshtim me konceptin biologjik të "seksit". Gjinia i referohet attributeve sociale dhe mundësive që lidhen me të qenit mashkull dhe femër, përfshirë rolet dhe marrëdhëniet e ndërtuara sipas konceptit shoqëror, tiparet e personalitetit, qëndrimet, sjelljet, vlerat, pushtetin dhe ndikimin përkatës. Barazia gjinore i referohet të drejtave, përgjegjësive dhe mundësive të barabarta mes grave dhe burrave, dhe nënkupton që interesat, nevojat dhe prioritetet si të grave ashtu edhe të burrave merren në konsideratë.

(c) Menaxhimi i burgjeve sensitiv ndaj gjinisë fillon nga pranimi dhe caktimi i një gruaje (dhe fëmijëve të saj) në burg, përfshin të gjitha aspektet e burgosjes së saj dhe shtrihet deri te marrëveshjet për lirim dhe mbështetjen pas lirit. Ai bazohet në të kuptuarit se kush janë gratë e burgosura dhe pse kanë nevoja specifike (shih seksionin II më sipër për nevojat specifike të grave të burgosura).

(Mjetet e referencës: Manuali i UNODC-së, kapitulli 2.1 dhe hyrja e kapitullit 3; Dokumenti Udhëzues i PRI/TIJ, kapitulli 2.)

Aktivite të sugjeruara në këtë modul

Diskutim në grup të madh. Kërkojuni pjesëmarrësve të identifikojnë rrethanat dhe nevojat specifike të grave të burgosura, të cilat ndryshojnë nga ato të burrave të burgosur. Vendosini idetë në tabelë.

Kërkojuni grupit të lexojë Rregullin e dytë Mandela (ish rregulli 6) dhe të identifikojnë instrumente të tjera ndërkombëtare (kombëtare) që kanë dispozita të ngjashme për mos diskriminim. Si lidhet ky parim me Rregullat e tjera? Si mund të justifikohen masat e tjera për gratë nga ky parim? Kërkojuni grupit të shqyrtojë Rregullin e parë të Bangkokut (dhe nenet përkatëse të Konventës së OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave).

Aktivitet në grup të vogël. Kërkojuni pjesëmarrësve të ndahen në grupe të vegjël ku secilit i caktohet një ose më shumë arsye për diskriminim të përmendura në Rregullin e parë të Bangkokut. Kërkojuni të identifikojnë se si diskriminohen gratë dhe vajzat në burgje mbi këtë bazë (duke u përqendruar te trajtimi i ndryshëm ose kushtet që ato hasin krahasuar me burrat ose djemtë). Jepini secilit grup kohë për të shpjeguar se si do të ndikonte te gratë ose vajzat në burg një arsye e caktuar për diskriminim.

Jepini secilit grup kohë për të identifikuar masat konkrete që mund të merren (prej tyre/prej aktorëve të tjerë) për të shmangur format e diskriminimit që kanë identifikuar. Kërkoni një vullnetar nga çdo grup që të prezantojë rezultatet.

Diskutim në grup të madh. Rishikoni idetë fillestare për nevojat specifike të grave të burgosura së bashku me grupin. Shtoni nevoja dhe sfida shtesë në listën në tabelë. Lëri aty gjatë gjithë periudhës së trajnimit për referencë më vonë.

B. Moduli 2: Pranimi, regjistrimi dhe shpërndarja

Objektivat mësimore. Në përfundim të këtij moduli pjesëmarrësit do të mund të:

- Kuptojnë kërkesat e Rregullave Mandela në lidhje me pranimin e të gjithë të burgosurve;
- Kuptojnë vulnerabilitetin e veçantë të grave në kohën e pranimit dhe kërkesat e Rregullave të Bangkokut në lidhje me gratë dhe fëmijët e tyre;
- Konsiderojnë pasojat e mundshme të zbatimit në institucionet e tyre përkatëse.

Përmbajtja. Në këtë modul identifikohen dhe diskutohen elementët kryesorë dhe përsiatja e dispozitave të konventave, normave dhe standardeve ndërkombëtare në lidhje me pranimin, regjistrimin dhe shpërndarjen e grave të burgosura dhe, sipas rastit, fëmijëve të tyre. Mund të përcillen pikat kyçe si më poshtë:

(a) Të dhënat e sakta për çdo pranim dhe lirim nga burgu shërbejnë për të krijuar llogaridhënie dhe për të garantuar që asnjë person të mos mbahet në mënyrë të paligjshme, që personat të mos "zhduken" në burgje, dhe përbëjnë bazën për garantimin e caktimit të buxhetit të mjaftueshëm për numrin e personave në burg.

(b) Personeli i burgjeve duhet të marrë parasysh vulnerabilitetin e grave të burgosura të sapo ardhura, t'i trajtojë ato me ndjeshmëri të veçantë dhe t'u sigurojë informacionin dhe ambientet e nevojshme.

(c) Procesi i pranimit duhet të përfshijë mundësitë që gratë të bëjnë marrëveshje për kujdesin e fëmijëve të tyre. Mundësitë e ndryshme përfshijnë pezullimin e dënimit për një periudhë të përshtatshme, vajtjen në shtëpi të autorizuar nga autoritetet e burgut, ose masat e marra nga institucionet përkatëse në emër të të burgosurit.

(d) Informacioni për fëmijët e grave të burgosura duhet të përfshihet në regjistër. Ky informacion duhet të jetë konfidencial, por është i nevojshëm për të garantuar që të gjithë ata që pranohen në burg të jenë të regjistruar dhe për të lehtësuar kontaktin midis nënave në burg dhe fëmijëve të tyre jashtë burgut.

(e) Gratë e burgosura duhet të caktohen, nëse është e mundur, në burgje afër komuniteteve ku banojnë, sepse kjo gjë mundëson akses në programe rehabilitimi dhe mbështetje nga familjet dhe komunitetet, dhe ndihmon në ruajtjen e lidhjeve familjare, të cilat janë thelbësore për rehabilitimin social. Megjithatë, preferencat e vetë grave duhen marrë seriozisht në konsideratë: gratë që kanë përjetuar dhunë në familje mund të mos dëshirojnë të jenë afër vendbanimit të personave që kanë abuzuar me to.

(Mjetet e referencës: Manuali i UNODC-së, kapitulli 2.3 dhe 2.4; Dokumenti Udhëzues i PRI/TIJ, kapitulli 3.)

Aktivitetet të sugjeruara në këtë modul

Aktivitet në grup / rast studimor. Ndajini pjesëmarrësit në trajnim në dy grupe të barabarta. Grupi 1 duhet të marrë në shqyrtim pranimin e një burri të burgosur. Ai është 45 vjeç. Shkelja që ka kryer është grabitje. Ai është dënuar me 7 vjet. Grupi 2 duhet të marrë në shqyrtim pranimin e një gruaje të burgosur. Ajo është 29 vjeç dhe ka katër fëmijë. Të gjithë fëmijët jetonin me të përpara se ajo të burgosej.

Kërkojini secilit grup të bëjnë një listë me dokumente ose artikuj të tjerë që i duhen dhënë të burgosurit dhe të përgatisin një sërë pyetjesh që duan t'ia drejtojnë të burgosurit për të marrë prej tij/saj të gjithë informacionin e nevojshëm. Jepuni grupeve pak kohë dhe kërkojini secilit grup të prezantojë rezultatet.

Lojë me role. Nëse ka ende kohë, aktiviteti mund të kryhet si lojë me role, ku secili grup identifikon një të burgosur dhe një oficer që do të kryejë marrjen fillestare në pyetje të të burgosurit që sapo sa ardhur.

Si përmbledhje, mblidhni nga një koment nga secili pjesëmarrës. Cilat janë ndryshimet thelbësore që u vunë re në pyetjet dhe/ose lojën me role? A kishte fusha të kërkuara nga standardet por që nuk u shqyrtuan si duhet nga grupet?

Rast studimor. Ndajini pjesëmarrësit në trajnim në grupe të ndryshme. Caktojini secilit grup një nga rastet e mëposhtme dhe kërkojuni të marrin në konsideratë pyetjet e mëposhtme:

- (a) Cilat janë pikat kryesore për t'u marrë në konsideratë për gruan që pranohet?
- (b) Si do të shërbejë kjo si informacion për planin e dënimit të saj dhe strukturën?
- (c) Cilat janë nevojat e saj për kujdes shëndetësor dhe higjienë tani dhe në të ardhmen gjatë dënimit të saj?
- (d) Cilat janë problemet specifike dhe elementët e nevojshëm për sigurinë dhe mbrojtjen e saj dhe ato që ajo paraqet për sigurinë dhe mbrojtjen e institucionit? Për shembull, si do të kontrollohet ajo nëse është e nevojshme gjatë lëvizjes ose gjatë vizitave shëndetësore jashtë?
- (e) Do të ketë nevojë ajo për kontroll trupor pa veshje pas vizitës të mjeku dhe nëse po pse?
- (f) Si ndikon situata e saj personale në marrëdhëniet shoqërore gjatë mbajtjes në burg dhe planet e lirimit të saj në komunitet?
- (g) Çfarë lloj trajnimi i veçantë mund t'i nevojitet personelit për të punuar me të në mënyrë efikase dhe të sigurt?

Rasti 1. Një e re 18 vjeçare akuzohet për vjedhje. Ka mundësi që ajo të dënohet me më shumë se një vit pasi kjo nuk është shkelja e saj e parë. Ajo është 7 muaj shtatzënë. Ajo ka jetuar në rrugë herë pas here dhe nuk ka lidhje familjare. Është pothuajse analfabete dhe e ka braktisur shkollën në moshën 10 vjeçare.

Rasti 2. Një grua e moshuar është dënuar me 3 vjet dhe dihet se ka një sëmundje mendore, megjithëse për momentin nuk ka hollësi për këtë. Ajo ka precedentë me

autoritetet e ligjit dhe dihet se nuk i merr medikamentet që i janë dhënë me recetë nga mjeku.

Rasti 3. Një grua 32 vjeçare është dënuar për trafikim. Ajo ka varësi nga droga dhe është pjesë e bandave dhe përdorimit të drogës për më shumë se dhjetë vjet. Nuk ka nivel të lartë arsimor dhe nuk ka pasur kurrë një punë.

Rasti 4. Një grua në mesin e të dyzetave është dënuar sepse ka mashtruar punëdhënësin e saj për një shumë të madhe parash. Ajo ka një familje të madhe që varet ekonomikisht dhe emocionalisht nga mbështetja e saj. Ajo ka nivel të lartë arsimor.

C. Moduli 3: Higjiena dhe kujdesi shëndetësor

Objektivat mësimore. Në përfundim të këtij moduli pjesëmarrësit do të mund të:

- Kuptojnë kërkesat e përgjithshme në lidhje me higjienën, ekzaminimet mjekësore dhe kujdesin shëndetësor, dhe rëndësinë e kërkesave specifike në lidhje me gratë e burgosura;
- Konsiderojnë pasojat e mundshme të zbatimit në institucionet e tyre përkatëse.

Përmbajtja. Në këtë modul identifikohen dhe diskutohen elementët kryesorë dhe përsiatja e dispozitave të konventave, normave dhe standardeve ndërkombëtare në lidhje me higjienën dhe kujdesin shëndetësor të grave të burgosura dhe, sipas rastit, fëmijëve të tyre. Çështjet e veçanta që duhen mbuluar përfshijnë mjedisin e shëndetshëm në burg, ekzaminimet mjekësore gjatë hyrjes, kujdesin shëndetësor specifik sipas gjinisë, kujdesin dhe shëndetin mendor, parandalimin e HIV-it, trajtimin dhe kujdesin, trajtimin e varësisë nga substancat, parandalimin e vetëvrasjes dhe vetëlëndimit, shërbimet e kujdesit shëndetësor parandalues dhe higjienën. Mund të përcillen pikat kyçe si më poshtë:

(a) Shëndeti dhe higjiena personale janë ndër çështjet më të rëndësishme në çdo mjedis burgu. Shumë nga standardet ndërkombëtare për këtë çështje pasqyrojnë nivelin absolut minimal të shërbimeve (p.sh. sigurimi i ujit për të burgosurit), të cilat duhet të jenë gjithmonë të disponueshme për çdo të burgosur. Këtu përfshihet përmbushja e nevojave higjienike që lidhen me menstruacionet dhe menopauzën, si edhe nevojat shëndetësore dhe higjienike të grave shtatzëna ose atyre që ushqejnë fëmijën me gji.

(b) Shëndeti mendor është thelbësor, sepse shumë njerëz përfundojnë në burg për shkak të problemeve me shëndetin mendor dhe shumë të tjerëve u shkaktohen probleme me shëndetin mendor gjatë burgosjes. Nevojat e grave të burgosura për kujdes të shëndetit mendor kanë gjasa të bëhen më akute në ambiente burgu, për shkak të ndarjes nga fëmijët, familja dhe komuniteti (duke qenë të pakta në numër gratë e burgosura shpesh caktohen në burgje larg nga shtëpitë e tyre dhe kanë më pak vizitorë se burrat e burgosur), ose për shkak të izolimit, kontrolleve ose mbikëqyrjes nga gardianë burra, ose nga klima e dhunës dhe abuzimit në disa burgje.

(c) Gratë kanë më pak akses në shërbimet e kujdesit shëndetësor në burgje sesa burrat. Gratë kanë nevoja për kujdes shëndetësor specifike për gjininë, të cilat shkojnë përtej shtatzënisë, kujdesit përpara dhe pas lindjes dhe përfshijnë gjithashtu kujdesin për shëndetin riprodhues dhe seksual ose depistimet parandaluese për kancerin e gjirit ose të qafës së mitrës. Nevojtat e ndryshme për kujdes për shëndetin fizik dhe mendor burojnë nga dhuna e përjetuar, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, praktikat seksuale të pambrojtura ose përdorimi i substancave. Gratë duhet të ekzaminohen ose të trajtohen nga një mjeke ose infermiere sipas kërkesës së tyre.

(d) Sëmundjeve ngjitëse dhe ndikimit të tyre te gratë e burgosura duhet t'u jepet vëmendje e veçantë, duke pasur parasysh numrin e madh të grave në burgje me infeksione të transmetuara seksualisht. Gratë kanë një vulnerabilitet të veçantë fizik ndaj HIV-it dhe paraqesin një rrezik veçanërisht të lartë për të marrë tuberkuloz për shkak të prevalencës së lartë të faktorëve të shumtë të rrezikut (përfshirë statusin më të ulët social-ekonomik, prevalencën më të lartë të HIV-it, së bashku me mbipopullimin, ajrosjen e keqe, ndriçimin e dobët dhe higjienën e dobët). Burgjet shpesh nuk disponojnë terapi antiretrovirale për të parandaluar transmetimin nga nëna te fëmija, dhe fëmijët e lindur në burgje nga nëna HIV pozitive kanë nevojë për kujdes dhe vëmendje të veçantë.

(Mjetet e referencës: Manuali i UNODC-së, kapitulli 2.8; UNODC/UNAIDS, Gratë dhe HIV-i në ambientet e burgut⁷; Dokumenti Udhëzues i PRI/TIJ, kapitulli 4.)

Aktivite të sugjeruara në këtë modul

Aktivitet në grup të vogël. Kërkojuni pjesëmarrësve të ndahen në grupe më të vogla. Caktojini secilit grup disa standarde të rëndësishme (p.sh. ato që janë renditur në secilin nga 9 seksionet e para të kapitullit 2.8 të Manualit të UNODC-së).

Jepuni grupeve kohë të identifikojnë problemet specifike, nevojtat dhe vulnerabilitetin e grave të burgosura për sa i përket higjienës dhe kujdesit shëndetësor. Kërkojuni të identifikojnë masat konkrete si përgjigje e këtyre problemeve, nevojave dhe vulnerabiliteteve, të cilat mund të zbatohen në institucionet e tyre, nën udhëheqjen e standardeve të caktuara. Cilat janë pengesat dhe çfarë nevojitet për t'i kaluar ato? Ftojini të përdorin tabelën.

Kërkojuni secilit grup të bëjë një prezantim të shkurtër të gjetjeve. Si përmbledhje, mbliidhni nga një koment nga secili pjesëmarrës. Çfarë ju ka mbetur në mendje nga ato që dëgjuat në këtë modul?

Diskutim në grup të madh. Përdorni shtojcën IV për të udhëhequr një diskutim të thelluar rreth shëndetit mendor dhe sfidave që lidhen me të për gratë e burgosura dhe kërkon masa konkrete, të cilat pjesëmarrësit mund t'i përdorin gjatë punës së tyre për të trajtuar këto probleme. Përqendrohuni te sëmundjet mendore dhe vetëlëndimi, simptomat e tyre dhe shenjat paralajmëruese dhe te strategjitë dhe masat për parandalimin dhe trajtimin e tyre. Ky diskutim duhet të kryhet në grupe të vogla nëse në trajnim ka më shumë se një moderator.

⁷ Disponohet në anglisht dhe rusisht në <https://www.unodc.org/balticstates/en/publications/prison-settings.html>.

Rast studimor. Ndajini pjesëmarrësit në trajnim në grupe të ndryshme. Caktojini secilit grup rastin e mëposhtëm dhe kërkojuni të marrin në konsideratë pyetjet e mëposhtme. Në fund, kërkojini secilit grup të prezantojë përgjigjet përpara të gjithë pjesëmarrësve në trajnim.

- (a) Si shpjegohen luhatjet e papritura të humorit?
- (b) Si shpjegohet marrëdhënia e saj me gardianet?
- (c) Cilat mund të jenë arsytet që ajo lëndon veten?
- (d) Kanë rrezik më të lartë për vetëvrasje të burgosurit që lëndojnë veten?
- (e) Si do të reagonit ndaj këtij incidenti të veçantë, do të ndiqnit sugjerimin e infermieres? Shpjegoni pse ose pse jo.
- (f) Çfarë mund të bëhet për të parandaluar dhe për të trajtuar incidente të ngjashme në të ardhmen.

Rasti. Një e re nëntëmbëdhjetë vjeçare është burgosur pasi ka sulmuar bashkëshortin e saj me gërshërë. Fëmija i saj një vjeç është nën kujdestari që nga arrestimi i saj. Ajo nuk e ka parë fëmijën e saj prej më shumë se gjashtë muajsh. Gjatë burgosjes, sjellja e saj ka qenë e çrregullt: një ditë është plotë jetë dhe shumë bashkëpunuese, madje deri në pikën ku përpjekjet e saj për t'u shoqëruar me gardianet bëhen të papërshtatshme. Në ditë të tjera ajo është e tërhequr dhe armiqësore. Kohët e fundit ka fjetur keq, ka ngrënë keq dhe ka ndërprerë komunikimin me të tjerët. Duket vërtet shumë e trishtuar. Askush nuk e di nga se shkaktohen luhatjet e humorit. Një mbrëmje, një gardiane e gjeti atë vetëm në qeli: kishte prerë të dy krahët në sipërfaqe me thikë dhe ishte e gjakosur. Kur po kuronte plagët, infermierja gjeti shenja të prerjeve të mëparshme në pjesën e sipërme të krahut dhe në bark. Kur infermierja përfundoi kurimin e plagëve, ajo sugjeroi që e reja të qëndronte e izoluar për pjesën tjetër të natës, në mënyrë që të mos kryente ndonjë përpjekje tjetër për vetëvrasje. Gardianet janë të bezdisura prej saj dhe e konsiderojnë krizën si një shembull tjetër të kërkimit të vëmendjes së tyre nga kjo e burgosur.

D. Moduli 4: Siguria dhe mbrojtja

Objektivat mësimore. Në përfundim të këtij moduli pjesëmarrësit do të mund të:

- Kuptojnë që siguria dhe mbrojtja janë parakushte për përmbushjen e standardeve dhe normave përkatëse dhe të kërkojnë respektim të të drejtave të njeriut;
- Njohin pasojat e pushtetit dhe autoritetit të oficerëve të burgjeve, se si ndryshon dinamika e pushtetit midis oficerëve të burgjeve dhe të burgosurve në rastin e grave, si edhe përgjegjësinë për të menaxhuar pushtetin dhe autoritetin si duhet në të gjitha situatat;
- Kuptojnë vulnerabilitetet e veçanta që hasin gratë, veçanërisht në lidhje me abuzimin seksual në burg, masat disiplinore, kontrollet dhe kufizimet, dhe të

identifikojnë mënyrat për parandalimin dhe trajtimin e këtyre problemeve në pajtim me standardet dhe normat ndërkombëtare;

- Konsiderojnë pasojat e mundshme të zbatimit në institucionet e tyre përkatëse.

Përmbajtja. Në këtë modul identifikohen dhe diskutohen elementët kryesorë dhe përsiatja e dispozitave të konventave, normave dhe standardeve ndërkombëtare në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e grave të burgosura dhe, sipas rastit, fëmijëve të tyre. Çështje të veçanta që do të mbulohen janë ndarja dhe mbikëqyrja e grave, ankesat e të burgosurve, kontrollet, shtrëngimet fizike dhe izolimi disiplinor. Mund të përcillen pikat kyçe si më poshtë:

(a) Siguria dhe mbrojtja për të gjithë personat në burg janë gur themeli për një regjim burgjesh efektiv dhe të njerëzishëm. Mbrojtja e jashtme (parandalimi i arratisjes) dhe siguria e brendshme (parandalimi i trazirave) garantohen më së miri duke krijuar marrëdhënie pozitive midis të burgosurve dhe personelit (koncepti i "sigurisë dinamike");

(b) Ndarja e grave nga burrat në burg dhe kërkesa që gratë e burgosura të mbikëqyren nga personel femra shërben për të parandaluar dhunën, abuzimin dhe ngacmimin dhe për t'imbrotur gratë prej tyre. Veçanërisht, meshkujt e personelit nuk duhet të marrin pjesë kurrë në kontrollet personale të grave të burgosura.

(c) Kontrollet trupore zhveshur dhe kontrollet trupore intime shkaktojnë poshtërim dhe shqetësim dhe për këtë arsye duhet të zëvendësohen me metoda alternative. Fëmijët nuk duhet t'i nënshtrohen kurrë kontrollove trupore invazive. Të gjitha kontrollohet duhet të kryhen nga personel i kualifikuar në përputhje me procedurat e përcaktuara paraprakisht.

(d) Izolimi disiplinor ose instrumentet e shtrëngimit janë masat e fundit dhe duhet të përdoren vetëm për një periudhë të shkurtër kohore. Gratë shtatzëna, gratë me foshnje dhe nënat që ushqejnë fëmijën me gji në burg gëzojnë mbrojtje të veçantë nga përdorimi i instrumenteve të shtrëngimit, apo izolimi.

(e) Masat për parandalimin dhe trajtimin e dhunës ndaj grave të burgosura, qoftë nga të burgosurit e tjerë, qoftë nga personeli i burgut, përfshijnë mbrojtjen e menjëhershme, mbështetjen dhe këshillimin, kujdesin për shëndetin fizik dhe mendor, mbështetjen dhe ndihmën juridike si edhe hetimet e pavarura.

(Mjetet e referencës: Manuali i UNODC-së, kapitulli 2.6; Dokumenti Udhëzues i PRI/TIJ, kapitulli 5.)

Aktivite të sugjeruara në këtë modul

Diskutim në grup të madh. Kërkojuni pjesëmarrësve të diskutojnë ndryshimet midis sigurisë dhe mbrojtjes për gratë, krahasuar me burrat. Si ndryshon situata e tyre në kontekstin e një burgu?

Lojë me role. Përdorni ushtrimin e mëposhtëm për të nxjerrë në pah faktin se personeli i burgut është gjithmonë në pozitë autoriteti dhe pushteti dhe se kjo nuk zvogëlohet aspak nga mënyra sesi u flasin të burgosurve;

Zgjidhni një vullnetar. Kërkojini vullnetarit t'i bindet udhëzimeve që i janë dhënë.

Shpjegoni se do të ketë tre skenarë, ku në secilin prej të cilëve vullnetari bën rolin e të burgosurit dhe ju rolin e personelit të burgut.

Skenari A: Përshëndeteni të burgosurin me mirësjellje. Jepini të burgosurit një stilolaps. Kërkojini të burgosurit me mirësjellje ta vendosë në tryezë në krah të tij. Falënderojeni për këtë.

Skenari B: Përshëndeteni të burgosurin rëndë. Jepini të burgosurit një stilolaps. Kërkojini të burgosurit në mënyrë të vrazhdë ta vendosë në tryezë në krah të tij. Udhëzojeni të burgosurin të kthehet në qeli.

Skenari C: Me zë të lartë dhe të inatosur urdhërojini të burgosurit të paraqitet përpara jush. Po me zë të lartë, urdhërojini të burgosurit të vendosë stilolapsin në tryezë. Urdhërojini ta bëjë TANI!!! Urdhërojini të kthehet në qeli.

Drejtojuni pjesëmarrësve të tjerë pyetjen e mëposhtme: "Në cilin skenar fillova të përdor pushtetin?" Lëri pjesëmarrësit të votojnë. Përgjigja e saktë është skenari i parë, sepse të gjitha marrëdhëniet midis personelit dhe të burgosurve bazohen në pushtet.

Aktivitet në grup të vogël. Kërkojuni pjesëmarrësve të ndahen në grupe më të vogla. Shpjegojuni se detyra e tyre është të hartojnë një politikë për kontrollet trupore për burgun e grave, bazuar në standardet dhe normat përkatëse. Kërkojuni të përqendrohen në faktin se kur duhet të kryhen kontrollet trupore, si dhe kush i merr vendimet për të kryer kontrolle trupore, kush lejohet t'i bëjë ato, udhëzimet për kryerjen e tyre dhe aspektet e tjera përkatëse.

Aktivitet në grup të vogël. Kërkojuni pjesëmarrësve të ndahen në grupe të vogla. Caktojini secilit grup disa standarde të rëndësishme (p.sh. ato që janë renditur në secilin nga 5 seksionet e kapitullit 6 të Manualit të UNODC-së). Shpjegoni se detyra e tyre është të kryejnë një kontroll të një institucioni imagjinar në vendin e tyre, për të vlerësuar nëse standardet e caktuara janë përmbushur. Kontrolli duhet të udhëhiqet nga 3 kriteret e mëposhtme: (1) institucioni duhet të ketë një politikë/procedurë, (2) duhet të jenë kryer trajnime për temën, dhe (3) duhet të ketë të dhëna që procedura realisht ndiqet.

Jepuni grupeve kohë për të krijuar 5 pyetje (maksimumi), të cilat do t'i bëjnë për të përcaktuar nëse në institucionin imagjinar në vendin e tyre janë përmbushur standardet e caktuara. Nëse nuk keni shumë kohë, kërkoni një vullnetar nga secili grup, i cili do të prezantojë mënyrë se si e përcaktojnë ata nëse standardi është përmbushur dhe cilat do të ishin provat për të vërtetuar këtë.

Nëse keni më shumë kohë, kërkojini secilit grup të marrë në pyetje një person nga institucioni imagjinar (ky rol është thelbësor, duhet të luhet nga një person që e njeh mirë përmbajtjen e standardit; më mirë do të ishte bashkëmoderatori). Më vonë, pyesni secilin grup nëse standardi është përmbushur, bazuar në përgjigjet e marra. Në fillim pyesni ata që kanë bërë pyetjet; pastaj audiencën; votoni, bëjeni seancën interaktive dhe përfshijeni grupin sa më shumë.

E. Moduli 5: Kontakti me botën e jashtme

Objektivat mësimore. Në përfundim të këtij moduli pjesëmarrësit do të mund të:

- Kuptojnë përfitimet që ka mbajtja e kontakteve midis të burgosurit dhe botës së jashtme dhe të njohin nevojat specifike të grave për të ruajtur kontaktet me familjet, veçanërisht me fëmijët;
- Kuptojnë që vizitat e familjarëve dhe miqve janë një e drejtë dhe jo një privilegj, dhe se kontakti me botën e jashtme lidhet ngushtë me detyrimin e përkujdesjes që kanë oficerët e burgut ndaj të burgosurve;
- Kuptojnë pse gratë marrin në mënyrë jo proporcionale shumë më pak vizita dhe kanë shumë më pak kontakte me familjarët dhe miqtë;
- Konsiderojnë pasojat e mundshme të zbatimit në institucionet e tyre përkatëse.

Përmbajtja. Në këtë modul identifikohen dhe diskutohen elementët kryesorë dhe përsiatja e dispozitave të konventave, normave dhe standardeve ndërkombëtare në lidhje me kontaktimin e grave të burgosura me botën e jashtme. Në të shqyrtohen mënyrat konkrete për të ruajtur lidhjet me familjen, për të përmirësuar kushtet gjatë vizitave në burg dhe kontaktet me komunitetin. Mund të përcillen pikat kyçe si më poshtë:

(a) Kontakti me botën e jashtme është më shumë se thjesht vizitë e familjarëve dhe miqve. Standardet përkatëse kërkojnë programe vizitash dhe lehtësimin e mjeteve të tjera të komunikimit, të cilat sot përfshijnë celularët, televizorin dhe internetin. Këtu përfshihen edhe vizita nga përfaqësuesit ligjorë.

(b) Gratë e burgosura kanë një nevojë të madhe për kontakte të rregullta me familjet e tyre, veçanërisht me fëmijët, gjë që është thelbësore për mirëqenien e tyre mendore dhe riintegrimin e suksesshëm në shoqëri, dhe për këtë arsye kufizimi i kontakteve me familjen është i ndaluar si masë disiplinore.

(c) Anëtarët e familjes nuk duhet të lejohen automatikisht të bëjnë vizitë në burg pa konsultuar më parë të burgosurën në fjalë, sepse shumë gra kanë përjetuar dhunë në familje përpara burgosjes së tyre.

(Mjetet e referencës: Manuali i UNODC-së, kapitulli 2.10; Dokumenti Udhëzues i PRI/TIJ, kapitulli 6.)

Aktivitete të sugjeruara në këtë modul

Aktivitet në grup të vogël. Kërkojuni pjesëmarrësve të ndahen në grupe më të vogla. Jepini secilit grup kohë të identifikojnë disa probleme specifike, nevojat dhe vulnerabilitetin e grave të burgosura për sa i përket kontaktit me botën e jashtme. Cilat janë masat që parashikohen në Rregullat e Bangkokut dhe Rregullat Mandela për trajtimin e këtyre problemeve, nevojave dhe vulnerabiliteteve? Ftojini të përdorin tabelën. Kërkojuni secilit grup të bëjë një prezantim të shkurtër të gjetjeve.

Aktivitet në grup të vogël. Kërkojuni grupeve të diskutojnë rekomandimet dhe praktikat e mira të identifikuara në kapitullin 2.10 të Manualit të UNODC-së. Jepuni kohë që të bëjnë një listë me masa konkrete, të cilat mund të zbatohen në institucionet e tyre, pengesat që ekzistojnë dhe çfarë nevojitet për t'i kaluar ato. Kërkoni një vullnetar nga çdo grup që të prezantojë rezultatet.

F. Moduli 6: Rehabilitimi i të burgosurve

Objektivat mësimore. Në përfundim të këtij moduli pjesëmarrësit do të mund të:

- Kuptojnë kërkesën për t'i trajtuar të burgosurit si individë, me nivele të ndryshme rreziku dhe nevoja të ndryshme, dhe të kuptojnë lidhjen me programet e punës, arsimimit dhe mbështetjes përpara dhe pas lirimit nga burgju;
- Kryejnë vlerësime të rrezikut sensitive ndaj gjinisë;
- Kuptojnë rolin që mund të luajnë shoqëria civile dhe aktorët e tjerë për të ndihmuar në riintegrimin në shoqëri;
- Konsiderojnë pasojat e mundshme të zbatimit në institucionet e tyre përkatëse.

Përmbajtja. Në këtë modul identifikohen dhe diskutohen elementët kryesorë dhe përsiatja e dispozitave të konventave, normave dhe standardeve ndërkombëtare në lidhje me vlerësimin dhe klasifikimin e grave të burgosura, aktivitetet dhe programet në burg dhe përgatitjen për lirim nga burgju dhe mbështetje pas lirimit. Mund të përcillen pikat kyçe si më poshtë:

(a) Vlerësimi, klasifikimi, planifikimi individual, monitorimi dhe dokumentimi i saktë i sjelljes, si edhe aktivitetet e punës, ato arsimore, zbatimëse dhe të tjera janë në nevojshme për të nxitur rehabilitimin e të burgosurve.

(b) Instrumentet dhe kriteret e klasifikimit duhet të përshtaten për gratë, në mënyrë që të merren informacione të rëndësishme rreth përvojave të dhunës, aftësisë së kufizuar mendore, abuzimit me substancat ose përgjegjësiive prindërore. Meqenëse gratë e burgosura vuajnë në mënyrë jo proporcionale nga probleme të shëndetit mendor, është e rëndësishme që të shmangët klasifikimi i gabuar i tyre si me rrezik të lartë dhe zbatimi i niveleve të larta të sigurisë, të cilat përkeqësojnë problemet e shëndetit mendor.

(c) Rrallëherë gratë janë të burgosura me rrezik të lartë dhe përjetojnë më shumë viktimizim përpara burgosjes dhe për këtë arsye kanë nevojë më të madhe për programe mbështetëse. Programet për gratë e burgosura nuk duhet të përjetësojnë stereotipat negative gjinore, por duhet të kenë cilësi dhe shumëllojshmëri të mjaftueshme dhe duhet të mundësojnë aftësitë e nevojshme për të filluar punë pas lirimit nga burgju ose për të mbështetur financiarisht familjet nga burgju.

(d) Për gratë shtatzëna, nënat që ushqejnë fëmijën me gji dhe gratë me fëmijë të vegjël nevojiten programe specifike dhe për gratë që kanë qenë viktime të abuzimit dhe dhunës nevojitet mbështetje psikosociale.

(Mjetet e referencës: Manuali i UNODC-së, kapitulli 2.5 dhe 2.7; Dokumenti Udhëzues i PRI/TIJ, kapitulli 7.)

Aktivite të sugjeruara në këtë modul

Aktivitet në grup të vogël. Kërkojuni pjesëmarrësve të ndahen në grupe më të vogla. Caktojini secilit grup disa standarde përkatëse.

Jepuni grupeve kohë të identifikojnë problemet specifike, nevojat dhe vulnerabilitetin e grave të burgosura për sa i përket rehabilitimit të të burgosurve. Kërkojuni të identifikojnë masat konkrete si përgjigje e këtyre problemeve, nevojave dhe vulnerabiliteteve, të cilat mund të zbatohen në institucionet e tyre, nën udhëheqjen e standardeve të caktuara. Cilat janë pengesat dhe çfarë nevojitet për t'i kaluar ato? Ftojini të përdorin tabelën.

Kërkojini secilit grup të bëjë një prezantim të shkurtër të gjetjeve. Si përmbledhje, mbledhni nga një koment nga secili pjesëmarrës. Çfarë ju ka mbetur në mendje nga ato që dëgjuat në këtë modul?

Rast studimor. Ndajini pjesëmarrësit në trajnim në dy grupe. Caktojini secilit grup një nga rastet e mëposhtme dhe kërkojuni të marrin në konsideratë pyetjet e mëposhtme:

- (a) Cilat janë pengesat për rehabilitimin e grave të burgosura në këtë rast?
- (b) Cilat janë masat që mund të merren për t'i kaluar këto pengesa?
- (c) Cilët janë aktorët që mund të luajnë një rol të rëndësishëm në kapërcimin e pengesave gjatë rehabilitimit?
- (d) A hasni probleme të ngjashme ose sfida të tjera në institucionin tuaj?

Rasti 1. Aktualisht në një burg mund të rrinë 1000 të burgosur, 45 prej të cilëve gra. Gratë e burgosura strehohen në një pjesë të ndarë të burgut. Në ndërtesën kryesore, ku ndodhet edhe një palestër e vogël, ofrohen programe të rregullta për kualifikim dhe arsim profesional. Megjithëse ka shumë pak vend për t'i realizuar këto programe në ndërtesën e grave, gratë e burgosura janë të afta të kryejnë punë që konsiderohen më të përshtatshme për gratë. Disa prej tyre përgatisin ushqimin për të burgosurit, ndërkohë që disa të tjera merren me pastrimin.

Rasti 2. Një burg grash aktualisht mban 200 të burgosura. Disa prej tyre kanë probleme me shëndetin mendor dhe mbahen në qeli të ndara me siguri më të lartë, sepse gardianët e burgut kanë frikë se mund të bëhen të dhunshme. Nuk ka shumë mësues që duan të punojnë në burgje, por institucioni arrin të ofrojë një kurs arsimit bazë herë pas here. Disa gra që janë liruar me kusht janë rikthyer në burg kohët e fundit sepse kanë kryer krime kundër pronës. Njëra prej tyre u ankua se nuk ishte e mundur që ajo të gjente punë jashtë burgut.

G. Moduli 7: Gratë shtatzëna dhe gratë me fëmijë në burg

Objektivat mësimore. Në përfundim të këtij moduli pjesëmarrësit do të mund të:

- Kuptojnë nevojat specifike të grave të burgosura shtatzëna, nënave dhe fëmijëve në varësi në burg, dhe kërkesat e përcaktuara nga Rregullat e Bangkokut;
- Konsiderojnë pasojat e mundshme të zbatimit në institucionet e tyre përkatëse.

Përmbajtja. Në këtë modul identifikohen dhe diskutohen elementët kryesorë dhe përsiatja e dispozitave të konventave, normave dhe standardeve ndërkombëtare në lidhje me trajtimin e grave shtatzëna, nënave që ushqejnë fëmijët me gjë dhe grave me fëmijë në burg. Mund të përcillen pikat kyçe si më poshtë:

(a) Kur burgosja e nënave dhe fëmijëve të tyre nuk mund të shmanget, Shteti merr përsipër përgjegjësinë për t'u ofruar atyre kujdesin e duhur. Standardi i kujdesit përpara dhe pas lindjes duhet të jetë i njëjtë me atë që ofrohet jashtë burgut.

(b) Gratë shtatzëna, nënat që ushqejnë fëmijët me gjë dhe gratë me fëmijë në burg kanë nevoja specifike për sa i përket kujdesit shëndetësor, ushqyerjes dhe aftësive prindërore, të cilat kërkojnë që autoritetet e burgjeve të jenë fleksibël dhe të miratojnë masat specifike.

(c) Vendimet për t'i lejuar fëmijët të qëndrojnë me nënat në burg dhe vendimet se kur do të ndahet fëmija nga nëna duhet të merren duke pasur në konsideratë interesin më të mirë të fëmijës. Fëmijët që jetojnë në burg nuk duhet të trajtohen kurrë si të burgosur, por, në parim, duhet të jenë të lirë të largohen nga burgu. Ambienti i rritjes së tyre duhet të jetë sa më i ngjashëm me atë të fëmijëve jashtë burgut.

(Mjetet e referencës: Manuali i UNODC-së, kapitulli 2.12; UNODC/UNAIDS, Gratë dhe HIV-i në ambientet e burgut; Dokumenti Udhëzues i PRI/TIJ, kapitulli 8.)

Aktivitete të sugjeruara në këtë modul

Aktivitet në grup të vogël / lojë me role. Kërkojuni pjesëmarrësve të ndahen në grupe më të vogla. Detyra e tyre është të përgatisin një propozim për vendimmarrësin ku argumentohet krijimi i çerdhes në institucionin e tyre. Kërkojuni të shqyrtojnë shembujt e praktikës së mirë për çerdhet, të identifikuar në kapitullin 2.12 të Manualit të UNODC-së. Kërkoni një vullnetar nga çdo grup që të prezantojë rezultatet. Nëse keni ende kohë, aktiviteti mund të realizohet në formën e lojës me role.

Aktivitet në grup të vogël. Caktojini secilit grup disa standarde përkatëse. Jepuni grupeve kohë të identifikojnë problemet specifike, nevojat dhe vulnerabilitetin e grave shtatzëna dhe grave me fëmijë në burg. Kërkojuni të identifikojnë masat konkrete si përgjigje e këtyre problemeve, nevojave dhe vulnerabiliteteve, të cilat mund të zbatohen në institucionet e tyre, nën udhëheqjen e standardeve të caktuara. Cilat janë pengesat dhe çfarë nevojitet për t'i kaluar ato? Kërkoni një vullnetar nga secili grup që të bëjë një prezantim të shkurtër të gjetjeve.

Rast studimor. Ndajini pjesëmarrësit në trajnim në dy grupe. Caktojini secilit grup një nga rastet e mëposhtme dhe kërkoni të marrin në konsideratë pyetjet e mëposhtme:

- (a) Cilat janë masat që mund të merren për të përmirësuar situatën?
- (b) Cilët janë aktorët që mund të luajnë një rol të rëndësishëm?
- (c) A hasni probleme të ngjashme ose sfida të tjera në institucionin tuaj?

Rasti 1. Në një burg grash, fëmijët nën 2 vjeç lejohen të qëndrojnë me nënat e tyre në burg. Gratë e burgosura me fëmijë mbi 5 muajsh janë të detyruara që të punojnë për tetë orë ndërkohë që fëmijët e tyre qëndrojnë në çerdhe. Ka pasur disa raste kur nënat nuk kanë pranuar t'i lënë fëmijët. Kjo ka shkaktuar tensione midis të burgosurave dhe personelit të burgut dhe disa gra janë shqetësuar tej mase.

Rasti 2. Në një burg grash, fëmijët nën 2 vjeç lejohen të qëndrojnë me nënat e tyre në burg. Kur arrijnë atë moshë fëmijët vendosen në kujdestarinë e babait ose pranohen në jetimoren më të afërt, e cila ndodhet në një qytet tjetër larg burgut. Gratë e burgosura me fëmijë më të rritur po shqetësohen gjithnjë e më shumë, pasi kanë frikë se nuk do t'i shohin më fëmijët e tyre derisa të kenë përfunduar dënimin.

Aktivitet në grup të vogël. Kërkoni pjesëmarrësve të ndahen në grupe më të vogla. Shpjegoni se detyra e tyre është të hartojnë procedura për autoritetin e burgut në një burg grash në lidhje me ndarjen e fëmijëve që jetojnë me nënat në burg, bazuar në standardet dhe normat ndërkombëtare përkatëse. Kërkoni të përqendrohen në faktin se kush duhet të përfshihet në marrjen e këtyre vendimeve, çfarë elementësh duhen marrë në konsideratë kur vendoset se cilat janë interesat më të mira të fëmijës, si duhet të kryhet ndarja dhe aspekte të tjera të rëndësishme.

H. Moduli 8: Kategoritë e veçanta të grave të burgosura

Objektivat mësimore. Në përfundim të këtij moduli pjesëmarrësit do të mund të:

- Kuptojnë se si ndikon arresti dhe burgimi në kategoritë e veçanta të grave, dhe kërkesat e përcaktuara nga Rregullat e Bangkokut;
- Konsiderojnë pasojat e mundshme të zbatimit në institucionet e tyre përkatëse.

Përmbajtja. Në këtë modul identifikohen dhe diskutohen elementët kryesorë dhe përsiatja e dispozitave të konventave, normave dhe standardeve ndërkombëtare në lidhje me trajtimin e grave në paraburgim, vajzave në burg dhe grave të huaja, nga pakicat ose vendase. Mund të përcillen pikat kyçe si më poshtë:

(a) Ndarja e të paraburgosurve nga të burgosurit e dënuar është e nevojshme për të garantuar sigurinë e tyre dhe për të shtuar kontaktin e tyre me familjen dhe fëmijët krahasuar me të burgosurit e dënuar. Ekzistojnë kritere të veçanta për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë, kujdesin shëndetësor dhe ndihmën juridike për gratë në paraburgim, sepse ato hasin një rrezik të veçantë për abuzim seksual ose detyrim me forcë dhe shpesh janë analfabete, kanë më pak njohuri për të drejtat e tyre sesa burrat ose kanë probleme psikosociale.

(b) Vajzat e burgosura duhet të ndahen nga të rriturit dhe djemtë dhe të mbikëqyren vetëm nga personel femra. Ato kanë nevojë për akses të barabartë në formim arsimor dhe profesional si edhe në këshillim për abuzimin seksual dhe në programet dhe shërbimet e tjera specifike për gjininë si kujdesi për shëndetin e femrës.

(c) Gratë e huaja të burgosura dhe fëmijët e tyre hasin vështirësi shtesë, përfshirë barrierat gjuhësore, largësinë nga familja, pamundësinë për të kuptuar sistemin ligjor dhe për të gjetur një avokat, ose rreziqe më të mëdha lidhur me abuzimin seksual dhe dhunën. Autoritetet e burgut duhet të lehtësojnë komunikimin me avokatët e tyre, përfaqësuesit konsullorë dhe familjarët si edhe transferimin në atdheun e tyre, aty ku është e përshtatshme.

(d) Gratë e burgosura vendase ose që u përkasin pakicave kanë nevoja të veçanta dhe përballen me forma të shumta diskriminimi. Autoritetet e burgut duhet të ofrojnë programe dhe shërbime që lidhen me gjininë dhe kulturën e tyre, të cilat janë gjithëpërfshirëse dhe trajtojnë këto nevoja. Konsultimi me gratë e burgosura në fjalë dhe grupet përkatëse të komunitetit është shumë thelbësor.

(Mjetet e referencës: Manuali i UNODC-së, kapitulli 2.13; Dokumenti Udhëzues i PRI/TIJ, kapitulli 9.)

Aktivite të sugjeruara në këtë modul

Aktivitet në grup të vogël / lojë me role. Kërkojuni pjesëmarrësve të ndahen në 5 grupe. Grupet 1 deri në 4 do të luajnë rolin e grave të burgosura dhe grupi 5 rolin e administratës së burgut në një juridiksion jo real. Caktoni rolet për kategoritë të veçanta të grupeve dhe kërkojuni secilit grup të shqyrtojë standardet dhe normat ndërkombëtare përkatëse (p.sh. ato që janë renditur në kapitullin 2.13 të Manualit të UNODC-së): (1) të paraburgosurit; (2) vajzat e burgosura; (3) shtetasit e huaj; (4) pakicat dhe vendasit.

Shpjegoni se ata janë të pakënaqur dhe kanë kërkuar një takim me administratën e burgut. Për habinë e tyre, takimi u pranua. Lëroni grupeve 20 minuta kohë për të përgatitur një prezantim për grupin e administratës së burgut ku argumentojnë njohjen e të drejtave të tyre sipas përcaktimeve në Rregullat Mandela dhe Rregullat e Bangkokut.

Ndërkohë, grupi i administratës së burgut duhet të shqyrtojë të gjitha standardet e zbatueshme dhe të përpiqet të parashikojë se cilat do të jenë kërkesat dhe cilat masa mund të merren në konsideratë prej tyre për t'iu përgjigjur kërkesave. Ata duhet të marrin në konsideratë parametrat e mëposhtëm: (a) nuk kanë para për të shpenzuar; (b) kanë vetëm pushtetin për të vendosur se çfarë do të ndodhë në institucion; (c) nuk kanë nevojë të kërkojnë autoritet nga dikush me pozitë më të lartë; (d) janë plotësisht përgjegjës për sigurinë dhe të gjitha çështjet e tjera në funksionimin e institucionit; (e) do të pushohen nga puna nëse ka probleme serioze, ose për shkak të trazirës së shkaktuar nga këta të burgosur të pakënaqur, ose për shkak të masave që zbatohen që të burgosurit të jenë të kënaqur, nëse gjërat nuk shkojnë mirë; (f) duhet t'i japin përgjigjen e tyre grupit, përfshirë logjikën që qëndron pas vendimit të tyre.

Grupet duhet t'i mbështesin argumentet e tyre në rregullat e zbatueshme, por mund të përfshijnë në argumentet e tyre edhe standarde të tjera si në Rregullat Mandela ose në

Rregullat e Bangkokut. Ata nuk mund të përdorin legjislacionin/politikat/procedurat ose rregullat lokale për të mbështetur argumentin e tyre, sepse ndodhen në një juridiksion jo real.

Jepuni grupeve 1-4 kohë për të bërë prezantimet.

Jepini grupit të administratës së burgut kohë që të shqyrtojë argumentet dhe të përgjigjet hollësisht në lidhje me mënyrën se si do t'i zbatojë apo jo ndryshimet e kërkuara.

Rast studimor. Ndajini pjesëmarrësit në trajnim në dy grupe. Caktotini secilit grup rastet e mëposhtme dhe kërkojuni të marrin në konsideratë pyetjet e mëposhtme. Në fund, kërkojuni secilit grup të prezantojë përgjigjet përpara të gjithë pjesëmarrësve në trajnim.

(a) Cilat janë nevojat e veçanta të gruas së burgosur dhe si ndryshojnë ato nga gratë e tjera të burgosura?

(b) Cilët elementë duhet të marrin në konsideratë autoritetet e burgut?

(c) Si mund të garantojnë autoritetet e burgut që masat që do të merren dhe shërbimet që do të realizohen janë të përshtatshme për kulturën?

Rasti 1. Një grua vendase po vuan dënimin në një burg grash. Ka të dhëna se ajo ka pasur varësi nga droga dhe ka përjetuar abuzim seksual. Kryesisht ajo flet gjuhën e saj, por kupton pak edhe gjuhën që përdorin autoritetet. Familja e saj banon në një fshat të thellë, larg nga burgu. Organizatat dhe drejtuesit vendas janë aktivë në të gjithë vendin për të nxitur sensibilizimin dhe të drejtat e njeriut. Autoritetet e burgut duhet të përgatisin një plan rehabilitimi gjithëpërfshirës për të trajtuar nevojat e saj.

Rasti 2. Një grua e huaj pranohet në një burg grash. Ajo nuk e flet gjuhën që përdorin autoritetet. Fëmijët e saj banojnë në atdheun e saj, së bashku me pjesën tjetër të familjes. Autoritetet e burgut duhet të vendosin për masat që do të marrin në pajtim me standardet dhe normat ndërkombëtare.

I. Moduli 9: Përgatitja për lirim dhe mbështetja pas lirim

Objektivat mësimore. Në përfundim të këtij moduli pjesëmarrësit do të mund të:

- Kuptojnë fokusin e standardeve ndërkombëtare për përgatitjen e të burgosurve për lirim dhe riintegrim, dhe kërkesat specifike për gratë e burgosura;
- Kuptojnë rëndësinë dhe përfitimet e bashkëpunimit me agjencitë e tjera qeveritare dhe organizatat e shoqërisë civile;
- Konsiderojnë pasojat e mundshme të zbatimit në institucionet e tyre përkatëse.

Përmbajtja. Në këtë modul identifikohen dhe diskutohen elementët kryesorë dhe përsiatja e Rregullave Mandela dhe Rregullave të Bangkokut në lidhje me përgatitjen për lirim dhe grave të burgosura dhe mbështetjen pas lirim. Mund të përcillen pikat kyçe si më poshtë:

(a) Përgatitja për lirim nis në fillim të dënimit me burg dhe pas lirimit nevojitet asistencë e vazhduar. Autoritetet e burgut kanë përgjegjësinë që t'i kthejnë të burgosurit në komunitet të përgatitur dhe në gjendje që të jetojnë duke zbatuar ligjin, me arsimimin dhe

aftësitë që u mundësojnë punësim, me marrëdhënie familjare të shëndosha dhe me mbështetje fillestare me veshmbathje, ushqim, para xhepi, dokumente identifikimit dhe artikuj të tjerë që nevojiten menjëherë pas lirimit nga burgu.

(b) Meqenëse gratë e burgosura shpesh përballen me stigmën- shumë më tepër se popullsia mashkullore në burgje- dhe humbasin kontaktet me familjet e tyre, masa të tilla si leja për të vajtur në shtëpi, burgjet e hapura ose shtëpitë e rehabilitimit dhe vizitat e familjarëve në burg ndihmojnë për të garantuar mirëqenien e tyre dhe për të lehtësuar riintegrimin në shoqëri. Megjithatë, konsultimet e duhura janë thelbësore për të shmangur që gratë që kanë përjetuar dhunë në familje të vizitohen dhe të tremben ende nga abuzuesit e tyre.

(c) Pas lirimit nga burgu, gratë kanë gjasa të vuajnë nga diskriminimi dhe kanë nevojë për mbështetje të caktuar për sa i përket strehimit, bashkimit me familjet, punësimit dhe shëndetit. Autoritetet e burgut duhet të bashkëpunojnë me shërbimet e provës, departamentet e mirëqenies sociale dhe OJQ-të për të hartuar dhe për të zbatuar programe riintegrimi për gratë përpara dhe pas lirimit nga burgu.

(Mjetet e referencës: Manuali i UNODC-së, kapitulli 2.11; Dokumenti Udhëzues i PRI/TIJ, kapitulli 7.)

Aktivite të sugjeruara në këtë modul

Aktivitet në grup. Kërkojuni pjesëmarrësve të ndahen në 2 grupe. Grupi 1 do të përqendrohet te burrat e burgosur dhe grupi 2 do të përqendrohet te gratë e burgosura.

Kërkojini secilit grup që të krijojë një përshkrim të tipit të të burgosurit që gjeni në burgjet përkatëse në vendin e tyre. (Ky ushtrim mund të shkurtohet duke caktuar një person që ta krijojë këtë përshkrim paraprakisht). Jepuni kohë që të krijojnë një plan lirimi për atë të burgosur, duke krijuar një listë të nevojave të tij/saj në kohën e lirimit dhe duke identifikuar metodat dhe burimet që mund të përdoren në mënyrë realiste për t'i trajtuar këto nevoja pas lirimit.

Kërkoni një vullnetar nga secili grup, i cili do të shënojë diskutimet në grup dhe pikat kryesore (në tabelë) dhe do të paraqesë rezultatet në fund të fazës së punës në grup.

J. Moduli 10: Personeli që punon me gratë e burgosura

Objektivat mësimore. Në përfundim të këtij moduli pjesëmarrësit do të mund të:

- Kuptojnë pse është e nevojshme që personeli i caktuar për të punuar me gratë e burgosura të ketë ndërgjegjësim dhe trajnimtë specializuar për problemet që hasen më shpesh nga gratë e burgosura;
- Kuptojnë kërkesat e standardeve ndërkombëtare në lidhje me cilësinë, trajnimin dhe të drejtat e personelit që punon me gratë e burgosura;
- Konsiderojnë pasojat e mundshme të zbatimit në institucionet e tyre përkatëse.

Përmbajtja. Në këtë modul identifikohen dhe diskutohen elementët kryesorë dhe përsiatja e Rregullave Mandela dhe Rregullave të Bangkokut në lidhje me personelin që punon me gratë e burgosura. Mund të përcillen pikat kyçe si më poshtë:

(a) Cilësia e përzgjedhjes dhe trajnimit të stafit është një gur themeli për një administratë të mirë burgu. Elementë të tjerë kryesorë përfshijnë kompensimin e duhur, një status të sigurt punësimi, lidhshmëri cilësor, politika dhe procedura të qarta dhe një sistem disiplinor efektiv për të parandaluar abuzimin ndaj grave të burgosura dhe diskriminimin ndaj grave të personelit.

(b) Gratë e personelit duhet të kenë akses të njëjtë në trajnime si burrat dhe mundësi për rritje në detyrë. Drejtuesit duhet të shfaqin një angazhim të qartë dhe të qëndrueshëm për të parandaluar dhe për të trajtuar diskriminimin e institucionalizuar ndaj grave të personelit.

(c) Personeli që punon me gratë e burgosura duhet të ketë trajnim të veçantë për çështje të sensitivitetit ndaj gjinisë dhe ndalimin e diskriminimit dhe ngacmimit seksual, nevojat specifike të gjinisë dhe të drejtat e njeriut të grave të burgosura, shëndetin e femrës, ndihmën e shpejtë dhe mjekësinë bazë, zhvillimin dhe kujdesin shëndetësor për fëmijët, si edhe për sëmundjet seksualisht të transmetueshme, HIV-in, mbrojtjen e personelit dhe zbulimin e nevojave për kujdes për shëndetin mendor dhe rrezikun për vetëlëndim dhe vetëvrasje. Ofruesit e kujdesit shëndetësor duhet të trajnohen për masat universale për kontrollin e infeksioneve në ambientet shëndetësore në objekte të mbyllura.

(Mjetet e referencës: Manuali i UNODC-së, kapitulli 2.2; Dokumenti Udhëzues i PRI/TIJ, kapitulli 10.)

Aktivite të sugjeruara në këtë modul

Aktivitet në grup të vogël / lojë me role. Kërkojuni pjesëmarrësve të ndahen në tre grupe. Detyra e parë e secilit grup është të krijojnë disa pyetje që do t'ia drejtojnë një pjesëtar të mundshëm të personelit që kërkon punë. Detyra e dytë është të marrin në intervistë një vullnetar nga secili grup duke i bërë pyetjet dhe duke mbajtur shënim përgjigjet.

Grupi 1 po përzgjedh një oficer burgu të nivelit të parë që do të punojë në një institucion për meshkuj. Ata po intervistojnë një kandidat mashkull.

Grupi 2 po përzgjedh një oficer burgu të nivelit të parë që do të punojë në një institucion për meshkuj. Ata po intervistojnë një kandidatë femër.

Grupi 3 po përzgjedh një oficer burgu të nivelit të parë që do të punojë në një institucion për femra. Ata po intervistojnë një kandidatë femër.

Kërkojuni grupeve që të mendojnë për vendin e punës dhe gjininë e kandidatit. Jepuni kohë që të krijojnë 2 pyetje për secilën nga karakteristikat e mëposhtme që duhet të ketë personi: (a) njohuritë, (b) aftësitë, (c) përshtatshmëria si person. Jepuni kohë që të bëjnë intervistën.

Kërkojini secilit grup të japë komente dhe vërejtje për grupin e madh. Bazuar në gjininë e kandidatit ose në llojin e institucionit, çfarë ndryshimesh vërehen gjatë intervistës?

K. Moduli 11: Kërkimi, planifikimi dhe vlerësimi

Objektivat mësimore. Në përfundim të këtij moduli pjesëmarrësit do të mund të:

- Kuptojnë rëndësinë e kërkimit, planifikimit dhe vlerësimit si bazë për vendime të sakta të administratës së burgut dhe arritjen e objektivave të burgosjes;
- Konsiderojnë pasojat e mundshme të zbatimit në institucionet e tyre përkatëse.

Përmbajtja. Në këtë modul identifikohen dhe diskutohen elementët kryesorë dhe përsiatja e Rregullave të Bangkokut në lidhje me kërkimin, planifikimin dhe vlerësimin. Mund të përcillen pikat kyçe si më poshtë:

(a) Kërkimet për rrethanat specifike të gjinisë dhe nevojat e grave të burgosura dhe kundërvajtëse dhe fëmijëve të grave të burgosura janë baza kryesore për politikën dhe strategjitë që synojnë përmbushjen e nevojave të tyre për riintegrim në shoqëri.

(b) Në kryerjen e kërkimeve dhe mbledhjen e të dhënave gjatë punës së përditshme mund të ndihmojnë jo vetëm ligjberësit dhe politikëbërësit, por edhe autoritetet e burgjeve dhe oficerët e tjerë të drejtësisë penale, p.sh. me informacione për nevojat e grave të burgosura për kujdes shëndetësor, ndikimin e kushteve dhe praktikave të burgut në shëndetin e tyre dhe mirëqenien e tyre mendore, ose për kushtet e fëmijëve nënat e të cilëve janë në burg.

(c) Procesi i planifikimit duhet të përfshijë vlerësime gjithëpërfshirëse dhe të rregullta të efikasitetit të shërbimeve dhe programeve që ekzistojnë për gratë kundërvajtëse dhe fëmijët e tyre në komunitet dhe në burgje, me qëllim realizimin e shërbimeve në mënyrë më efektive dhe të paanshme.

(Mjetet e referencës: Manuali i UNODC-së, kapitulli 4.1; Dokumenti Udhëzues i PRI/TIJ, kapitulli 11.)

Aktivitete të sugjeruara në këtë modul

Aktivitet në grup të vogël. Kërkojuni pjesëmarrësve të ndahen në grupe të vogla. Kërkojuni grupeve të diskutojnë pyetjet e mëposhtme: (a) Si kontribuon kërkimi për të pasur burgje më të sigurta?, (b) Si kontribuon kërkimi për të pasur programe më të mira?, (c) Pse është kërkimi veçanërisht i rëndësishëm për gratë e burgosura?

Jepuni kohë që të shqyrtojnë fushat e kërkimit të identifikuar në kapitullin 4.2 të Manualit të UNODC-së dhe të diskutojnë rreth mënyrës se si mund t'i ndihmojë ky kërkim në planifikimin e punës së tyre. Kërkoni një vullnetar nga çdo grup që të prezantojë rezultatet.

L. Moduli 12: Masat alternative të burgimit

Objektivat mësimore. Në përfundim të këtij moduli pjesëmarrësit do të mund të:

- Kuptojnë qëllimin dhe përfitimet e masave alternative të burgimit dhe arsyet pse këto masa janë veçanërisht të përshtatshme për gratë kundërvajtëse;
- Identifikojnë elementët që duhet të përfshijnë masat alternative të burgimit sensitive ndaj gjinisë;
- Konsiderojnë pasojat e mundshme të zbatimit në institucionet e tyre përkatëse.

Përmbajtja. Në këtë modul identifikohen dhe diskutohen elementët kryesorë dhe përsiatja e dispozitave të konventave, normave dhe standardeve ndërkombëtare në lidhje me masat alternative të burgimit për gratë kundërvajtëse. Çështjet e veçanta që do të mbulohen përfshijnë shmangien e ndjekjes penale, alternativat ndaj paraburgosjes dhe burgosjes, dënimi dhe lirimi me kusht. Mund të përcillen pikat kyçe si më poshtë:

(a) Shumica e grave kundërvajtëse nuk paraqesin rrezik për shoqërinë dhe burgosja e tyre nuk ndihmon, por pengon riintegrimin e tyre në shoqëri dhe ndikon negativisht te fëmijët e tyre. Dhuna dhe traumat që e shoqërojnë shpesh janë shkak që gratë të kryejnë shkelje. Të gjitha opsionet e mundshme për të shmangur ndjekjen penale të grave kundërvajtëse dhe për të shmangur paraburgimin duhet të përdoren të kombinuara me ndërhyrjet për trajtimin e problemeve më të zakonshme që shkaktojnë lidhjen e grave me sistemin e drejtësisë penale.

(b) Vendimet për një dënim ose lirim me kusht duhet të marrin parasysh prejardhjen tipike të grave, përfshirë përvojat e abuzimit dhe dhunës, përgjegjësitë e tyre për kujdesin ndaj familjes dhe nevojat për riintegrim në shoqëri. Faktorë specifikë lehtësues mund të përfshijnë mungesën e precedencave penale, kryerjen e krimeve relativisht të lehta dhe karakterin e sjelljes kriminale.

(c) Mënyrat alternative për të menaxhuar gratë kundërvajtëse duhet të zbatohen sa herë që është e përshtatshme dhe e mundur. Masat alternative të burgimit duhet të preferohen në rastet e kundërvajtëseve të mitura, grave shtatzëna dhe grave me fëmijë të varësi. Nevojiten masa specifike për gratë kundërvajtëse, të cilat kanë varësi nga droga, shtetasit e huaj ose viktimat e trafikimit të genieve njerëzore.

(d) Mund të jetë e nevojshme të hartohen ose të rishikohen ligje dhe politika të përshtatshme dhe duhet të vihen në dispozicion burime të mjaftueshme për të garantuar që për gratë shkelëse të jetë e disponueshme për zbatim një gamë e plotë masash alternative ndaj burgimit, së bashku me ndërhyrjet për të trajtuar problemet më të zakonshme që shkaktojnë lidhjen e grave me sistemin e drejtësisë penale.

(Mjetet e referencës: Manuali i UNODC-së, kapitulli 3; Dokumenti Udhëzues i PRI/TIJ, kapitulli 1.)

Aktivite të sugjeruara në këtë modul

Aktivitet në grup të vogël. Kërkojuni pjesëmarrësve të ndahen në grupe më të vogla. Caktojini secilit grup disa standarde përkatëse. Jepuni grupeve kohë të identifikojnë problemet specifike, nevojat dhe vulnerabilitetin e grave kundërvajtëse dhe problemet më të zakonshme që shkaktojnë burgosjen e grave. Kërkojuni që të identifikojnë ndërhyrjet dhe masat alternative që u japin përgjigje këtyre problemeve, çështjeve, nevojave dhe vulnerabiliteteve të udhëzuar nga standardet e caktuara. Cilat masa mund të merren brenda kuadrit ligjor ekzistues dhe cilat masa kërkojnë reformë legislative? Ftojini të përdorin tabelën.

Kërkojini secilit grup të bëjë një prezantim të shkurtër të gjetjeve. Si përmbledhje, mbliidhni nga një koment nga secili pjesëmarrës. Çfarë ju ka mbetur në mendje nga ato që dëgjuat në këtë modul?

Shtojca I. Materiale për pjesëmarrësit

Faqet në vijim përmbajnë materiale për pjesëmarrësit që mund të përdoren për të lehtësuar aktivitetet në klasë dhe diskutimet për secilin modul të kurrikulës.

Moderatorët këshillohen që t'i ndryshojnë materialet dhe aktivitetet sipas nevojës, për të garantuar që të jenë të përshtatshme për problemet, nevojat dhe kulturën lokale. Këtu përfshihet futja e emrave të personave të zakonshëm lokalë në rastet studimore. Vini re se nuk është e përshtatshme që rastet studimore të bazohen në persona realë, veçanërisht në mënyrë që tillë që mund të çojë në identifikimin e tyre.

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 1: Trajtimi i diskriminimit ndaj grave të burgosura dhe kundërvajtëse

Në formën e diskutimit në grup të vogël, shqyrtoni arsyet e mëposhtme të diskriminimit:

- | | |
|------------------------------------|------------------------|
| (1) raca | (6) origjina kombëtare |
| (2) ngjyra | (7) origjina shoqërore |
| (3) gjinia | (8) prona |
| (4) besimi fetar | (9) lindja |
| (5) mendimet politike ose të tjera | (10) status tjetër |

Si diskriminohen gratë dhe vajzat në burg mbi këtë bazë të veçantë?

Cilat janë trajtimet apo kushtet e ndryshme që ato hasin krahasuar me burrat ose djemtë?

Identifikoni masat konkrete që mund të merren për të shmangur format e diskriminimit që keni identifikuar.

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 2: Pranimi, regjistrimi dhe shpërndarja (I)

Në formën e diskutimit në grup të vogël, shqyrtoni rastin e një gruaje të pranuar në burg që ju është caktuar nga moderatori dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

- (a) Cilat janë pikat kryesore për t'u marrë në konsideratë për gruan që pranohet?
- (b) Si do të shërbejë kjo si informacion për planin e dënimit të saj dhe strukturën?
- (c) Cilat janë nevojat e saj për kujdes shëndetësor dhe higjienë tani dhe në të ardhmen gjatë dënimit të saj?
- (d) Cilat janë problemet specifike dhe elementët e nevojshëm për sigurinë dhe mbrojtjen e saj dhe ato që ajo paraqet për sigurinë dhe mbrojtjen e institucionit? Për shembull, si do të kontrollohet ajo nëse është e nevojshme gjatë lëvizjes ose gjatë vizitave shëndetësore jashtë?
- (e) Do të ketë nevojë ajo për kontroll trupor pa veshje pas vizitës te mjeku dhe nëse po pse?
- (f) Si ndikon situata e saj personale në marrëdhëniet shoqërore gjatë mbajtjes në burg dhe planet e lirimit të saj në komunitet?
- (g) Çfarë lloj trajnimi i veçantë mund t'i nevojitet personelit për të punuar me të në mënyrë efikase dhe të sigurt?

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 2: Pranimi, regjistrimi dhe shpërndarja (II)

Listë e rasteve studimore:

Rasti 1. Një e re 18 vjeçare akuzohet për vjedhje. Ka mundësi që ajo të dënohet me më shumë se një vit pasi kjo nuk është shkelja e saj e parë. Ajo është 7 muaj shtatzënë. Ajo ka jetuar në rrugë herë pas here dhe nuk ka lidhje familjare. Është pothuajse analfabete dhe e ka braktisur shkollën në moshën 10 vjeçare.

Rasti 2. Një grua e moshuar është dënuar me 3 vjet dhe dihet se ka një sëmundje mendore, megjithëse për momentin nuk ka hollësi për këtë. Ajo ka precedentë me autoritetet e ligjit dhe dihet se nuk i merr medikamentet që i janë dhënë me recetë nga mjeku.

Rasti 3. Një grua 32 vjeçare është dënuar për trafikim. Ajo ka varësi nga droga dhe është përfshirë në kriminalitet dhe në përdorimin e drogës për më shumë se dhjetë vjet. Nuk ka nivel të lartë arsimor dhe nuk ka pasur kurrë një punë.

Rasti 4. Një grua në mesin e të dyzetave është dënuar sepse ka mashtruar punëdhënësin e saj për një shumë të madhe parash. Ajo ka një familje të madhe që varet ekonomikisht dhe emocionalisht nga mbështetja e saj. Ajo ka nivel të lartë arsimor.

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 3: Kujdesi shëndetësor (I)

Në formën e diskutimit në grup të vogël, identifikoni problemet specifike, nevojat dhe vulnerabilitetin e grave të burgosura për sa i përket higjienës dhe kujdesit shëndetësor. Mbani parasysh standardet dhe normat që ju janë caktuar nga moderatori.

Bëni një listë të këtyre problemeve, nevojave dhe vulnerabiliteteve.

Cilat masa konkrete mund të merren për të trajtuar secilën prej tyre, bazuar në standardet dhe normat?

Cilat janë pengesat që ekzistojnë? Çfarë nevojitet për t'i kaluar ato?

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 3: Kujdesi shëndetësor (II)

Në formën e diskutimit në grup të vogël, shqyrtoni rastin e mëposhtëm dhe përgjigjuni pyetjeve:

- (a) Si shpjegohen luhajtjet e papritura të humorit?
- (b) Si shpjegohet marrëdhënia e saj me gardianet?
- (c) A është vetëlëndimi një mënyrë për të kërkuar vëmendje?
- (d) A është vetëlëndimi një përpjekje për vetëvrasje?
- (e) Kanë rrezik më të lartë për vetëvrasje të burgosurit që lëndojnë veten?

Rasti. Një e re nëntëmbëdhjetë vjeçare është burgosur pasi ka sulmuar bashkëshortin e saj me gërshërë. Fëmija i saj një vjeç është nën kujdestari që nga arrestimi i saj. Ajo nuk e ka parë fëmijën e saj prej më shumë se gjashtë muajsh. Gjatë burgosjes, sjellja e saj ka qenë e çrregullt: një ditë është plotë jetë dhe shumë bashkëpunuese, madje deri në pikën ku përpjekjet e saj për t'u shoqëruar me gardianet bëhen të papërshtatshme. Në ditë të tjera ajo është e tërhequr dhe armiqësore. Kohët e fundit ka fjetur keq, ka ngrënë keq dhe ka ndërprerë komunikimin me të tjerët. Duket vërtet shumë e trishtuar. Askush nuk e di nga se shkaktohen luhajtjet e humorit. Një mbrëmje, një gardiane e gjeti atë vetëm në qeli: kishte prerë të dy krahët në sipërfaqe me thikë dhe ishte e gjakosur. Kur po kuronte plagët, infermierja gjeti shenja të prerjeve të mëparshme në pjesën e sipërme të krahut dhe në bark. Kur infermierja përfundoi kurimin e plagëve, ajo sugjeroi që e reja të qëndronte e izoluar për pjesën tjetër të natës, në mënyrë që të mos kryente ndonjë përpjekje tjetër për vetëvrasje. Gardianet janë të bezdisura prej saj dhe e konsiderojnë krizën si një shembull tjetër të kërkimit të vëmendjes së tyre nga kjo e burgosur.

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 4: Siguria dhe mbrojtja (I)

Në formën e diskutimit në grup të vogël, mbani parasysht standardet dhe normat që ju janë caktuar nga moderatori në lidhje me kontrollet trupore.

Detyra juaj është të hartoni një politikë për kontrollet trupore në një burg grash. Në politikë duhet të specifikohen të paktën aspektet e mëposhtme: (1) kur duhet të kryhen kontrollet trupore, (2) kush i merr vendimet për të kryer kontrolle trupore, (3) kush lejohet t'i bëjë ato, dhe (4) udhëzimet për kryerjen e tyre.

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 5: Kontakti me botën e jashtme

Në formën e diskutimit në grup të vogël, identifikoni problemet specifike, nevojat dhe vulnerabilitetin e grave të burgosura për sa i përket kontaktit me botën e jashtme.

Cilat janë masat që parashikohen në Rregullat e Bangkokut dhe Rregullat Mandela për trajtimin e këtyre problemeve, nevojave dhe vulnerabiliteteve?

Çfarë nënkupton kjo për punën tuaj? Rendisni masat konkrete që mund të merren për t'i zbatuar këto elemente thelbësore.

Cilat janë pengesat që ekzistojnë? Çfarë nevojitet për t'i kaluar ato?

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 6: Rehabilitimi i të burgosurve (I)

Në formën e diskutimit në grup të vogël, identifikoni problemet specifike, nevojat dhe vulnerabilitetin e grave të burgosura për sa i përket rehabilitimit të të burgosurve. Mbani parasysh standardet dhe normat që ju janë caktuar nga moderatori.

Bëni një listë të këtyre problemeve, nevojave dhe vulnerabiliteteve.

Cilat masa konkrete mund të merren për të trajtuar secilën prej tyre, bazuar në standardet dhe normat?

Cilat janë pengesat që ekzistojnë? Çfarë nevojitet për t'i kaluar ato?

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 6: Rehabilitimi i të burgosurve (III)

Listë e rasteve studimore:

Rasti 1. Aktualisht në një burg mund të rrinë 1000 të burgosur, 45 prej të cilëve gra. Gratë e burgosura strehohen në një pjesë të ndarë të burgut. Në ndërtesën kryesore, ku ndodhet edhe një palestër e vogël, ofrohen programe të rregullta për kualifikim dhe arsim profesional. Megjithëse ka shumë pak vend për t'i realizuar këto programe në ndërtesën e grave, gratë e burgosura janë të afta të kryejnë punë që konsiderohen më të përshtatshme për gratë. Disa prej tyre përgatisin ushqimin për të burgosurit, ndërkohë që disa të tjera merren me pastrimin.

Rasti 2. Një burg grash aktualisht mban 200 të burgosura. Disa prej tyre kanë probleme me shëndetin mendor dhe mbahen në qeli të ndara me siguri më të lartë, sepse gardianët e burgut kanë frikë se mund të bëhen të dhunshme. Nuk ka shumë mësues që duan të punojnë në burgje, por institucioni arrin të ofrojë një kurs arsimit bazë herë pas here. Disa gra që janë liruar me kusht janë rikthyer në burg kohët e fundit sepse kanë kryer krime kundër pronës. Njëra prej tyre u ankua se nuk ishte e mundur që ajo të gjente punë jashtë burgut.

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 7: Gratë shtatzëna dhe gratë me fëmijë në burg (II)

Në formën e diskutimit në grup të vogël, identifikoni problemet specifike, nevojat dhe vulnerabilitetin e grave shtatzëna dhe grave me fëmijë në burg. Mbani parasysh standardet dhe normat që ju janë caktuar nga moderatori.

Bëni një listë të këtyre problemeve, nevojave dhe vulnerabiliteteve.

Cilat masa konkrete mund të merren për të trajtuar secilën prej tyre, bazuar në standardet dhe normat?

Cilat janë pengesat që ekzistojnë? Çfarë nevojitet për t'i kaluar ato?

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 7: Gratë shtatzëna dhe gratë me fëmijë në burg (IV)

Listë e rasteve studimore:

Rasti 1. Në një burg grash, fëmijët nën 2 vjeç lejohen të qëndrojnë me nënat e tyre në burg. Gratë e burgosura me fëmijë mbi 5 muajsh janë të detyruara që të punojnë për tetë orë ndërkohë që fëmijët e tyre qëndrojnë në çerdhe. Ka pasur disa raste kur nënat nuk kanë pranuar t'i lënë fëmijët. Kjo ka shkaktuar tensione midis të burgosurave dhe personelit të burgut dhe disa gra janë shqetësuar tej mase.

Rasti 2. Në një burg grash, fëmijët nën 2 vjeç lejohen të qëndrojnë me nënat e tyre në burg. Kur arrijnë atë moshë fëmijët vendosen në kujdestarinë e babait ose pranohen në jetimorën më të afërt, e cila ndodhet në një qytet tjetër larg burgut. Gratë e burgosura me fëmijë më të rritur po shqetësohen gjithnjë e më shumë, pasi kanë frikë se nuk do t'i shohin më fëmijët e tyre derisa të kenë përfunduar dënimin.

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 8: Kategoritë e veçanta të grave të burgosura (I)

Në grup të vogël, luani rolin e një prej kategorive të mëposhtme të grave të burgosura në një institucion në një vend imagjinar. Jeni të pakënaqur me gjendjen tuaj dhe trajtimin dhe keni kërkuar një takim me administratën e burgut. Për habinë tuaj, takimi u pranua. Përgatitsni një prezantim për administratën e burgut ku argumentoni njohjen e të drejtave tuaja sipas përcaktimeve në Rregullat Mandela dhe Rregullat e Bangkokut. Nuk mund të përdorni legjisllacionin /politikat/procedurat ose rregullat lokale për të mbështetur argumentin tuaj, sepse ato nuk zbatohen në vendin imagjinar.

- (1) të paraburgosurat;
- (2) vajzat e burgosura;
- (3) shtetaset e huaja;
- (4) pakicat dhe vendasit.

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 8: Kategoritë e veçanta të grave të burgosura (II)

Në grup të vogël, luani rolin e administratës së burgut në një vend imagjinar. Grupe të ndryshme grash ju janë drejtuar sepse janë të pakënaqura me gjendjen e tyre dhe trajtimin në burgun që është nën autoritetin tuaj. I keni caktuar atyre një takim për të dëgjuar se çfarë duan. Shqyrtoni standardet e mëposhtme dhe përpiquni të parashikoni se cilat do të jenë kërkesat e grupeve të ndryshme dhe cilat masa mund të merrni në konsideratë për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave.

- (1) të paraburgosurat;
- (2) vajzat e burgosura;
- (3) shtetasit e huaja;
- (4) pakicat dhe vendasit.

Mbani parasysh parametrat e mëposhtëm:

- (a) nuk keni para për të shpenzuar;
- (b) keni vetëm pushtetin për të vendosur se çfarë ndodh në institucion;
- (c) nuk keni nevojë të kërkonit autoritet nga dikush me pozitë më të lartë;
- (d) jeni plotësisht përgjegjës për sigurinë dhe të gjitha çështjet e tjera në funksionimin e institucionit;
- (e) do të pushoheni nga puna nëse ka probleme serioze, ose për shkak të trazirës së shkaktuar nga këta të burgosur të pakënaqur, ose për shkak të masave që zbatohen që të burgosurit të jenë të kënaqur, nëse gjërat nuk shkojnë mirë;
- (f) duhet t'i jepni përgjigjen tuaj grupit, përfshirë logjikën që qëndron pas vendimit tuaj.

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 8: Kategoritë e veçanta të grave të burgosura (III)

Në formën e diskutimit në grup të vogël, shqyrtoni rastin që ju është caktuar nga moderatori dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

(a) Cilat janë nevojat e veçanta të gruas së burgosur dhe si ndryshojnë ato nga gratë e tjera të burgosura?

(b) Cilët elementë duhet të marrin në konsideratë autoritetet e burgut?

(c) Si mund të garantojnë autoritetet e burgut që masat që do të merren dhe shërbimet që do të realizohen janë të përshtatshme për kulturën?

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 8: Kategoritë e veçanta të grave të burgosura (IV)

Listë e rasteve studimore:

Rasti 1. Një grua vendase po vuan dënimin në një burg grash. Ka të dhëna se ajo ka pasur varësi nga droga dhe ka përjetuar abuzim seksual. Kryesisht ajo flet gjuhën e saj, por kupton pak edhe gjuhën që përdorin autoritetet. Familja e saj banon në një fshat të thellë, larg nga burgu. Organizatat dhe drejtuesit vendas janë aktivë në të gjithë vendin për të nxitur sensibilizimin dhe të drejtat e njeriut. Autoritetet e burgut duhet të përgatisin një plan rehabilitimi gjithëpërfshirës për të trajtuar nevojat e saj.

Rasti 2. Një grua e huaj pranohet në një burg grash. Ajo nuk e flet gjuhën që përdorin autoritetet. Fëmijët e saj banojnë në atdheun e saj, së bashku me pjesën tjetër të familjes. Autoritetet e burgut duhet të vendosin për masat që do të marrin në pajtim me standardet dhe normat ndërkombëtare.

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 9: Përgatitja për lirim dhe mbështetja pas lirit

Në formën e diskutimit në grup të madh, krijoni një përshkrim të tipit të të burgosurit që gjeni zakonisht në burgjet e burrave / grave në vendin tuaj.

Krijoni një plan lirimi për atë të burgosur, përfshirë një listë të nevojave të tij/saj në kohën e lirit dhe identifikoni metodat dhe burimet që mund të përdoren në mënyrë realiste për t'i trajtuar këto nevoja pas lirit.

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 10: Personeli që punon me gratë e burgosura (I)

Bazuar në rastin studimor që iu caktua grupit tuaj, diskutoni se cilat pyetje duhet t'i drejtoni një pjesëtari të ardhshëm të personelit që kërkon punë. Mendoni për vendin e punës dhe gjininë e kandidatit. Krijoni 2 pyetje për secilën nga karakteristikat e mëposhtme që duhet të ketë personi: (a) njohuritë, (b) aftësitë, (c) përshtatshmëria si person.

Pas kësaj, merrni në intervistë një vullnetar nga grup juaj duke i bërë pyetjet dhe duke mbajtur shënime përgjigjet.

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 10: Personeli që punon me gratë e burgosura (II)

Raste studimore për punë në grup:

Grupi 1. Po përzgjidhni një oficer burgu të nivelit të parë që do të punojë në një institucion për meshkuj. Po intervistoni një kandidat mashkull.

Grupi 2. Po përzgjidhni një oficer burgu të nivelit të parë që do të punojë në një institucion për meshkuj. Po intervistoni një kandidate femër.

Grupi 3. Po përzgjidhni një oficer burgu të nivelit të parë që do të punojë në një institucion për femra. Po intervistoni një kandidate femër.

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 11: Kërkimi, planifikimi dhe vlerësimi

Në formën e diskutimit në grup të vogël, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

- (a) Si kontribuon kërkimi për të pasur burgje më të sigurta?
- (b) Si kontribuon kërkimi për të pasur programe më të mira?
- (c) Pse është kërkimi veçanërisht i rëndësishëm për gratë e burgosura?

Shqyrtoni fushat e kërkimit të identifikuar në kapitullin 4.2 të Manualit të UNODC-së dhe diskutoni rreth mënyrës se si mund t'ju ndihmojë ky kërkim në planifikimin e punës tuaj.

Aktivitet për pjesëmarrësit

Moduli 12: Masat alternative të burgimit

Në formën e diskutimit në grup të vogël, identifikoni problemet specifike, nevojat dhe vulnerabilitetin e grave kundërvajtëse dhe problemet më të zakonshme që shkaktojnë burgosjen e grave. Mbani parasysh standardet dhe normat që ju janë caktuar nga moderatori.

Bëni një listë me ndërhyrjet dhe masat alternative që u japin përgjigje këtyre problemeve, çështjeve, nevojave dhe vulnerabiliteteve, bazuar nga standardet dhe normat.

Cilat masa mund të merren brenda kuadrit ligjor ekzistues nga institucioni juaj ose nga institucione të tjera shtetërore?

Cilat masa kërkojnë reformë legjislative?

Shtojca II. Pyetjet dhe përgjigjet e testit

- A. Çelës i përgjigjeve për pyetjet e testit
- B. Pyetësor për modulin 1: Trajtimi i diskriminimit ndaj grave të burgosura dhe kundërvajtëse
- C. Pyetësor për modulin 2: Pranimi, regjistrimi dhe shpërndarja
- D. Pyetësor për modulin 3: Kujdesi shëndetësor
- E. Pyetësor për modulin 4: Siguria dhe mbrojtja
- F. Pyetësor për modulin 5: Kontakti me botën e jashtme
- G. Pyetësor për modulin 6: Rehabilitimi i të burgosurve
- H. Pyetësor për modulin 7: Gratë shtatzëna dhe gratë me fëmijë në burg
- I. Pyetësor për modulin 8: Kategoritë e veçanta të grave të burgosura
- J. Pyetësor për modulin 9: Përgatitja për lirim dhe mbështetja pas lirimit
- K. Pyetësor për modulin 10: Personeli që punon me gratë e burgosura
- L. Pyetësor për modulin 11: Kërkimi, planifikimi dhe vlerësimi
- M. Pyetësor për modulin 12: Masat alternative të burgimit

A. Çelës i përgjigjeve për pyetjet e testit

Pyetja	Moduli											
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
a.	E vërtetë	E vërtetë	E rreme	E vërtetë	E rreme	E rreme	E rreme	E rreme	E rreme	E rreme	E rreme	E rreme
b.	E rreme	E rreme	E rreme	E rreme	E rreme	E vërtetë	E vërtetë	E vërtetë	E rreme	E vërtetë	E vërtetë	E vërtetë
c.	E rreme	E rreme	E vërtetë	E rreme	E vërtetë	E vërtetë	E vërtetë	E vërtetë	E vërtetë	E rreme	E rreme	E vërtetë
d.	E vërtetë	E vërtetë	E vërtetë	E vërtetë	E vërtetë	E rreme	E rreme	E vërtetë	E vërtetë	E rreme	E vërtetë	E rreme
e.	E rreme	E vërtetë	E rreme	E rreme	E vërtetë	E vërtetë	E rreme	E rreme	E vërtetë	E vërtetë	E vërtetë	E rreme
f.	E rreme	E rreme	E vërtetë	E vërtetë	E rreme	E vërtetë	E vërtetë	E vërtetë	E vërtetë	E rreme	E vërtetë	E vërtetë
g.	E vërtetë	E rreme	E rreme	E rreme	E rreme	E rreme	E rreme	E rreme	E vërtetë	E vërtetë	E rreme	E vërtetë
h.	E vërtetë	E vërtetë	E vërtetë	E rreme	E vërtetë	E rreme		E vërtetë	E rreme	E rreme	E rreme	
i.	E rreme	E vërtetë	E vërtetë	E vërtetë	E vërtetë	E rreme		E rreme	E rreme	E rreme	E rreme	
j.	E vërtetë	E vërtetë	E vërtetë	E vërtetë	E vërtetë	E rreme		E vërtetë	E rreme	E vërtetë	E vërtetë	
k.			E vërtetë	E vërtetë	E vërtetë	E vërtetë						
l.			E vërtetë		E rreme	E vërtetë						
m.			E rreme			E rreme						
n.			E rreme			E vërtetë						
o.			E vërtetë									
p.			E vërtetë									
q.			E vërtetë									
r.			E rreme									
s.			E vërtetë									
t.			E vërtetë									
u.			E vërtetë									
v.			E rreme									

B. Pyetësor për modulin 1: Trajtimi i diskriminimit ndaj grave të burgosura dhe kundërvajtëse

	<i>E vërtetë</i>	<i>E rreme</i>
a. Rregullat Mandela e ndalojnë në veçanti diskriminimin me bazë gjinore.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b. Ekzistenca e rregullave të veçanta të pranimit për gratë është diskriminuese.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c. Trajtimi i veçantë i grave përbën diskriminim ndaj burrave.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
d. Ofrimi i dietave sipas besimit fetar nuk është diskriminues.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
e. Gratë nuk janë kurrë të dhunshme dhe nuk kanë nevojë për siguri të lartë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
f. Është diskriminuese nëse burrat nuk lejohen të mbikëqyrin gratë e burgosura.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
g. Disa forma të diskriminimit (përveç atij gjinor) ndikojnë te gratë dhe vajzat e burgosura më shumë se te burrat e burgosur.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
h. Gratë oficere mund të jenë fajtores për diskriminim ndaj grave të burgosura.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
i. Burrat oficerë janë gjithmonë fajtores për diskriminim ndaj grave të burgosura.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
j. Vajzat e burgosura kanë nevojë për më shumë mbrojtje ndaj diskriminimit sesa gratë e rritura.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

C. Pyetësor për modulin 2: Pranimi, regjistrimi dhe shpërndarja

	<i>E vërtetë</i>	<i>E rreme</i>
a. Kërkesat për identitetin personal për burrat dhe gratë e burgosura janë të njëjta.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b. Kërkesat ligjore për burrat dhe gratë e burgosura që do të pranohen në një burg janë të ndryshme.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c. Nuk është e nevojshme që çdo informacion të shënohet në regjistër; informacioni mund tëshënohet diku tjetër.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
d. Identiteti i fëmijëve duhet të mbahet konfidencial.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
e. Koha e pranimi dhe lirimit duhet të shënohet në regjistër.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
f. Nëse një nënë nuk pranon të japë informacion për fëmijët e saj, ajo duhet të detyrohet ta bëjë këtë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
g. Nëse një grua e burgosur nuk paraqitet në burg me fëmijët e saj, institucioni nuk mban përgjegjësi ndaj fëmijëve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
h. Të gjithë të burgosurit ndihen të pafuqishëm në kohën e pranimi; por gratë mund të ndihen edhe më të pafuqishme sepse shoqëria pret që ato të kujdesen për fëmijët.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
i. Kontakti me familjen në kohën e pranimi është i rëndësishëm për të gjithë, por akoma më i rëndësishëm për gratë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
j. Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet në mënyrë që gratë e burgosura të pranuar të marrin masa për kujdesin për fëmijët e tyre; edhe kur kjo kërkon mungesë të përkohshme në institucion, me ose pa shoqërues.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

D. Pyetësor për modulin 3: Kujdesi shëndetësor

Problemet e përgjithshme të kujdesit shëndetësor

	<i>E vërtetë</i>	<i>E rreme</i>
a. Kërkesa për të përcaktuar praninë e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme është përcaktuar në Rregullat Mandela.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b. Rregullat e Bangkokut kërkojnë që të gjitha gratë e pranuar të testohen për HIV.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c. Nëse një grua do të ekzaminohet nga një doktor, duhet të jetë e pranishme edhe një grua e personelit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
d. Të burgosurit duhet të ekzaminohen nga një mjek burgu menjëherë pas pranimit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
e. Të burgosurit mund të vendosen në dhoma fjetjeje ndërkohë që presinekzaminimin e tyre mjekësor.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
f. Informacione dhe masa për kujdesin shëndetësor parandalues kërkohen nga Rregullat e Bangkokut por jo nga Rregullat Mandela.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
g. Masa të veçanta, si depistimi për kancer të gjirit dhe PAP testet kërkohen nga Rregullat Mandela.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
h. Edhe fëmijët që pranohen me nënat e tyre duhet të kryejnë ekzaminim mjekësor gjatë pranimit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
i. Standardi i kujdesit shëndetësor për të burgosurit dhe fëmijët duhet të jetë të paktëni barabartë me standardin e komunitetit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
j. Kujdesi i veçantë, përfshirë kujdesin përpara dhe pas lindjes, dhe kujdesin për fëmijët përcaktohet në Rregullat Mandela.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
k. Marrja në konsideratë e mundësisë për abuzim seksual duhet të jetë pjesë eekzaminimit gjatë pranimit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
l. Personeli mjekësor gjatë pranimit duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë probleme të shëndetit mendor kur pranojnë gratë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Problemet e veçanta të kujdesit shëndetësor

	<i>E vërtetë</i>	<i>E rreme</i>
m. Standardet ndërkombëtare kërkojnë praninë e psikiatrit në burg.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
n. Të burgosurit me aftësi të kufizuar mendore mund të mbahen në një pjesë të veçantë të burgut.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
o. Të burgosurit me sëmundje të shëndetit mendor duhet të mbikëqyren nga profesionistë të kualifikuar të kujdesit shëndetësor.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
p. Duhet të disponohen programe të individualizuara të trajtimit për gratë me nevoja për kujdes të shëndetit mendor.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
q. Programet e veçanta për trajnimin e grave se si të parandalojnë transmetimin e HIV/AIDS nga nëna te fëmija janë të detyrueshme.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
r. Gratë nuk kanë nevojë për programe të veçanta për parandalimin e abuzimit me drogën, sepse varësia është e njëjtë si për gratë ashtu edhe për burrat.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
s. Programet për parandalimin e vetëvrasjes të hartuara posaçërisht për gratë janë të detyrueshme.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
t. Gratë rrezikojnë më shumë të vetëlëndohen sesa burrat në burgje.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
u. Gratë shtatzëna kanë nevojë për programe të veçanta në lidhje me abuzimin me drogën.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
v. Kultura nuk është problem kur bëhet fjalë për kujdesin shëndetësor.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

E. Pyetësor për modulin 4: Siguria dhe mbrojtja

	<i>E vërtetë</i>	<i>E rreme</i>
a. Sistemet disiplinore janë të nevojshme për të garantuar respektimin e të drejtave të njeriut.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b. Institucionet që respektojnë të drejtat e njeriut nuk përdorin kurrë forcën kundër të burgosurve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c. Siguria dhe mbrojtja janë e njëjta gjë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
d. Përdorimi i instrumenteve të shtrëngimit ndonjëherë është i nevojshëm dhe nuk përbën gjithmonë shkelje të të drejtave të njeriut.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
e. Secili institucion duhet të krijojë politikën e tij për përdorimin e prangave.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
f. Të burgosurit duhet të marrin informacione të detajuara me shkrim për rregullat dhe rregulloret e burgut gjatë pranimit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
g. Gratë shtatzëna mund të vendosen në izolim për periudha të shkurtra kohore.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
h. Një grua që ushqen fëmijën me gji duhet të lejohet ta mbajë fëmijën me vete nëse vendoset në izolim.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
i. Kontrolli i grave duhet të kryhet vetëm nga gratë oficere.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
j. Duhet të ekzistojë një sistem për të shqyrtuar dhe trajtuar si duhet pretendimet e grave të burgosura për abuzim.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
k. Ata që hetojnë pretendimet e grave të burgosura për abuzim duhet të jenë të pavarur nga sistemi i burgut.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

F. Pyetësor për modulin 5: Kontakti me botën e jashtme

	<i>E vërtetë</i>	<i>E rreme</i>
a. Ankesat e të burgosurve drejtuar personave me autoritet, si për shembull gjyqtarët, inspektorët e burgjeve dhe organet e të drejtave të njeriut duhet të censurohen nga institucioni.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b. Vizitat e familjarëve dhe miqve janë privilegj, jo e drejtë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c. Aksesit në media, si për shembull gazeta, televizion ose radio është një e drejtë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
d. Të burgosurit kanë të drejtë të adhurojnë dhe të kenë lidhje me një përfaqësues të kualifikuar të besimit të tyre.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
e. Të burgosurit kanë të drejtë të refuzojnë adhurimin e ndonjë besimi, dhe të refuzojnë vizitat e përfaqësuesve fetarë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
f. Të burgosurit nuk duhet të njoftohen menjëherë për vdekjen e një personi të familjes në komunitet, sepse kjo gjë do t'i mërzhiste.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
g. Vizitat bashkëshortore janë kriter i Rregullave Mandela.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
h. Kur vizitat bashkëshortore lejohen, gratë duhet të kenë të njëjtat privilegje si burrat.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
i. Ambientet e vizitorëve duhet të jenë sa më të rehatshme dhe të krijojnë një përvojë pozitive takimi.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
j. Të arrestuarit kanë të drejtë të njoftojnë familjarët e tyre menjëherë për arrestimin e tyre.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
k. Të arrestuarit duhet të kenë të drejtë për të diskutuar në mënyrë konfidenciale me përfaqësuesit e tyre ligjorë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
l. Institucionet nuk janë përgjegjëse për t'i ndihmuar të burgosurit që të vizitojnë me familjarët që ndodhen larg, dhe në veçanti me fëmijët e grave të burgosura.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

G. Pyetësor për modulin 6: Rehabilitimi i të burgosurve

	<i>E vërtetë</i>	<i>E rreme</i>
a. Qëllimi i burgosjes është t'i mësojë të burgosurit si të sillet në burg.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b. Është e rëndësishme që i gjithë informacioni për të burgosurit të jetë në një dosje të vetme në institucion.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c. Klasifikimi i ndan të burgosurit bazuar te rreziku dhe nevoja	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
d. Gratë zakonisht janë të burgosura me rrezik të lartë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
e. Izolimi mendohet se është më i vështirë për gratë se për burrat.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
f. Gratë e burgosura shpesh janë viktimizuar nga burrat përpara ardhjes në burg.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
g. Programet unike që trajtojnë problemet gjinore nuk janë të nevojshme.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
h. Mes moduleve duhet të përzihen klasifikime të ndryshme për të balancuar rrezikun në institucion.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
i. Në afrim të përfundimit të dënimit të të burgosurit duhet të përgatiten plane programesh individuale bazuar në një studim të kujdesshëm të të burgosurit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
j. Nuk është nevoja që privilegjet të përkufizohen mirë, të gjithë i dinë ato.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
k. Programet arsimore janë të detyrueshme për analfabetët dhe të rinjtë e burgosur.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
l. Programet kulturore dhe zbavitëse sensitive ndaj nevojave të të gjitha grave, përfshirë ato që janë përpara lindjes ose pas lindjes, janë një kriter i Rregullave të Bangkokut.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
m. Programet e posaçme për gratë që kanë vuajtur abuzim seksual nuk janë të nevojshme.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
n. OJQ-të dhe të tjerët që mund të ndihmojnë me riintegrimin e të burgosurit duhet të nxiten që të vijnë në institucion gjatë dënimit të të burgosurit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

H. Pyetësor për modulin 7: Gratë shtatzëna dhe gratë me fëmijë në burg

	<i>E vërtetë</i>	<i>E rreme</i>
a. Të gjitha nënave të reja dhe të burgosurave shtatzënë duhet t'u jepet qumësht formule për fëmijë falas për t'i nxitur ato që të mos ushqejnë fëmijët me gji.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b. Për gratë e burgosura shtatzëna duhet të ketë një program për shëndetin dhe dietën.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c. Për gratë shtatzëna, foshnjat, fëmijët dhe nënat që ushqejnë fëmijët me gji duhet të ekzistojnë programe të posaçme ushtrimesh.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
d. Gratë që kanë lindur, por që nuk i kanë foshnjat me vete, nuk kanë nevojë për vëmendje të veçantë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
e. Vendimet për t'i lejuar fëmijët të qëndrojnë me nënat duhet të mbështeten në interesat më të mira të nënës dhe të babait.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
f. Gratë me fëmijë duhet të kenë sa më shumë kohë për të kaluar me fëmijët.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
g. Fëmijët që janë në burg me nënat e tyre janë po ashtu të burgosur dhe duhet të trajtohen si të tillë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

I. Pyetësor për modulin 8: Kategoritë e veçanta të grave të burgosura

	<i>E vërtetë</i>	<i>E rreme</i>
a. Shtetasit e huaj duhet të vuajnë dënimin që u është dhënë përpara se të lejohen të kthehen në shtëpi.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b. Fëmijët e shtetaseve të huaja duhet të dërgohen në shtëpi nëse kjo gjë është në të mirë të fëmijës dhe në konsultim me nënën.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c. Gratë e pakicave shpesh ndeshen me forma të veçanta diskriminimi dhe mund të kenë nevojë për mbrojtje ose mbështetje të veçantë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
d. Gratë në paraburgim hasin një rrezik më të madh për abuzim se gratë e burgosura ose burrat.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
e. Nuk është e nevojshme që të burgosurat e padënuara të qëndrojnë të ndara nga të burgosurat e zakonshme, zakonisht ato e njohin njëra-tjetrën.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
f. Të burgosurit e padënuar mund të veshin rrobat e tyre.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
g. Të burgosurit e padënuar gjykimin duhet të punojnë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
h. Të burgosurit e padënuar mund të vizitohen dhe të trajtohen nga mjeku i tyre me shpenzimet e tyre.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
i. Të burgosurit e padënuar nuk kanë të drejta të veçanta për sa i përket avokatëve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
j. Shtetasit e huaj duhet të kenë mundësinë që të komunikojnë me përfaqësuesit e tyre diplomatikë ose konsullorë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

J. Pyetësor për modulin 9: Përgatitja për lirim dhe mbështetja pas lirimit

	<i>E vërtetë</i>	<i>E rreme</i>
a. Planifikimi për lirimin e një të burgosuri në komunitet bëhet më mirë në fund të dënimit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b. Përgjegjësia për të ndihmuar të burgosurin gjatë lirimit të tij në komunitet i takon tërësisht institucionit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c. Marrëdhëniet familjare të ruajtura mirë gjatë kohës në burg janë të dobishme kur planifikoni lirim.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
d. Institucionet qeveritare nuk mund t'i përmbushin të gjitha nevojat e të burgosurit të liruar.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
e. Edhe OJQ-të dhe pjesët e tjera të shoqërisë mund të ndihmojnë me përshtatjen pas lirimit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
f. Institucioni duhet ta përgatisë të burgosurin për lirim duke përdorur lejen për në shtëpi, shtëpitë e rehabilitimit dhe programet e tjera të krijuara për të ndihmuar me kalimin në jetën në komunitet.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
g. Gratë kanë disa nevoja të ndryshme nga burrat kur lirohen nga burg.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
h. Detyra e burgut përfundon kur i burgosur del nga dera.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
i. Popullsia e burgjeve të hapura duhet të jetë shumë e madhe.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
j. Një madhësi e arsyeshme për burgjet është 2000 të burgosur.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

K. Pyetësor për modulin 10: Personeli që punon me gratë e burgosura

	<i>E vërtetë</i>	<i>E rreme</i>
a. Forca, shëndeti dhe shkathhtësia janë karakteristikat e një oficeri burgu.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b. Duhet të ekzistojnë programe menaxheriale për të parandaluar dhe për të trajtuar diskriminimin me bazë gjinore të grave të personelit nga gratë ose burrat.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c. Gratë e personelit nuk kanë nevojë për akses të njëjtë në trajnime për sensitivitetin ndaj gjinisë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
d. Oficerët burra mund të hyjnë në burgun ose në zonën e grave vetëm, herë pas here, për të ruajtur rendin dhe disiplinën.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
e. Personeli duhet të trajnohet përpara se të fillojë detyrën në një burg.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
f. Nuk është e rëndësishme që gratë të kenë detyra të larta për sa kohë që numri i tyre në menaxhimin e grave të burgosura në pozicione më të ulëta është i mjaftueshëm.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
g. Personeli i burgut ka nevojë për trajnim për të identifikuar rrezikun e vetëlëndimit dhe vetëvrasjes.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
h. HIV/AIDS është një problem serioz, por është njësoj si për gratë ashtu edhe për burrat.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
i. Nuk ka nevojë për personel të specializuar nëse oficerët e burgut janë të gatshëm të bëjnë punën e tyre.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
j. Trajnimi i vazhdueshëm pas fillimit të punësimit dhe pas caktimit nënjë institucion është i rëndësishëm për ata që punojnë me gratë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

L. Pyetësor për modulin 11: Kërkimi, planifikimi dhe vlerësimi

	<i>E vërtetë</i>	<i>E rreme</i>
a. Nevojat unike të grave të burgosura kuptohen drejt.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b. Karakteristikat kriminale të grave kundërvajtëse nuk njihen mirë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c. Nevojat e grave për riintegrim në shoqëri janë njësoj me ato të burrave.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
d. Është e rëndësishme që politikëbërësit të marrin informacione faktike.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
e. Kërkimi është i dobishëm vetëm kur dikush i përdor rezultatet e tij për të marrë vendime.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
f. Gjinia mund të luajë një rol të rëndësishëm gjatë marrjes së vendimit se cilat shkelje janë kryer ngagratë krahasuar me burrat.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
g. Nxitja e kërkimit është përgjegjësi vetëm e universiteteve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
h. Botimi i rezultateve të kërkimit nuk është i rëndësishëm.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
i. Çdo program do të zvogëlonte mundësinë e përsëritjes së shkeljes.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
j. Ndikimi dytësor i burgosjes së grave është më i madh se për burrat.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

M. Pyetësor për modulin 12: Masat alternative të burgimit

	<i>E vërtetë</i>	<i>E rreme</i>
a. Shumë gra kryejnë krime të dhunshme dhe përbëjnë rrezik për publikun.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b. Shumë gra kundërvajtëse janë viktime të dhunës me bazë gjinore, kanë nevoja për kujdes për shëndetin mendor ose varësi nga substancat dhe kërkojnë ndihmë, mbështetje dhe trajtim.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c. Paraburgimi i grave mund të ketë një ndikim të konsiderueshëm dhe të dëmshëm te fëmijët dhe familjarët e tyre, veçanërisht nëse ato janë kujdestaret e vetme ose kryesore të fëmijëve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
d. Gratë mund të mbahen në kujdestari mbrojtëse për t'i mbrojtur ato nga dhuna, edhe nëse ato nuk e kërkojnë shprehimisht këtë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
e. Gratë që abuzojnë me drogën përbëjnë rrezik për shoqërinë dhe nuk kualifikohen për masa alternative ose alternativa të dënimit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
f. Në rastet e shkeljeve të rënda ose me dhunë ku një grua përbën një rrezik të vazhdueshëm, mund të merren parasysh edhe dënimet në burg ose në institucione të tjera edhe pse ajo është shtatzënë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
g. Rregullat e Bagkokut i nxitin Shtetet që t'i japin mundësinë gjykatave të tyre që të marrin në konsideratë faktorët specifikë lehtësues dhe rrethanat që lidhen me gjininë kur japin dënimet për gratë kundërvajtëse.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Shtojca III. Trajnimi i trajnuesve: material informues

- A. Karakteristikat e nxënësve të rritur
- B. Faktorët që ndikojnë në ritmin e të mësuarit
- C. Mënyrat e të mësuarit
- D. Teknikat efikase të mësimdhënies
- E. Elementet e procesit të të mësuarit
- F. Parimet e trajnimit efikas
- G. Roli i moderatorit
- H. Përgatitja për të dhënë mësim
- I. Fillimi dhe përfundimi i çdo dite mësimi

A. Karakteristikat e nxënësve të rritur

Përvoja. Të gjitha mësimet e reja për të rritur bazohen në atë që ata e dinë që më parë. Të rriturit kanë më shumë përvojë, tek e cila mund të mbështeten, sesa fëmijët. Ata mund të kenë pikëpamje dhe opinione të caktuara. Kjo është veçanërisht e vërtetë duke pasur parasysh temën e kësaj kurrikule. Ata sjellin në klasë interesa, qëndrime, arsim, moshë dhe përgjegjësi e shqetësime të ndryshme. Bazuar në përvojën e tyre të mëparshme, ata mund të kenë aftësi të konsiderueshme për ta ndihmuar moderatorin, duke qenë se janë burime të mirinformuara, gjatë diskutimit të aspekteve të ndryshme të materialit të kursit. Do të ishte e dobishme që të merreshin shembuj nga pjesëmarrësit për përvojat e tyre me këtë temë. Të rriturit mund të sjellin në trajnim edhe ide të pa mbështetura në fakte, bazuar në përvojën e tyre. Duke përdorur qasjen lehtësuese, mund t'i zbuloni këto ide dhe t'i zbusni ato që në fillim të seancës. Pikëpamjet e pjesëmarrësve nuk mund të trajtohen si pa vlerë dhe duhet të trajtohen me respekt.

Koncepti i pavarur për veten. Në krahasim me fëmijët, të rriturit janë më autonomë, të sigurt në vetvete dhe e dinë çfarë duan dhe çfarë besojnë, dhe e kanë veten në kontroll. Ata vendosin vetë se çfarë është e rëndësishme për t'u mësuar dhe po ashtu kontrollojnë vetë të nxënit. Atyre u pëlqejnë ambientet demokratike, bashkëpunuese dhe që nxisin pjesëmarrjen. Përdorni teknika që i lejojnë të rriturit t'i mësojnë këto koncepte në mënyrë të pavarur.

Lidhja me jetën reale. Të rriturit mësojnë atë që duan të mësojnë, atë që u intereson dhe atë që mendojnë se do t'u shërbejë në jetë. Përdorni shembuj dhe materiale trajnimi që janë të rëndësishme për pjesëmarrësit. Sa më shumë të lidhet procesi mësimor me jetën e tyre, aq më të motivuar për të mësuar do të jenë ata. Lërnini t'i kontrollojnë vetë ushtrimet dhe rastet studimore, dhe miratoni rëndësinë e zgjedhjeve të tyre. Kjo është pjesërisht arsyeja se pse në kurrikul përdoren raste studimore dhe diskutime bazuar në përvojat praktike.

Orientimi për zgjidhjen e problemeve. Zakonisht, të rriturit hyjnë në klasë sepse e kuptojnë se ka një mungesë në dijet e tyre dhe kanë vendosur ta plotësojnë këtë mungesë. Ata duan informacionet dhe aftësitë që mund të zbatohen në botën reale. Ata e konsiderojnë mësimin si një përgjigje për një problem dhe si një aktivitet që drejtohet nga objektivat. Ata mund të mos kenë interes për mësimin për hir të mësimin. Tregojuni se si mund të lidhet një koncept ose një mësim menjëherë me përvojat e tyre kur punojnë me gratë e burgosura dhe kundërvajtëse.

Pranimi i kolegëve. Të rriturit mësojnë më mirë nga personat me moshë dhe prejardhje të ngjashme. Nxitini të ndajnë përvojat me njëri-tjetrin. Të rriturit kanë nevojë për shoqërim dhe pranim, prandaj jepuni mundësi të shumta për të ndarë me të tjerët në grup dijet dhe përvojat e tyre në lidhje me temën.

Presin të respektohen. Të rriturit mësojnë kur trajtohen me respekt për aftësitë, përvojën dhe idetë e tyre. Trajtojini si të barabartë, si njerëz që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe të mësuarit e tyre. Pranoni përvojën e gjerë që sjell secili në grup dhe jepuni mundësinë që t'i shprehin mendimet e tyre lirshëm. Dëgjojini me respekt përvojat e tyre gjatë punës me gratë e burgosura dhe kundërvajtëse.

Ritmi individual. Të rriturit mësojnë me ritme të ndryshme, sipas nivelit të tyre arsimor, personalitetit dhe mënyrës së të mësuarit. Moderatorët duhet të lejojnë që secili të ketë ritmin e vet të të mësuarit.

B. Faktorët që ndikojnë në ritmin e të mësuarit

Ambienti. Ndryshimi, zhurma, temperatura dhe vendosja e karrigeve mund të ndikojnë në procesin e të mësuarit. Të qëndruarit në një karrige të fortë për orë me radhë pa ndërveprim do ta ngadalësojë ndjeshëm procesin mësimor. Të rriturit zakonisht lëvizin dhe përfshihen në aktivitete të ndryshme gjatë një dite. Mos harroni, shumica e të rriturve nuk janë mësuar të rrinë ulur në karrige gjithë ditën dhe kjo gjë mund t'i lodhë shumë. Përdorni grupe të vogla, grupe dyshe, diskutime dhe teknika të tjera për të mbajtur gjallë interesin e grupit dhe për të pasur variacion.

Sociologjikë. Me kalimin e kohës, aftësitë e të rriturve për vëzhgim dhe arsyetim forcohen. Kjo aftësi për të vëzhguar, menduar dhe analizuar do të thotë se në arsimimin e të rriturve të gjithë janë nxënës dhe të gjithë janë mësues. Përdorni sa më shumë diskutimet në grup, në vend që t'i izoloni njerëzit nga njëri-tjetri me ushtrime me laps e letër. Përdorni grupet e vogla ose dyshe. Diskutimet në grup i ndihmojnë të rriturit që të mësojnë duke zbuluar.

Fizikë. Shëndeti i përgjithshëm, niveli i përgatitjes fizike, nivelet e energjisë - të gjitha këto ndikojnë në aftësinë e njerëzve për të mësuar. Shumica e njerëzve kanë më pak energji pasdite sesa në mëngjes. Njerëzit që flasin dhe që rrinë në këmbë gjithë ditën lodhen më shumë kur qëndrojnë ulur. Aktivitetet duhet të pasqyrojnë ndryshimet në gjendjen fizike të pjesëmarrësve. Disa të rritur mund të kenë probleme me dëgjimin, shikimin ose disa probleme të tjera fizike që duhet të merren parasysh. Bëjeni ambientin e mësimin sa më fleksibël në mënyrë që nevojat e tyre të përmbushen.

Intelektualë dhe të lidhur me përvojën.

Të rriturit mësojnë më mirë përmes zbulimit. Testet kanë vërtetuar se të rriturit mbajnë mend:

- 10 për qind të asaj që lexojnë;
- 20 për qind të asaj që dëgjojnë;
- 30 për qind të asaj që shikojnë;
- 50 për qind të asaj që shikojnë dhe dëgjojnë;
- 80 për qind të asaj që thonë;
- 90 për qind të asaj që thonë dhe bëjnë;

Shfaqja e aftësive, lehtësimi i diskutimeve interaktive dhe aktiviteteve në tavolinë dhe përdorimi i rasteve studimore dhe lojës me role janë mënyra për t'i angazhuar në mënyrë aktive nxënësit përtej përdorimit të leksioneve.

Ndonjëherë, diskutimet mund të marrin një drejtim tjetër, ku disa pjesëmarrës dëshirojnë të shprehin mendimet e tyre, të ndajnë përvojat ose të bëjnë një pushim kur tema bëhet shumë emocionale ose ngjall kujtime të vështira nga përvoja të shkuara. Instruktori duhet të tregohet i ndjeshëm ndaj këtyre emocioneve.

C. Mënyrat e të mësuarit

Ekzistojnë tre mënyra bazë që informacioni të mbetet në kujtesë: pamore (mëso duke parë), dëgjimore (mëso duke dëgjuar) dhe kinestetike (mëso duke bërë). Shumica e njerëzve kanë një mënyrë mbizotëruese të mësuarit, por disa kanë një ekuilibër midis dy ose madje edhe të tre mënyrave. Shumë studentë i dinë preferencat e tyre, gjë që i ndihmon ata të mësojnë më me efikasitet. Në tabelën më poshtë jepet një përmbledhje e karakteristikave të tre mënyrave.

Pamore	Dëgjimore	Kinestetike
<ul style="list-style-type: none">• Mendja humbet gjatë aktiviteteve verbale• Ka vështirësi në ndjekjen ose mbajtjen mend të udhëzimeve verbale• Shkarravit kot• Preferon të vëzhgojë sesa të marrë pjesë aktive në aktivitetet dhe diskutimet në grup• I pëlqen të lexojë në qetësi• Është i rregullt dhe i organizuar• I kushton vëmendje detajeve• Ka shkrim dore të mirë	<ul style="list-style-type: none">• Shpërqendrohet lehtë• E humb shpejt interesin në demonstrimet pamore• I pëlqejnë aktivitetet me dëgjim• Është aktiv në aktivitetet dhe diskutimet në grup• I pëlqen t'i lexojnë• Preferon të lexojë me zë të lartë sesa në heshtje• Dëgjon muzikë kur studion ose kur bën detyrat e shtëpisë• Mund të ketë shkrim dore të keq	<ul style="list-style-type: none">• Përplas lapsin ose këmbën kur mendon, studion ose jep provimet• I pëlqen të bëjë eksperimente• I pëlqen të ekzaminojë objektet• Përdor tej mase gjestet me duar dhe gjuhën e trupit• Krijon kontakt fizik me njerëzit kur u flet• Nuk i pëlqen leximi• I pëlqejnë aktivitetet praktike• I pëlqen të zgjidhë problemet

- Germëzon mirë
- Memorizon lehtë duke parë figurat dhe diagramet
- Mund të ketë "kujtesë fotografike"
- Zakonisht është i qetë, i turpshëm ose i ndrojtur
- Memorizon lehtë listat dhe sekuencat
- Është mjaft social
- Është i çorganizuar
- Nuk germëzon mirë
- Mund të ketë probleme me memorizimin e listave, numrave e të tjera
- Është social
- E ka të lehtë të shprehë emocionet

Teknikat e ndryshme të mësimdhënies kanë nivele të ndryshme efikasiteti, në varësi të mënyrës së preferuar të të mësuarit të studentëve. Mësimdhënia efikase duhet të përfshijë një sërë metodat mësimdhënieje, të cilat i mbulojnë të tre mënyrat e të mësuarit. Pavarësisht preferencave, studentët duhet të kenë mundësi të barabarta për të mësuar në një mënyrë që për ta është efikase.

D. Teknikat efikase të mësimdhënies

Bazuar në listën e mësipërme të mënyrave të ndryshme të të mësuarit, në tabelën më poshtë renditen disa teknika që sugjerohen për përdorim në klasë me qëllim përmbushjen e nevojave unike që paraqet secila nga tre mënyrat e ndryshme.

Pamore	Dëgjimore	Kinestetike
<ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i fjalëve dhe muzikës për të ngjallur imazhe pozitive • Demonstrimet • Kopjimi i shënimeve • Nxjerrja në pah e ideve kryesore në shënime/libra • Letrat me informacione • Kodimet me ngjyra • Diagramet, fotografitë, skicat, grafikët, hartat • Shiritat e filmave, filmat, televizioni • Hartat e mendjes, akronimet 	<ul style="list-style-type: none"> • Kasetat • Leximi me zë të lartë • Udhëzimet me gojë • Leksionet • Përsëritja e ideve me gojë • Përdorimi i tingujve ritmikë • Poemat, poezitë, fjalët • shoqërizimi • Diskutimet në grup • Muzika, vargjet • Televizioni 	<ul style="list-style-type: none"> • Eksperimentet/puna në laborator • Dramat, aktrimi, loja me role • Lojërat • Zgjidhja e problemeve • Udhëtimet në terren • Mbajtja e shënimeve • Bërja e listave • Mbështetëset, shembuj fizikë • Lidhja e emocioneve me konceptet

Shembujt e mëposhtëm të teknikave duhet të merren në konsideratë për të realizuar seminare trajnimi më interaktive për standardet dhe normat ndërkombëtare në lidhje me gratë dhe burgosjen:

- *Punë të grup të madh (5 veta ose më shumë).* Kjo funksionon më së miri kur detyrat mund të nën ndahen ose kur tema është shumë delikate.
- *Punë në grup të vogël (3-5 veta).* Kjo funksionon më së miri kur rezultati specifik është i thjeshtë dhe jo shumë delikat.

- *Diskutim në grup dysh.* Krijohen grupe shumë të vogla me nga dy veta secili dhe kanë për detyrë të "angazhojnë personin në krah". Ky ushtrim është shumë i shpejtë dhe duhet të përqendrohet në një pyetje të vetme.
- *Metoda akuarium.* Në këtë ushtrim me përgjigje, të gjithë pjesëmarrësit rrinë në rreth. Të nxitur nga një pyetje e moderatorit, secili lëviz në qendër të rrethit dhe i përgjigjet pyetjes. Ky ushtrim mund të jetë i shkurtër dhe mundëson përgjigje të shpejta të individëve përpara të gjithë grupit.
- *Rrathët rrotullues koncentrikë.* Moderatori krijon dy rrathë koncentrikë pjesëmarrësish që qëndrojnë përballë. Çdo pjesëmarrës duhet të ketë një partner. Moderatori u kërkon çifteve që të diskutojnë një pyetje të caktuar për një periudhë të shkurtër kohe. Pastaj, rrethit të jashtëm i kërkohet të rrotullohet dy persona majtas ose djathtas. Partnerët e rinj diskutojnë të njëjtën pyetje, ose një pyetje tjetër.
- *Mollë/Dardhë/Banane.* Moderatorit e identifikon secilin si mollë, dardhë ose banane. Kur moderatorit përmend një nga këto fruta, personat përkatës duhet të ngrihen dhe të ndërrojnë vendet me një person tjetër nga i njëjti frut. Kur përmendet fjala "sallatë", të gjithë duhet të ndërrojnë vendet. Kjo teknikë mund të përdoret për t'i lëvizur njerëzit ose për t'i gjallëruar. Po ashtu ajo është e dobishme në situata kur njerëzit që ulen afër janë të zhurmshëm dhe duhet të zhvendosen, pa fyer askënd.
- *Lojë me role për kontroll imagjinar.* Grupe të vogla ose 3-5 veta është madhësia më e mirë për këtë ushtrim. Secili grup ka për detyrë të shqyrtojë një standard ose grup standardesh për të identifikuar 5 pyetje që duhen bërë për të përcaktuar nëse një standard i caktuar është përmbushur apo jo. Pasi të jenë identifikuar pyetjet, grupit i jepet kohë të intervistojë një person që luan rolin e drejtorit të një institucioni dhe duhet t'i përgjigjet pyetjeve të grupit në mënyrë sa më të arsyeshme. Rolin e drejtorit është mirë ta luajë moderatorit, ose, edhe më mirë akoma, një bashkë moderator, por ky rol mund të luhet edhe nga një pjesëmarrës i zgjedhur.
- *Simulimi.* Simulimi përfshin një numër rrethanash të krijuara me qëllim imitim të realitetit, në këtë rast, ambientit të burgut. Megjithatë i ngjashëm me lojën me role, simulimi është pak më i përgjithshëm dhe shpesh të jep mundësinë për t'i përfshirë më shumë pjesëmarrësit. Simulimet janë të dobishme për të mbledhur perspektiva të ndryshme të përjetuara nga pjesëmarrësit për aspektet e ndryshme që një pyetje ose problemi.
- *Hartëzimi.* Kjo metodë ka për qëllim të paraqesë pyetjet ose rezultat e punës së një grupi. Të gjithë pjesëmarrësit duhet të kenë mundësinë që të shohin zhvillimin e "hartës" dhe të kontribuojnë në këtë zhvillim. Kjo kërkon hapësirë në mur dhe diçka për të ngjitur fletët me ngjyrë në mur në mënyrë të tillë që të mund të lëvizin përreth.

E. Elementet e procesit të të mësuarit

Që trajnimi të jetë sa më efikas ai duhet të përfshijë ndërveprimin, pjesëmarrjen dhe përfshirjen. Në përgatitjen e trajnimit duhet të përdoren të gjitha mënyrat, siç tregohet më poshtë:

- "Atë që e dëgjoj e harroj."
- Atë që e dëgjoj dhe e shikoj e mbaj mend pak."
- "Atë që e dëgjoj, e shikoj dhe për të cilën bëj pyetje ose diskutoj me dikë, filloj ta kuptoj."
- "Për atë që e dëgjoj, e shikoj, e diskutoj dhe e bëj fitoj njohuri dhe aftësi."
- "Atë që ja mësoj një tjetri e njoh thellë."

Procesi i të mësuarit përmban katër elemente të rëndësishme. Këto elemente janë:

- (a) Motivimi;
- (b) Përforcimi;
- (c) Mbajtja mend;
- (d) Përdorimi i materialeve/mësimeve në mjedis real.

1. Motivimi

Pjesëmarrësit duhet të kenë një arsye për t'i mësuar materialet. Mënyra më e mirë për të krijuar motivim është t'u bëni pyetje pjesëmarrësve në grupe të vogla dhe t'i lini të krijojnë motivimin e tyre. Për shembull: "Pse është e rëndësishme për ju mbrojtja e grave dhe fëmijëve të tyre në burg?" "Cilat janë përfitimet për ju dhe institucionin tuaj?" Nëse moderatori mund të krijojë një raport me pjesëmarrësit dhe t'i përgatisë ata për procesin e të mësuarit, kjo gjë krijon motivim. Moderatorët mund t'i motivojnë studentët duke përdorur disa mënyra:

- *Krijojnë një ndjesi ose ton për mësimin.* Moderatorët duhet të përpiqen të krijojnë një atmosferë miqësore dhe të hapur që i tregon pjesëmarrësve se moderatori do t'i ndihmojë që të mësojnë.
- *Përshtatin seriozitetin me përmbajtjen.* Niveli i tensionit duhet të përshtatet në mënyrë që të përmbushë nivelin e rëndësisë së temës që po diskutohet. Nëse materiali është i rëndësishëm së lartë, në klasë duhet të vendoset një nivel më i lartë serioziteti.
- *Krijojnë nivelin e duhur të vështirësisë.* Shkalla e vështirësisë duhet të jetë aq e lartë sa t'i sfidojë pjesëmarrësit, por jo e lartë sa t'i acarojë ata nga mbingarkesa e informacionit. Gjatë mësimdhënies duhet të parashikohet dhe të shpërblehet pjesëmarrja, e cila kulmon me sukses.
- *Të rriturit motivohen edhe nga mundësia për të takuar dhe për t'u shoqëruar me njerëz të tjerë në kontekste të ngjashme.* Një motivues shumë i rëndësishëm për të rriturit është aftësia për rrjetëzim, për të vendosur kontakte dhe për të gjetur burime dhe për të shkëmbyer informacion dhe ide me profesionistë të tjerë.

2. Përforcimi

Përforcimi është një pjesë shumë e rëndësishme e procesit të mësimdhënies/të mësuarit; përmes tij moderatorët nxisin mënyra të sakta sjelljeje dhe performance. Përforcimi duhet të jetë pjesë e procesit të mësimdhënies-të mësuarit për të garantuar sjelljen e duhur. Moderatorët duhet ta përdorin atë rregullisht dhe shpesh në fillim të procesit për t'i ndihmuar studentët që të ruajnë atë që kanë mësuar dhe për t'i nxitur ata që të marrin pjesë në procesin e të mësuarit. Përforcimi përfshin sjelljen verbale dhe jo verbale. Sa herë që dikush përfshihet në një aktivitet, pavarësisht nëse përgjigja është e "saktë", duhet ta falënderoni për kontributin. Kjo është një formë e fuqishme përforcimi dhe krijon përfshirje në një kohë mjaft të shpejtë. Nxënësit që përdorin humor të papërshtatshëm ose shfaqin sjellje negative gjatë diskutimit të temës duhet të dëgjohen dhe të nxitin të marrin në konsideratë pikëpamje të ndryshme, pa i përjashtuar nga biseda. Përforconi pjesëmarrjen e tyre, jo komentet negative.

Më poshtë ndodhet një sugjerim për përforcim në fillim të një seance trajnimiti:

- Sa herë që një pjesëmarrës jep një përgjigje me dëshirën e tij, jepini një letër. Teksa shpërndani letrat, do të ketë edhe të tjerë që duan të marrin një letër dhe kështu do të fillojnë dhe ata të përgjigjen. Vazhdoni derisa të gjithë të kenë të paktën një letër. Në fund të seancës mund të shpërndani dhurata të vogla për çdo person si shpërblim për pjesëmarrjen e tyre dhe letrat krijojnë emocion pasi njerëzit vrasin mendjen se cili është qëllimi i tyre.
- Përforcimi është edhe jo verbal. Përdorni gjeste të hapura dhe mirëpritjeje për të nxitur pjesëmarrjen. Kënaquni me pjesëmarrjen dhe nxitni edhe të tjerët të flasin. Kërkojuni pjesëmarrësve të bazohen te përgjigjet e njëri-tjetrit.

3. Mbajtja mend

Studentët duhet ta mbajnë mend informacionin që kanë marrë gjatë mësimit për të përfutur nga procesi. Nëse pjesëmarrësit e dinë se do t'i përdorin materialet menjëherë pas trajnimit, motivimi për të mbajtur mend informacionin rritet. Gjithashtu ata duhet të kuptojnë dhe të jenë në gjendje të interpretojnë dhe të vënë në zbatim informacionin. Ky perceptim përfshin aftësinë e tyre për të shfaqur zotërimin e informacionit dhe rrit aftësinë e tyre për t'i mbrojtur më mirë gratë viktimë në të ardhmen.

Mbajtja mend e informacionit ndikohet drejtpërdrejt nga sasia e praktikës gjatë procesit të të mësuarit. Moderatorët duhet të theksojnë mbajtjen mend dhe zbatimin. Pasi studentët të shfaqin një performancë të saktë (të dëshiruar), ata duhet të nxitin të praktikojnë që ta ruajnë performancën e dëshiruar. Praktika e ndarë në sesione është e ngjashme me përforcimin e pjesshëm.

4. Përdorimi i materialeve/mësimeve në mjedis real

Transferimi i të mësuarit është rezultat i trajnimit: është aftësia për ta përdorur informacionin e mësuar në kurs, por në një ambient të ri.

Gjithashtu, pjesëmarrësit kanë nevojë të njohin specifikisht rezultatet e tyre mësimore (feedback). Feedback-u duhet të jetë specifik, jo i përgjithshëm. Pjesëmarrësit duhet edhe

të shpërblehen për mësimin. Shpërblimi jo domosdoshmërisht duhet të jetë monetar; ai mund të jetë thjesht një shfaqje e përfitimeve që do të realizohen nga mësimi i materialeve. Në fund, pjesëmarrësit duhet t'i interesojë tema. Interesi lidhet drejtpërdrejt me shpërblimin. Të rriturit duhet të shohin përfitimet e mësimin në mënyrë që të motivohen për të mësuar temën.

Përdorimi i rasteve studimore dhe lojës me role me tema të tilla si intervista me viktimat, do t'i ndihmojë pjesëmarrësit të shohin se si nga përdorimi i teknikave të reja mund të dalin pohime më të sakta dhe më të detajuara dhe më shumë të dhëna në mënyrë që hetuesit të marrin masa.

F. Parimet e trajnimit efikas

Për të qenë trajnues/mësues më efikasë të të rriturve, moderatorët duhet:

Ta bëjnë mësimin të rëndësishëm. Lidheni mësimin me atë që ata e dinë që më parë. Përdorni shembuj realistë që lidhen me moshën, përvojën dhe interesat e pjesëmarrësve policë. Mënyra më e mirë për ta bërë këtë është t'i kërkoni grupit shembuj kur kjo është e nevojshme. Një nga aftësitë më të rëndësishme të një moderatori të mirë është të bëni pyetje, dhe jo thjesht të jepni informacion.

Ti bëjnë njerëzit aktiv. Rregulli i përgjithshëm është se duhet të ketë një ndryshim ritmi ose aktiviteti rreth çdo 20-30 minuta. Të rriturit, veçanërisht policët, janë të mësuar me një shumëllojshmëri aktivitetesh gjatë një dite të zakonshme pune dhe përqendrimi i tyre drejtohet nga kjo shumëllojshmëri.

Të krijojnë mundësi për të vepruar. Loja me role, simulimi, diskutimi, rastet studimore - këto aktivitete sigurojnë një mundësi që njerëzit të praktikojnë teorinë ose aftësitë që sapo kanë mësuar. Përmbledhja e këtyre aktiviteteve krijon mundësinë për feedback dhe përforsim. Disa moderatorë shumë të zotë mund të ndalen te loja me role si pjesë e realizimit të përmbajtjes së seminarit. Kur një pjesëmarrës paraqet një problem ose pyetje, në vend që të japë përgjigjen, moderatori kalon në lojën me role për t'i dhënë pjesëmarrësit një përvojë të menjëhershme të mënyrës se si trajtohet problemi i paraqitur.

Ta zhvillojnë trajnimin në një mjedis jo formal. Përshtatini vendet në mënyrë të tillë që pjesëmarrësit të mund ta shohin dhe të ndërveprojnë lehtë me njëri-tjetrin. Tryezat e rumbullakëta, ato në formë u-je, dhe në formë katrore me hapësirë në mes funksionojnë, në varësi të madhësisë së grupit. Vendosja e karrigeve si në klasë ose në stil kinema është më formale dhe krijon një ambient të përqendruar te moderatori, duke qenë po ashtu më pak efikase në garantimin e realizimit të të mësuarit.

Duke pasur parasysh fokusin e kësaj kurrikule, rëndësinë dhe sensitivitetin e saj, vendosja në stil kinemaje është më pak e përshtatshme. Përdorimi i rasteve studimore dhe ushtrimeve në këtë kurrikulë sugjeron se vendosja më e përshtatshme është në grupe të vogla në tryeza të rumbullakëta, nëse kjo është e mundur.

Të krijojnë variacion dhe humor. Të rriturit mësojnë në raport të drejtpërdrejtë me sasinë e argëtimit. Përdorni ushtrime gjallëruese në mënyrë që njerëzit të ndërveprojnë dhe të lidhen në mënyrë të relaksuar. Mund të duket se çështja e dhunës ndaj grave nuk lë vend për humor, por edhe në një seminar me një përmbajtje kaq serioze ka vend për humor dhe shkurtesje, për sa kohë që respektohet tema dhe humori është i përshtatshëm. Mund ta

përdorni humorin për t'i lidhur njerëzit me njëri-tjetrin, për të prezantuar një temë ose për të kaluar nga një modul në tjetrin.

Të shërbejnë si lehtësues të procesit të të mësuarit. Përpara se t'i thoni ndonjë gjë pjesëmarrësve, pyetini se çfarë dinë ata për temën. Lëroni grupin të punojë. Ju mund të jeni përgjegjës për informacionet e munguara ose gabimet në përgjigje. Drejtojini, mos i shtyni. Udhëzojini dhe nxitini, mos u thoni si të veprojnë.

T'i njoftojnë pjesëmarrësit për objektivat mësimore. Të rriturve nuk u pëlqejnë surprizat gjatë trajnimit, që të mos rrezikojnë të turpërohen apo të kapen të papërgatitur. Shpjegojini me hollësi objektivat dhe sigurohuni që udhëzimet dhe sugjerimet tuaja të kuptohen qartë. Pyetini pjesëmarrësit sa mirë ndihen me proceset që do të përdorni dhe sigurojini se nëse nuk ndihen mirë ata janë gjithmonë të lirë ta "anashkalojnë" atë pjesë të caktuar të trajnimit.

Të japin dhe të kërkojnë feedback. Kërkojuni pjesëmarrësve të japin mendimet dhe idetë e tyre. Çfarë kanë mësuar? Si do ta zbatojnë informacionin në terren, në punën si policë? Cilat gjëra qëkanë mësuar do t'i përdorin menjëherë? Arti i të bërit pyetje është tregues i feedback-ut të shkëlqyer.

Të përdorin përsëritjen. Përsëriteni një ide duke përdorur mënyra të ndryshme të mësuarit. Përsëritja krijon familjarizim dhe familjarizimi krijon komunikim dhe një mundësi më të mirë që pjesëmarrësit ta përdorin informacionin kur të kthehen në punët e tyre.

G. Roli i moderatorit

Roli i moderatorit është të ndihmojë grupin në arritjen e objektivave mësimore për programin e trajnimit. Kjo bëhet përmes një sërë teknikash dhe ky objektiv realizohet gjithashtu nga vetë moderatorit.

Përshtypja që bën moderatorit të pjesëmarrësit është po aq e rëndësishme sa dhe përgatitja dhe përmbajtja e trajnimit. Moderatorit është kanali i komunikimit të mesazhit, prandaj stili i tij ose e saj, paraqitja dhe sjellja ndikojnë në suksesin e programit të trajnimit.

Misioni i moderatorit është të mësojë të tjerët. Ai ose ajo duhet të japë mësim duke drejtuar dhe duke dhënë shembullin e mirë. Moderatorit është gjithmonë duke krijuar, si kur është në qendër të vëmendjes ashtu edhe kur nuk është. Pavarësisht nëse është i vetëdijshëm për këtë apo jo, ai apo ajo është vazhdimisht nën vëzhgimin e pjesëmarrësve dhe ata prirjen të ndjekin shembullin e moderatorit.

Paraqitja e moderatorit duhet të jetë profesionale, e përshtatshme dhe e rehatshme. Nëse grupi duhet të veshë uniformë, edhe për moderatorin do të ishte e përshtatshme një veshje po aq formale.

Moderatorit duhet të krijojë gjatë gjithë kohës një qasje të respektueshme, serioze dhe të përkushtuar ndaj temës duke nxitur kështu një qëndrim të ngjashëm nga ana e pjesëmarrësve.

Roli i moderatorit përfshin:

- T'u thotë të trajnuarve informacione vetëm nëse ata nuk mund t'i gjejnë vetë përgjigjet.

- Të nxisë përsëritjen dhe praktikën që e bëjnë të mësuarit të përhershëm.
- Të kuptojë që qëndrimet nuk mësohen, ato merren.
- T'i përfshijë pjesëmarrësit për të marrë rezultate maksimale.
- Të vlerësojë rezultatet për përmirësim të vazhdueshëm.
- Të përdorë materialet për lexim që plotësojnë dhe përforcojnë të mësuarin.

Moderatori është një prezantues i aftë, i cili merre një sasi përmbajtjeje të zhvilluar paraprakisht dhe ia ofron një klase në mënyrë zbavitëse dhe përfshirëse.

Moderatori zbaton parimet e arsimit të rriturve gjatë mësimdhënies së tij ose të saj. Ai ose ajo e di se njerëzit mësojnë në mënyra të ndryshme dhe është në gjendje të zgjedhë, të planifikojë, të realizojë dhe të vlerësojë efikasitetin e aktiviteteve të caktuara mësimore.

Roli i moderatorit përfshin demonstrimin e përdorimit efikas të një sërë metodash mësimdhënieje dhe demonstrimin e aftësive mësimdhënëse si dëgjimi aktiv, përdorimi i heshtjes, përdorimi i pyetjeve, të mësuarit përmes zbulimit/veprimit, feedback-u, reflektimi dhe përmbledhjet.

H. Përgatitja për të dhënë mësim

Përpara se të filloni një seancë, sigurohuni që i keni të gjitha mjetet dhe pajisjet e nevojshme, dhe ato janë funksionale. Është e këshillueshme që të mbërrini të paktën një orë përpara fillimit të seancës, në mënyrë që të jeni të përgatitur për çdo rast. Më poshtë jepet një listë e mjeteve dhe pajisjeve që mund të nevojiten:

- Bllok shënimesh dhe laps për çdo pjesëmarrës
- Tabela
- Letër A4
- Projektor
- Mprehëse lapsash
- Fletore ushtrimesh për çdo pjesëmarrës
- Etiketa me emrat për secilin pjesëmarrës
- Karrige të rehatshme, nëse është e mundur, dhe një vendosje e karrigeve në mënyrë të përshtatshme
- Salla për ndarje në grupe aty afër ose salla të mëdha ku mund të qëndrojnë të paktën katër grupe të vegjël
- Axhendë për çdo pjesëmarrës
- Pajisje video nëse nevojiten
- Ndriçim i përshtatshëm i sallës
- Këmbalec me letra të mjaftueshme

- Markera me ngjyra
- Ujë dhe gota
- Shënime udhëzuese
- Kopje të materialeve

Jini të përgatitur përpara se të arrijnë pjesëmarrësit. Që nga koha kur mbërrin pjesëmarrësi i parë, duhet të përqendrohni tek ata dhe jo te përgatitja juaj. Kjo është koha për t'i ndihmuar që të ndihen mirë me mjedisin e ri të mësimin.

Merrni një moment për t'u angazhuar në biseda pozitive me veten. Vendosni objektiva mendore për cilësinë e seminarit dhe për ndërveprimin tuaj me pjesëmarrësit. Merrni frymë thellë dhe hapeni mendjen dhe zemrën për një përvojë të mrekullueshme. Ky është çasti për të përsëritur pikat kryesore. Sigurohuni që e dini se si do ta hapni seminarin dhe tregohuni plotësisht të familjarizuar me mënyrën se si doni që të shkojë seminari. Tregohuni të përgatitur për sensitivitetin e veçantë dhe përvojat personale me temën që mund të kenë disa pjesëmarrës.

I. Fillimi dhe përfundimi i çdo dite mësimi

Siç e kemi përmendur, moderatorët nxiten të mbërrijnë çdo ditë përpara pjesëmarrësve. Kjo i jep moderatorit kohë për të përgatitur materialet, për të shpërndarë materialet për pjesëmarrësit, për të rregulluar pajisjet e klasës sipas nevojës, për të testuar pajisjet audiovizuale dhe për të qenë i përgatitur të përshëndesë pjesëmarrësit kur të mbërrijnë.

Në fillim të çdo dite trajnimi, moderatorët nxiten që:

- T'i lënë pjesëmarrësit të prezantojnë veten (në fillim të ditës së parë). Kjo mund të përfshijë emrin, agjencinë dhe vendndodhjen e detyrës, kohëzgjatjen e shërbimit në polici dhe objektivin mësimor personal që kanë për trajnimin.
- Të përshkruajnë dhe të diskutojnë objektivat mësimore për modulën e asaj dite.
- Të pyesin pjesëmarrësit për të parë nëse ka pyetje, probleme ose shqetësime të prapambetura nga moduli apo dita e kaluar.
- T'i orientojnë pjesëmarrësit për programin e planifikuar për modulën ose ditën, përfshirë orarin e pushimeve dhe kohën e planifikuar për mbarimin e ditës/mësimin.
- T'u thonë pjesëmarrësve se ku mund t'i gjejnë tualetet, daljet dhe zonat për pirjen e duhanit (nëse është e përshtatshme).
- T'u kërkojnë pjesëmarrësve që të përmendin një gjë që u ka mbetur në mendje nga dita e kaluar.

Në fund të çdo dite trajnimi, moderatorët nxiten që:

- Të përsërisin mësimet kryesore të ditës. Kjo mund të kryhet në formën e një diskutimi të drejtuar, të shënuar në tabelë, ku vetë pjesëmarrësit identifikojnë pikat kryesore të mësimin të asaj dite/mësimi.

- Të pyesin pjesëmarrësit për të parë nëse ka pyetje, probleme ose shqetësime të prapambetura nga dita/mësimi.
- T'i orientojnë pjesëmarrësit për programin dhe temat që do të mbulohen të nesërmen.
- Sipas rastit, t'u japin pjesëmarrësve një mënyrë për të kontaktuar grupin e instruktorëve pas përfundimit të trajnimit, nëse kanë pyetje të tjera.

Një moderatori i mirë është i përgatitur, i njeh materialet, i dëgjon dhe i respekton individët dhe grupin dhe kërkon gjatë gjithë kohës mundësi për t'i përfshirë aktivisht pjesëmarrësit në procesin mësimor.

Shtojca IV. Informacione për shëndetin mendor dhe problemet që lidhen me të në burgje

- A. Llojet e diagnozave
- B. Simptomat e sëmundjeve mendore
- C. Parandalimi dhe trajtimi i problemeve të shëndetit mendor në burg

A. Llojet e diagnozave

Ekzaminimi shëndetësor pas hyrjes në burg është shumë i rëndësishëm për të evidentuar problemet me shëndetin mendor dhe për të garantuar që gratë e burgosura të marrin terapinë më të përshtatshme dhe vëmendjen më të mirë.

Llojet kryesore të diagnozave përfshijnë ato sëmundje që janë të kontrollueshme me medikamente psikoaktive dhe ato që nuk janë të kontrollueshme. Sipas Manualit të Diagnostikimit dhe Statistikave të American Psychological Society (Shoqata Psikologjike Amerikane), lloji i parë i sëmundjeve përfshin skizofreninë, psikozat, çrregullimin bipolar dhe shumë të tjera. Lloji i dytë përfshin çrregullimet e personalitetit, të cilat mund të jenë kufitar, narcistik, histrionik (kërkon vëmendje të tepruar) ose antisocial (psikopati, mungesë ndjeshmërie dhe nuk ka frikë). Megjithëse këto çrregullime nuk kontrollohen dot me medikamente, disa prej tyre mund të ndihmojnë me simptoma të caktuara.

Në shumë raste të burgosurit kanë probleme të shumta të shëndetit mendor në të njëjtën kohë. Për shembull, një pacient mund të diagnostikohet me vonesa në zhvillim (për shkak të rritjes së çrregullt të trurit) dhe me një sëmundje mendore (mundësisht të shkaktuar nga trauma që ka dëmtuar rritjen e trurit). Ky është rast diagnostikimi të dyfishtë, i cili ndryshon nga diagnostikimi i njëkohshëm (ose që ndodh në të njëjtën kohë). Një shembull i këtij të fundit vërehet te pacientët që kanë një problem me shëndetin mendor si edhe varësi nga droga. Shpesh këto janë të ndërlidhura sepse njerëzit me sëmundje mendore priren të ndërpresin mjekimin dhe fillojnë vetë kurimin me drogë.

Problemet me shëndetin mendor mbizotërojnë në burgje për shumë arsye. Për shembull, historitë traumatike mbizotërojnë te të burgosurit dhe pjesërisht sepse këto çrregullime shkaktajnë një rritje të sjelljeve antisociale që mund të çojnë në shkelje. Ata shfaqin luhatje të humorit, zemërim dhe sjellje armiqësore të cilat mund të jenë ekstreme dhe të paarsyeshme (pa një shkak të dukshëm), madje edhe zemërim shpërthyes (që është vështirë të menaxhohet), të cilat e vështirësojnë jetesën e këtyre njerëzve dhe jetesën bashkë me ta.

Shfaqja e sëmundjes mendore përcaktohet nga dy faktorë kryesorë. I pari është faktori gjenetik. Është zbuluar se një gen i dëmtuar që mund të jetë në familje për breza luan një rol të rëndësishëm në sëmundje si skizofrenia. Kjo prirje nuk mund të ndryshohet, por jo të gjithë njerëzit me këtë prirje shfaqin sëmundje mendore. Faktori i dytë është një ngjarje ose situatë në jetën e të rinjve (në adoleshencë/në fillim të moshës 20 vjeçare) që mund të shkaktojë sëmundje mendore.

Një shembull i një sëmundjeje mendore që ndikon te disa të burgosur është çrregullimi i spektrit të fetusit nga alkooli (FASD). Ai shkaktohet nga kombinimi i konsumit të alkoolit (dhe drogës) nga nëna gjatë shtatzënisë, me stresin dhe keq ushqyerjen. Lobi frontal i trurit të pacientëve me këtë sëmundje, i cili luan një rol të rëndësishëm në personalitetin e një personi, nuk është zhvilluar si duhet. Një simptomë e rëndësishme është konfabulimi: pacientët fillojnë të tregojnë një histori por ngatërrojnë ngjarje dhe ditë të ndryshme në një mënyrë jo koherente që nuk ka kuptim. Është e rëndësishme të kuptohet se ata nuk po gënjejnë, pavarësisht faktit se mund të duket sikur po gënjejnë. Në vend që t'i ndëshkoni, një mënyrë efektive për ta trajtuar këtë çrregullim është t'i ndihmoni që të sistemojnë faktet dhe të krijojnë një tregim koherent. Njerëzit me këtë çrregullim mund të manipulohen dhe të shfrytëzohen nga të tjerët, pasi ata kanë prirjen të veprojnë pa u shqetësuar për pasojat. Ata nuk e pyesin veten se cilat do të jenë pasojat përpara se të veprojnë. Kjo ndodh për shkak të moszhvillimit të duhur të asaj zone të trurit që kupton sjelljen shkakësore.

B. Simptomat e sëmundjeve mendore

Simptoma të ndryshme shfaqen në faza të ndryshme të çrregullimeve mendore. Personeli i burgut duhet t'i njohë problemet më të zakonshme të sjelljes, të cilat janë tregues të problemeve me shëndetin mendor, në mënyrë që të reagojë si duhet dhe në kohë. Është e rëndësishme të shmangen paragjykimet që nuk bazohen në të dhëna shkencore. Për shembull, njerëzit që vuajnë nga depresioni shpesh nuk qajnë. Është e nevojshme të vështroni më tej dhe të përqendrohni në atë që nuk është normale për çdo të burgosur. Sjelljet e mëposhtme janë zakonisht simptoma të sëmundjeve mendore:

- (a) Zemërimi dhe sjellja armiqësore;
- (b) Zemërimi shpërthyes dhe luhatjet e humorit;
- (c) Përqendrimi i ulët, hutimi ose kujtesa e dobët;
- (d) Ripërsëritja e problemeve, pendimeve ose kërcënimeve apo fyerjeve të perceptuara;
- (e) Hipersensitiviteti ndaj zhurmës, dritës etj. hipervigjilenca;
- (f) Moskujdesi për higjienën vetjake;
- (g) Kujtimet e ekzagjeruara të përvojave të mëparshme;
- (h) Reagimi emocional i ekzagjeruar ndaj ngjarjeve, ose e kundërta: mpirja
- (i) Humbja e kohës;
- (j) Izolimi;
- (k) Lëkundjet kur qëndrojnë në këmbë ose ulur;
- (l) Mungesa e kontaktit pamor ose vështrimi në boshllëk;
- (m) Shqetësimet me gjumin: ose gjumë i tepërt ose i pakët;
- (n) Letargjia ose hiperaktiviteti;
- (o) Djersitja, afshet, frymëmarrja e shpejtë dhe e cekët;

C. Parandalimi dhe trajtimi i problemeve të shëndetit mendor në burg

Parandalimi efikas kërkon vëzhgim të vazhdueshëm dhe dokumentim të hollësishëm të historiku mjekësor dhe shoqëror të të burgosurit. Ky dokumentim mundëson krijimin e një profili të qartë të problemeve, i cili ndihmon në zhvillimin e reagimeve sociale/komunitare ndaj problemeve më të mëdha që shkojnë përtej kontekstit të burgut. Përveç informacionit dhe të kuptuarit të simptomave të mundshme të sëmundjes mendore, personeli i burgut duhet t'i kushtojë vëmendje ndryshimeve të sjelljes së të burgosurve, të jetë në dijeni të problemeve të tilla si përvjetori i ngjarjeve traumatike që kanë përjetuar, ose informacioneve të dhëna nga të burgosurit e tjerë.

Personeli i burgut duhet të jetë i trajnuar për të reaguar menjëherë dhe si duhet ndaj incidenteve të shkaktuar nga problemet e shëndetit mendor. Një aspekt kryesor është se personeli i burgut duhet të jetë në gjendje të vëzhgojë të burgosurit e caktuar, të identifikojë simptomat e mundshme ose të përcaktojë nëse një sëmundje mendore ekzistuese është në përkeqësim. Reagimet nga personeli i burgut nuk duhet të përforcojnë sjelljes duke i kapur paniku ose duke përdorur forcën e tepruar, për shkak të mungesës së të kuptuarit ose shqetësimit të tyre emocional. Për shembull, ankthi mund të vërehet kur personi në fjalë fillon të djersijë dhe hapi i parë më i mirë është ta bëni të kontrollojë frymëmarrjen për të ulur ankthin. Të burgosurit e diagnostikuar që më parë me një sëmundje mendore mund të përkeqësohen kur ndërpresin mjekimin.

Gjithashtu, personeli i burgut ka një rol të rëndësishëm për të kontribuar në trajtimin afatgjatë. Kjo shkon përtej garantimit të ndjekjes së terapisë me medikamente të dhëna nga personeli shëndetësor. Personeli i burgut mund t'i ndihmojë pacientët gjatë procesit të rëndësishëm kur ata mësojnë të menaxhojnë reagimet fiziologjike në trup, për shembull duke shëtitur së bashku për t'i qetësuar ose duke ndihmuar me ushtrime të tjera fizike. Personeli i burgut i kualifikuar si duhet mund t'u mësojë pacientëve se çfarë po ndodh në trupin e tyre, për t'i ndihmuar që të menaxhojnë nivelin e stresit dhe të shmangin ataket e panikut. Mësimi i aftësive për reduktimin e stresit, të cilat janë të përshtatshme në aspektin kulturor, mund t'i ndihmojë të burgosurit në menaxhimin dhe lehtësimin e sëmundjes së tyre mendore.

Çdo masë që zbut ndjesinë e pafuqisë të të burgosurit mund të jetë e dobishme. Në të kundërt, mosndjekja e terapisë mund të ketë efektin e kundërt dhe personeli i burgut duhet të tregojë shumë kujdes me këtë. Një teknikë tjetër e dobishme është nxitja e një rutine gjumi, e cila mundëson rregull në përgatitjen dhe rënien në gjumë dhe ndihmon me ngadalësimin e ritmit biologjik që personi të jetë gati për të fjetur. Krijimi i një hapësire të vogël kopshti për të rritur çajra bimorë është një mundësi tjetër e pa kushtueshme, e cila u lejon të burgosurve të pinë një filxhan çaj përpara se të bien për të fjetur. Në shumë raste përfitime kanë sjellë edhe mësimet e meditimit, jogës ose teknikave të tjera për të burgosurit. Me rëndësi janë edhe vëmendja ndaj të ushqyerit, mësimi i ushtrimeve dhe rutinës. Të burgosurit me probleme të shëndetit mendor duhet të kenë ndjesinë e suksesit, pavarësisht se sa e vogël është kjo ndjesi.

1. Reagimet ndaj psikozave dhe iluzioneve

Dëgjimi i zërave, dyshemetë e shndritshme si ujë, tmerri nga gjëra në dukje të parëndësishme, frika nga helmimi, vrasja, lëndimi. Perceptimi i kërcënimeve aty ku nuk ka të tilla. Duhet t'i largoni ata nga çfarëdo që shkakton reagimin e tyre, mos i kundërshtoni dhe mos pohoni, thjesht çojini diku ku ata të ndihen të mbrojtur dhe qetësojini. Ata mund të përjetojnë një ndjeshmëri të shtuar ndaj stimujve të jashtëm (dëgjimi, nuhatja etj.) që mund të rrisë rrezikun për vetëvrasje ose vetëlëndim, për shkak të ndjeshmërisë së shtuar, kujtimit të situatave të shkuara të pakëndshme.

Ekziston një lidhje midis stresit dhe shëndetit mendor të një njeriu. Aroma është një nxitës i fortë (ushqimi, parfumi etj.) i ankthit (p.sh. parfumi i përdhunuesit). Informacioni për aromën përpunohet nga një pjesë qendrore e trurit (sistemi limbik), e cila nuk përdoret për të menduar, ndaj reagimi është i menjëhershëm dhe primitiv. Prisni derisa niveli i stresit të ulet për të shpjeguar se reagimi shkaktohet nga një kujtim, dhe nuk po ndodh aktualisht.

Si ta parandaloni këtë: sigurohuni që pacienti të marrë mjekimin (ta marrë dhe ta gëlltisë); kujdes nga "fshehja në gojë" (fshehja e pilulës në gojë në mënyrë që më vonë ta shesin). Një pilulë (mjekim antidepressant ose psikotropik) nuk bën ndonjë ndryshim të madh, duhen deri në 3 javë që dozat terapeutike të arrijnë në trup. Mund t'u duhet kohë për t'u përmirësuar. Nëse njerëzit dezintoksikohen nga droga, mund të duhen 2 vjet derisa biokimia e trurit të stabilizohet përsëri. Dezintoksimi nga alkooli është i vështirë dhe i rrezikshëm. Përdoruesit e rëndë të kokainës mund të mos e stabilizojnë më kurrë qendrën që rregullon depresionin/lumturinë dhe mund të kenë nevojë për anti depresantë gjatë gjithë jetës. Medikamentet kundër ankthit veprojnë shpejt.

2. Reagimet ndaj vetëlëndimit

Një nga format më të zakonshme është prerja e vetes ose djegia. Kjo gjë i shkakton të burgosurit një lehtësim të jashtëzakonshëm të ngjashëm me euforinë e vrapuesit. Personat që janë tejet të stresuar mësojnë se duke djegur ose duke prerë veten trupat e tyre çlirojnë endorfinën dhe ndihen më mirë. Gjithashtu ata mësojnë nga njëri-tjetri (fenomeni i imitimit). Nëse trauma ka ndodhur në fëmijëri, fëmijët mësojnë të shkëputen (duke mos qenë aty). Kur rriten ata do të zhvillojnë aftësinë të mos ndihen të gjallë, ata janë diku tjetër dhe kjo është shumë e pakëndshme. Kështu duke djegur veten ata ndihen të lidhur me kohën aktuale dhe ndihen të gjallë. Prerja është shumë e rrezikshme, veçanërisht nëse presin një arterie (rrezik biologjik, rrezik për HIV, hepatit C etj. nevojë për ndërhyrje kirurgjikale urgjente për të ndaluar gjakderdhjen.) Përplasja e kokës është më e rrezikshme. Përplasja e përsëritur e kokës në një mur të fortë shkakton dëmtim të trurit dhe vështirësi afatgjata në aftësitë intelektuale.

Ekzistojnë edhe forma të tjera të rrezikshme vetëlëndimi. Disa persona mund të gëlltisnin sende, gjë që mund të jetë shumë e rrezikshme, veçanërisht në rastin e baterive, të cilat duhet të hiqen menjëherë sepse ato mund të çahen brenda trupit duke shkaktuar vdekje. Të tjerë vendosin lidhje rreth qafës, gjë që mund të shkaktojë vdekje, qoftë kjo e paqëllimshme, për shkak të humbjes së vetëdijes. Çrregullimet e të ngrënies janë një problem tjetër i rëndësishëm që haset shpesh te gratë dhe burrat homoseksualë, të cilët mund të praktikojnë urinë ekstreme ose buliminë. Nga ana tjetër, e ngrëna e tepruar mund

të jetë një problem për gratë që kanë pësuar abuzim seksual dhe mund të shoqërohet me higjienë të keqe vetjake. Shkulja e flokëve, pickimi i lëkurës, ngrënia e thonjve derisa të gjakosen janë të gjitha shenja të shqetësimeve mendore dhe përdorimit të drogës (p.sh. amfetaminës, metamfetaminës, krakut).

Ndonjëherë vetëlëndimi përsëritet në një periudhë të caktuar të vitit dhe është e rëndësishme të identifikohet ngjarja që e nxit atë (p.sh. një viktimë e një përdhunimi në grup djeg veten çdo vit kur afrohet ditëlindja e djalit të saj, i cili ishte produkt i përdhunimit). Këto probleme janë edhe ngjitëse, prandaj duhet pasur kujdes që të shmangët fenomeni i "imitimit" në popullsinë më të gjerë të të burgosurve, gjë që mund të rrisë numrin e rasteve të vetëlëndimit dhe vetëvrasjes. Megjithatë, izolimi do të ishte antiproduktiv dhe nuk është përgjigja e duhur.

Mund të jetë e vështirë që problemet të diskutohen, por është e rëndësishme të ruhet qetësia dhe të flitet me njerëzit që lëndojnë veten. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse gjendja është alarmante, sepse në të kundërt sjellja e dëmshme do të përforcohet. Mund të mos jetë e dobishme që të hetohen shkaqet e kësaj sjelljeje dhe do të ishte më efikase që ngjarja të trajtohej shpejt dhe klinikisht dhe ndërhyrja terapeutike të lihej për periudhën pas qetësimit të krizës. Ngjarjet kërcënuese për jetën kërkojnë masa të menjëhershme. Më pas, është e rëndësishme që të zhvillohet një seancë diskutimi, pasi këto situata janë traumatike edhe për personelin e burgut.

Të burgosurit mund të ndihen të pafuqishëm dhe kjo ndjenjë përforcohet nga rutina e burgut. Megjithatë, është e mundur që t'u mësoni atyre si të kontrollojnë disa aspekte të jetës së tyre. Për shembull, personeli mund t'i përfshijë ata në vendimet për veprimtaritë argëtuese ose të artizanatit dhe në organizimin e tyre. Këto programe duhet të përshtaten me kulturën lokale dhe mund të jenë të ngjashme por jo të njëjta nga njëri vend në tjetrin.

Është e rëndësishme dhe me vlerë të identifikohet droga specifike që përdor një e burgosur, pasi kjo gjë tregon llojet e simptomave të dhimbshme që po përpiqet të lehtësojë ajo. Personeli i burgut mund të identifikojë teknika të posaçme për menaxhimin e stresit për të imituar efektet e kategorive specifike të drogave (opiatet, kanabisi, kokaina etj.). Teknikat nuk janë asnjëherë aq efikase sa droga, por ato ndihmojnë dhe nuk kushtojnë. Për shembull, të burgosurit që kanë varësi nga kraku/kokaina duhet të bëjnë shumë ushtrime fizike dhe sport, ndërsa ata që kanë varësi nga opiatet kanë nevojë për teknika relaksimi për të qetësuar ankthin e tyre.

D. Rëndësia e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe edukatës shëndetësore

Gratë e burgosura shpesh kanë nevoja më të mëdha për kujdes shëndetësor parësor krahasuar me burrat. Përveç problemeve shëndetësore specifike për gjininë, gratë, veçanërisht ato nga shtresat në nevojë në aspektin ekonomik dhe social, mund të kenë sëmundje që kanë mbetur të patrajtuara përpara pranimin në burg për shkak të diskriminimit në aksesin në shërbimet e duhura të kujdesit shëndetësor në komunitet.

Shpesh burgu paraqet një mundësi të vyer dhe pikë kontakti për edukim dhe për të ndërhyrë në mënyrat dhe praktikat e rrezikshme të jetesës. Përvoja ka treguar se shumë

gra të burgosura i vlerësojnë mundësitë për të mësuar dhe për të bërë zgjedhje të reja në jetën e tyre për t'i kthyer kurrizin drogës dhe dhunës. Kundërvajtëset më të shëndetshme menaxhohen më lehtë dhe përbëjnë një barrë financiare më të ulët për administratën e burgut.

Gratë që janë pranuar në burg kanë probabilitet më të lartë se burrat për të vuajtur nga probleme të shëndetit mendor, shpesh për shkak të dhunës së mëparshme në familje, abuzimit fizik dhe seksual. Për këtë arsye, kujdesi për shëndetin mendor që ofrohet në burgjet e grave duhet të jetë sensitiv ndaj gjinisë dhe ndërdisiplinor, dhe të marrë parasysh shqetësimin dhe depresionin e shkaktuar nga izolimi, ndarja nga fëmijët, familja dhe komuniteti. Rregulli 12 i Bangkokut thekson shprehimisht se trajtimi duhet të jetë i individualizuar dhe të synojë të trajtojë arsyet që shkaktojnë shqetësim, depresion, si edhe problemet psikiatrike, bazuar në një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse që përfshin këshillimin, mbështetjen psikosociale dhe mjekimin, nëse është e nevojshme.

Realiteti i mjerruar në shumë burgje është që në vend të që të trajtohen shkaqet e problemeve të shëndetit mendor, trajtohen simptomat. Shumë shpesh, në vend të mbështetjes individuale psikosociale dhe edukimit për menaxhimin e simptomave thjesht jepen medikamente për depresionin. Këshillimi dhe trajtimi duhet të ofrohen jo vetëm për të burgosurit e dënuar por edhe për ata të padënuar. Megjithatë, programet afatgjata të trajtimit mund të fillojnë vetëm pasi një grua të jetë dënuar dhe për rrjedhojë pret të qëndrojë për një periudhë të gjatë në burg. Kur është e mundur dhe e përshtatshme, duhet të merret në konsideratë trajtimi në komunitet, i shoqëruar me masat e posaçme të sigurisë, duke pasur parasysh ndikimin negativ të burgosjes në shëndetin mendor.

Varianti më i mirë është të jepet trajtim mjekësor në një spital jashtë burgut. Nëse kjo nuk është e mundur, edukimi është shumë i rëndësishëm, si për personelin e burgut ashtu edhe për të burgosurit. Përveç problemeve të shëndetit mendor, është e rëndësishme të jepet informacion, materiale edukative dhe komunikimi për sëmundjet infektive, në mënyrë që ata që i kanë këto sëmundje të dinë si të MOS i transmetojnë ato dhe që ata që kujdesen për ta të dinë si ta shmangin ngjitjen e sëmundjes. Shumë njerëz nuk i dinë faktet e rëndësishme ose besojnë në mite/ide të gabuara të pavërteta për këto sëmundje. Për shembull, shumë nuk janë në dijeni të faktit se përdorimi i përbashkët i mjeteve të higjienës vetjake shton rrezikun e infeksionit. Përdorimi i përbashkët i brisqeve, prerëseve të thonjve dhe furçave të dhëmbëve përbën rrezik për hepatitin C. Edhe gjaku i menstruacioneve mund të përmbajë virusin e hepatitit C, i cili në gjak jeton më gjatë kur është jashtë trupit sesa HIV-i. Gjithashtu, hepatiti C dhe HIV-i kanë shumë shtame, dhe disa njerëz që përdorin drogën kanë shtame të shumtë. Duhet të siguroheni që ata e ndjekin mjekimin për të shmangur rritjen e ngarkesës virale.

Mite të zakonshme për HIV/AIDS

Mit: *Një grua shtatzënë që jeton me HIV gjithmonë sjell në jetë një fëmijë HIV pozitiv.*

Realiteti: Pa marrë trajtim, nënat e infektuara me HIV ua transmetojnë HIV-in foshnjave të tyre në rreth 25% të rasteve. Megjithatë, me trajtimet moderne, kjo përqindje ka rënë nën 2%. Shih [Fletën informative 611](#) për më shumë informacion për HIV-in dhe shtatzëninë.

Mit: *Medikamentet aktuale mund ta kurojnë SIDËN. Nuk është ndonjë problem i madh nëse infektohesh.*

Realiteti: Medikamentet e sotme e kanë reduktuar përqindjen e vdekjeve nga SIDA me rreth 80%. Gjithashtu ato mund të merren më lehtësisht se më parë. Megjithatë, ato kanë efekte anësore, janë shumë të kushtueshme dhe duhet të merren çdo ditë gjatë gjithë jetës. Nëse numri i dozave që nuk i merrni është i madh, HIV-i mund të zhvillojë rezistencë (shih [fletën informative 126](#)) ndaj medikamenteve që po merrni dhe ato mund të mos funksionojnë më. Aktualisht nuk ka kurë për HIV-in. Megjithatë, në përkujdesjen për pacientët me HIV janë bërë hapa të mëdhenj. Me mjekësinë e sotme, njerëzit mund ta ulin ngarkesën e tyre virale (sasinë e HIV-it në gjak) deri në atë pikë që është e pazbulueshme. Ekzistenca e një ngarkese virale të pazbulueshme ndihmon në parandalimin e SIDËS dhe infeksioneve të tjera oportunistike. **Kërkimet** vazhdojnë gjatë gjithë kohës dhe kjo mund të sjellë krijimin e **trajtimeve** të reja dhe **mënyrave të reja për parandalimin e infektimit me HIV**. Njerëzit me HIV kanë edhe familje dhe lidhje që u sjellin gëzim të madh. Shumë njerëz ende punojnë, pavarësisht sëmundjes. Me pak fjalë, njerëzit e jetojnë jetën në maksimum me HIV dhe SIDA, por ende nuk ka një kurë.

Mit: *HIV-i nuk merret nga tatuazhet ose piercing në trup.*

Është e mundur që HIV-i të merret nga instrumentet për bërjen e tatuazheve dhe piercing, të cilat nuk janë të sterilizuara si duhet kur përdoren nga një klient te tjetri. Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) thotë se instrumentet që presin lëkurën duhet të përdoren një herë dhe pastaj të hidhen ose të sterilizohen nga përdorimi në përdorim. Përpara se të bëni një tatuazh apo një piercing në trup, bëni pyetjet e duhura. Zbuloni hapat që ndërmerren stafin për të parandaluar HIV-in dhe infeksionet e tjera si **Hepatiti B** dhe **Hepatiti C**. Gjithashtu mund të telefononi në drejtorinë lokale të shëndetësisë për të pyetur se si duhet t'i sterilizojnë instrumentet e tyre dyqanet e tatuazheve. Për çdo person duhet të përdoret një age e re.

Mit: *Nëse partneri im do të kishte HIV do të mund ta dalloja.*

Duhen 10 vjet që simptomat e HIV-it të shfaqen. Kjo quhet periudhë latence. Mund të kalojë shumë kohë ku dikush ka HIV por nuk shfaq shenja. Përdorimi i vazhdueshëm dhe i saktë i kondomëve është tejet efikas për të parandaluar transmetimin seksual të HIV-it. Kondomët për meshkuj dhe për femra janë mjetet e vetme që ulin transmetimin e HIV-it dhe infeksioneve të tjera seksualisht të transmetueshme dhe parandalojnë shtatzëninë e padëshiruar (shih [deklaratën e qëndrimit të OKB-së](#)).

Mit: *Meqenëse jam HIV pozitive, nëse ngelem shtatzënë, do t'ia kaloj sëmundjen fëmijës tim të palindur.*

Një grua që e di që është e infektuar me HIV në fillim të shtatzënisë dhe trajtohet ka rreth 2 për qind mundësi që të lindë një fëmijë me HIV. Pa trajtim, 15-25% e nënave HIV pozitive që nuk e ushqejnë fëmijën me gjido t'i infektojnë foshnjat gjatë shtatzënisëose gjatë lindjes. Nëse fëmija ushqehet me gji, rreziku i transmetimit të HIV-it është edhe më i lartë. Nënata që e dinë se janë të infektuara me HIV duhet ose të ushqejnë fëmijën me gji dhe të marrin ndërhyrje antiretrovirale, ose ta shmangin ushqyerjen me gji (shih [udhëzimin e OKB-së për HIV-in dhe ushqyerjen e foshnjave](#)).

Mit: Si partneri im ashtu edhe unë kemi HIV. Nuk kemi nevojë të përdorim kondom.

Kjo nuk është e vërtetë. Ende duhet të praktikoni seks më të sigurt. Kini parasysh, ekzistojnë shtame (lloje) të ndryshme HIV-i. Edhe nëse keni HIV, mund të infektoheni me një lloj të ndryshëm nga ai që keni. Mund të infektoheni me një shtam të HIV-it që i reziston mjekimit. Kjo mund ta vështirësojë funksionimin e trajtimit. Sigurohuni që të përdorni kondom sa herë të kryeni çfarëdolloj seksi.

Mit: Unë kam HIV. Nuk duhet të filloj terapinë me ilaçe derisa të jem shumë sëmurë.

Edhe kur ndiheni mirë, HIV-i riprodhohet dhe sulmon trupin tuaj. Kur më në fund filloni të ndiheni sëmurë, HIV-i e ka dëmtuar tashmë sistemin tuaj imunitar. Në këtë pikë, nuk ka asgjë që ta sjellë atë në gjendje plotësisht normale. Për të mbrojtur sistemin imunitar, shumica e ekspertëve mendojnë se duhet t'i filloni medikamentet kundër HIV-it përpara se të sëmureni rëndë. Duke qenë se këto ilaçe ulin "ngarkesën tuaj virale" ose sasinë e virusit në gjatë, ato reduktojnë edhe mundësitë tuaja për t'ua transmetuar HIV-in të tjerëve. Megjithatë, marrja e trajtimit kundër HIV-it nuk garanton se nuk do t'i infektoni të tjerët. Kontrolllet periodike do të ndihmojnë mjekun tuaj dhe ju që të vendosni se kur është momenti më i mirë për të filluar trajtimin.

Mit: Gratë nuk mund t'ua ngjisin burrave HIV-in.

Është shumë më e vështirë që burrat ta marrin HIV-in nga gratë, por ndodh. HIV-i nuk jeton gjatë jashtë trupit. Penisi i një burri ekspozohet ndaj HIV-it për një periudhë më të shkurtër kohe dhe ka më pak zona ku virusi të mund të hyjë në trup. Nga ana tjetër, vagina e një gruaje ekspozohet ndaj HIV-it në spermën e burrit për një kohë shumë më të gjatë dhe ka më shumë hapësirë përmes së cilës HIV-i mund të hyjë në trup. Prandaj gratë kanë rrezik më të madh ta marrin HIV-in nga burrat. Nëse një partner ka një infeksion seksualisht të transmetueshëm të patrajtuar, rreziku është më i lartë.

Mit: HIV-i është njësoj si SIDA.

HIV-i është virusi që shkakton SIDËN. Një person thuhet se ka SIDA kur numri i CD4 bie nën 200 ose kur ai apo ajo ka simptoma dhe shenja të caktuara. Një person mund të ketë HIV për vite pa pasur SIDA. Pasja e HIV-it nuk do të thotë se keni SIDA.

Shtojca V. Vlerësim në fund të seminarit

Më poshtë jepet një shabllon i formularit të vlerësimit të seminarit, të cilin moderatorët mund ta kopjojnë që ta shpërndajnë dhe ta mbledhin në fund të trajnimit. Qëllimi i këtij vlerësimi është marrja e komenteve të pjesëmarrësve, të cilat do ta ndihmojnë moderatorin që t'i përmbushë më mirë nevojat e grupeve të ardhshëm. Këtu përfshihen komentet për mjedisin mësimor, qasjet dhe metodat e mësimdhënies dhe materialet mësimore. Në këtë formular përgjigjet janë anonime.

Kur shpërndajnë formularin, moderatorët duhet t'i nxisin pjesëmarrësit që të japin sa më shumë komente konstruktive.

Moderatorët nxiten që t'i lexojnë me kujdes dhe t'i shqyrtojnë rezultatet e vlerësimit. Ky informacion mund të ndihmojë në përmirësimin e seminareve të ardhshëm dhe në të mësuarin e pjesëmarrësve.

Formular vlerësimi në fund të seminarit

Titulli i seminarit: _____

Datë: _____

Vendi: _____

1. Sa i rëndësishëm ishte seminari për punën tuaj? (Rretho një përgjigje)

Nuk ishte i rëndësishëm		I rëndësishëm		Shumë i rëndësishëm	
1	2	3	4	5	6

2. A i përmbushi pritshmëritë tuaja përmbajtja e seminarit? (Rretho një përgjigje)

Aspak	Disa		Shumicën		Të gjitha
1	2	3	4	5	6

3. I arrit objektivat e tij seminari? (Rretho një përgjigje)

Aspak	Disa		Shumicën		Të gjitha
1	2	3	4	5	6

4. Sa aspekte të përmbajtjes ishin të reja për ju? (Rretho një përgjigje)

Disa të reja Shumë të reja Të gjitha të reja

Asnjë të re	Disa të reja		Shumë të reja		Të gjitha të reja
1	2	3	4	5	6

5. Si i vlerësoni sa më poshtë: (Rretho një përgjigje)

	Shumë keq	Keq	Mjaftueshëm	Mirë	Shkëlqyeshëm
Ambienti/salla e takimit	1	2	3	4	5
Pajisjet teknike (mikrofonat, mjetet vizuale etj.)	1	2	3	4	5
Mbështetja administrative	1	2	3	4	5
Drejtimi i seminarit	1	2	3	4	5
Sasia dhe cilësia e materialeve të shkruara	1	2	3	4	5

6. Ishin të mjaftueshme materialet e shkruara që ju t'i kuptonit prezantimet dhe të merrnit pjesë aktive në diskutime? (Rretho një përgjigje)

Të pamjaftueshme		Të mjaftueshme			Të shkëlqyera	
1	2	3	4	5	6	

7. Specifikoni se cila metodë trajnimi do ta përmirësonte më shumë procesin mësimor:

8. Specifikoni se cila metodë trajnimi mendoni se duhet të përdoret më pak në seminarët eardhshëm:

9. Rendisni kohën që u është kushtuar aktiviteteve të mëposhtme: (Rretho një përgjigje)

	Shumë pak kohë		Koha e duhur		Shumë kohë	
	1	2	3	4	5	6
Leksionet	1	2	3	4	5	6
Puna në grup	1	2	3	4	5	6
Diskutimet	1	2	3	4	5	6
Shkëmbimi i përvojave	1	2	3	4	5	6
Shprehja e mendimeve	1	2	3	4	5	6

10. Rendisni përvojën tuaj me moderatorin: (Rretho një përgjigje)

	Keq		Mjaftueshëm		Shkëlqyeshëm	
Njohuritë	1	2	3	4	5	6
Prezantimi i qartë	1	2	3	4	5	6
Drejtimi i mirë	1	2	3	4	5	6
Metodat e përdorura	1	2	3	4	5	6

11. Përshkruani se cilat module mendoni se ishin më të dobishme për punën tuaj:

12. Përshkruani se cilat module mendoni se ishin më pak të dobishme për punën tuaj:

13. Cilat pjesë të seminarit do të donit t'i kishit diskutuar më gjatë?

14. Ka tema të tjera që mendoni se mund të ishin përfshirë në seminar?

15. Jepni komente të tjera që mund të keni për seminarin dhe për masat që mund të merren për të përmirësuar realizimin e këtij seminari në të ardhmen:

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen dhe komentet!



UNODC

United Nations Office on Drugs and Crime

Justice Section
Division for Operations
United Nations Office on Drugs and Crime
P.O. Box 500
1400 Vienna
Austria
E-mail: justice@unodc.org
Tel.: (+43) 1 26060 0